

RAPORTI VJETOR

2024

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE

Hyrje.....	2
Problematikat të cilat duhen adresuar.....	8
Zbatimi i Rekomandimeve të Bashkimit Europian.....	9
Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë.....	11
Zbatimi i rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër korrupsionit dhe kriminalitetit	18

SITUATA E KRIMINALITETIT

Situata e kriminalitetit.....	25
Krimi i organizuar	25
Terrorizmi	30
Matja e riskut	31
Korrupsioni	32
Matja e riskut	35

ANALIZA KRAHASIMORE E EFEKTIVITETIT

Efektiviteti në hetim	37
Masat e sigurimit për personat e regjistruar.....	38
Volumi i punës në mbylljen e hetimeve	40
Sekuestrimi dhe konfiskimi i produkteve të veprave penale.....	44
Efektiviteti në gjykim	47

ANALIZA E VOLUMIT TË PUNËS TË PROKURORISË SË POSAÇME PËR VITIN 2024

Volumi i punës në hetim.....	48
Volumi i punës në gjykim	52
Ekzekutimi i vendimeve penale.....	53
Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe hetimet e përbashkëta.....	54
Bërthama Komanduese.....	63
Sektori i Ekspertizës.....	66
Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit.....	68
Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës.....	73
Kompetenca e Institucionit të Komisionerit Publik	73
Koordinatori për marrëdhënien me median dhe e drejta e informimit..	74
Dokumentacioni i klasifikuar dhe i paklasifikuar.....	77
Drejtoria e Burimeve Njerëzore, etj.	78
Byroja Kombëtare e Hetimit.....	84
Treguesit e buxhetit për vitin 2024 dhe plani i shpenzimeve për vitin e ardhshëm drejtoria e buxhetit dhe menaxhimi financiar	86

TABELA E AKRONIMEVE

SPAK	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
Prokuroria e Posaçme	Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
GJKKO	Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
GJAKKO	Gjykata e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
SHISH	Shërbimi Informativ i Shtetit
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
OPGJ	Oficer i Policisë Gjyqësore
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
OFL	Operacioni Forca e Ligjit
DTI	Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit
PSHS	Policia e Shtetit Shqiptar
SPH	Skuadrat e Përbashkëta Hetimore
DVP	Drejtoria Vendore e Policisë
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Teknologjisë së Informacionit
AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
AKSIK	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
BE	Bashkimi Europian
FATF	Financial Action Task Force
MONEYVAL	Committee of Experts on the Evaluation of Anti-Money Laundering Measures and the Financing of Terrorism
ICRG	International Country Risk Guide
PP/FT	Pastrimi i parave/ Financim i terrorizmit
KBLKPP	Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave
EU4FOCAL	Fighting organised crime in Albania
EU4LEA	European Union for Law Enforcement in Albania
EU4FAST	EU Support to Strengthen the Fight against Migrant Smuggling and Trafficking in Human Beings in the Western Balkans
Eurojust	European Union Agency for Criminal Justice Cooperation
Interpol	The International Criminal Police Organization
Europol	European Serious and Organised Crime Centre
ICITAP	International Criminal Investigative Training Assistance Program
OPDAT	Office of Overseas Prosecutorial Development, Assistance and Training
FBI	Federal Bureau of Investigation
DIA (EUROPOL)	Defense Intelligence Agency
ILEA – Budapest	International Law Enforcement Academy in Budapest
CEPOL	ILEA - Budapest
CISA	Cybersecurity and Infrastructure Security Agency
IPA 2019	Lufta kundër Krimeve të Rënda në Ballkanin Perëndimor 2019
JIT	Joint Investigation Teams
WBCJ	Western Balkan Criminal Justice
MATRA	European Cooperation Embassy Program
OJF	Organizatë jofitimprurëse

Raporti vjetor i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar¹, mbështetet në nenin 148/dh të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë², si dhe në përcaktimet e nenit 15/2, shkronja “d”, të ligjit nr. 95/2016 Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, të ndryshuar dhe neneve 103, 104 dhe 105 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar.

Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të zyrtarëve të lartë, edhe pse ka dhënë rezultate inkurajuese, mbetet një sfidë e rëndësishme për forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri³.

Në lidhje me përmbushjen e rolit të saj, Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) ka marrë vlerësime pozitive nga institucione vendase dhe ndërkombëtare⁴.

Në Indeks Global të Korrupsionit për vitin 2024, Shqipëria vlerësohet me 42 pikë, duke e përmirësuar indeksin e perceptimit të korrupsionit me 5 pikë në raport me një vit më parë⁵. *Transparency International* ka njohur rolin e SPAK në rritjen e besimit të publikut⁶.

Takimi i 16-të i Nënkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë⁷, i zhvilluar më 11 dhe 12 shkurt 2025, nënvijëzoi rolin e SPAK në përpjekjet e përgjithshme të Shqipërisë për të ofruar një bilanc të besueshëm kundër krimit të rëndë dhe të organizuar dhe korrupsionit, përfshirë në nivele të larta. Ai e konsideroi gjithashtu rolin e SPAK si themel të

¹ Prokuroria e Posaçme së bashku me Njësinë e Posaçme Hetimore të saj (Byroja Kombëtare e Hetimit) formojnë Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, të titulluar (“SPAK”).

² Prokuroria e Posaçme është organ kushtetues i pavarur i cili ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën para gjykatave të posaçme të parashikuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, si dhe para Gjykatës së Lartë për veprat penale të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

³ Komisioni Evropian (2024). *Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit: Raporti mbi Shtetin e së Drejtës. Kapitulli i Shtetit mbi situatën e sundimit të ligjit në Shqipëri 2024. Shoqëruar me Komunikatën për Situatën mbi Shtetin e së Drejtës në Bashkimin Evropian*. Marrë nga: https://commission.europa.eu/document/download/0154dce1-5026-45de-8b37-e3d56eff7925_en?filename=59_1_58088_coun_chap_albania_al.pdf, fq. 11

⁴ Kuvendi i Shqipërisë (2024). *Rezolutë Për vlerësimin e veprimtarisë së strukturës së posaçme kundër Korrupsionit dhe krimit të organizuar për vitin 2023*. Marrë nga: <https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/856782a4-a924-4741-9e7c-d2ec952e58c5>. U.S. Embassy Tirana (19.12.2024). *Deputy Assistant Secretary Kasanof at the Five-Year Anniversary of SPAK*. Marrë nga: <https://al.usembassy.gov/deputy-assistant-secretary-kasanof-at-the-five-year-anniversary-of-spak/>.

Komisioni Evropian (2024). *Dokument i Punës i Stafit të Komisionit: Raporti i Shqipërisë 2024. Shoqëruar me Komunikatën për Politikën e Gjërimit të BE-së*. Marrë nga [enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania Report 2024.pdf](https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf)

⁵ Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit (2024). *Transparenca Ndërkombëtare. Koalicioni global kundër korrupsionit*. Marrë nga: <https://www.transparency.org/en/countries/albania>

⁶ CPI 2024 për Europën Lindore dhe Azinë Qendrore: cikli vicioz i demokracisë së dobët dhe korrupsionit në lulëzim (11.2.2025). *Transparenca Ndërkombëtare. Koalicioni global kundër korrupsionit*. Marrë nga: <https://www.transparency.org/en/neës/cpi-2024-eastern-europe-central-asia--vicious-cycle-weak-democracy-flourishing-corruption>

⁷ Takimi i 16-të i Nënkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë, i zhvilluar më 11 dhe 12 shkurt 2025. Marrë nga: https://www.eeas.europa.eu/delegations/albania/european-union-%E2%80%93-albania-16th-sa-sub-committee-meeting-justice-freedom-and-security_en?s=214

reformës në drejtësi të vitit 2016 dhe vlerësoi pavarësinë e tij në hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve komplekse të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Po kështu, **Progres Raporti i Komisionit Evropian, i publikuar në 30 tetor 2024**, nënvizon se, SPAK ka vazhduar të japë rezultate të mira duke avancuar më tej në ndjekjen penale dhe hetimin e rasteve komplekse të korrupsionit, përfshirë ato që përfshijnë politikanë dhe zyrtarë të nivelit të lartë, si dhe raste që lidhen me mbrojtjen e interesave financiare të BE-së⁸. Po aty, në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar cilëson se: Shqipëria vazhdon të ketë një nivel të mirë bashkëpunimi me shtetet anëtare të BE-së, Europolin dhe Eurojust-in dhe ka marrë pjesë në një sërë operacionesh ndërkombëtare të zbatimit të ligjit. Është bërë njëfarë progresi në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të lidhura me krimin e organizuar, i cili duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen.

SPAK ka arritur që tashmë të krijojë një besueshmëri me institucionet partnere në nivel rajonal dhe më gjerë, ku ndër të tjera, ka arritur të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë Kombëtare kundër Krimit të Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut (NCA), si dhe memorandume mirëkuptimi me Prokurorinë e Përgjithshme të Mbretërisë së Spanjës dhe Prokurorinë Speciale të Malit të Zi.

Brenda vitit 2024, SPAK tashmë ka përcaktuar një strategji të konsoliduar institucionale në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe pastrimit të parave duke përmbyllur dhe kornizën strategjike me të gjitha strategjitë përkatëse, në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare⁹. Kjo kornizë strategjike ka reflektuar edhe rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë¹⁰, të Këshillit të Ministrave në luftën kundër korrupsionit dhe kriminalitetit, si dhe të Progres–Raportit të Bashkimit Evropian për Shqipërinë për vitin 2024.

SPAK i ka dhënë një rëndësi të veçantë hetimit pasuror dhe financiar. Në këtë kontekst, është forcuar Sektori i Hetuesve Financiarë nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve njerëzore kryesisht në hetimet financiare dhe pasurore me veprime komplekse brenda dhe jashtë vendit ku përfshihen edhe veprimet me kriptovaluta. Gjatë vitit 2024, me asistencën e ekspertëve ndërkombëtarë është finalizuar nxjerrja e një udhëzimi të përgjithshëm për masat administrative dhe procedurale për kryerjen e hetimit financiar dhe pasuror në SPAK¹¹.

Hetimet financiare dhe pasurore kanë dhënë rezultate, të cilat janë reflektuar në rritjen e vlerës së aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara gjatë vitit 2024, që përllogaritet në vlerën totale prej rreth 65,5 milion euro¹². Prej tyre, vlera e pasurive të sekuestruara është në shumën rreth 28,7 milion

⁸ Komisioni Evropian (2024). *Dokument i Punës i Stafit të Komisionit: Raporti i Shqipërisë 2024. Shoqëruar me Komunikatën për Politikën e Zgjerimit të BE-së*. Marrë nga enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania_Report_2024.pdf, faqe 6.

⁹ <https://spak.gov.al/wp-content/uploads/2024/09/Plani-Strategjik-2024-2027.pdf>

¹⁰ Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, miratuar në seancë plenare, datës 25.07.2024 Për vlerësimin e veprimtarisë së Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2023.

¹¹ Publikuar në faqen zyrtare të SPAK, <https://spak.gov.al/wp-content/uploads/2024/11/Udhezim-i-pergjithshem-nr-1093-date-11.11.2024-Masat-administrative-dhe-procedurale-per-kryerjen-e-hetimit-financiar-dhe-pasuror-ne-strukturen-e-Posacme-Kunder-Korrupsionit-dhe-Krimin-te-Organizuar.pdf>

¹² Kjo vlerë është përllogaritur duke patur parasysh vlerën totale të aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara për vitin 2024. Në mënyrë të detajuar, vlera e pasurive të sekuestruara është 2,800,705,512 lekë, ndërkohë që vlera e pasurive

euro, ndërkohë që për pasuritë e konfiskuara kjo vlerë arrin në shumën rreth 36,7 milion euro. Kështu, vlera e pasurive të sekuestruara zë rreth 43,8% të vlerës totale, ndërsa pasuritë e konfiskuara zënë rreth 56,2% të vlerës totale. Krahësuar gjithashtu me vitin 2023, vihet re një rritje në masën rreth 59,7% e vlerës totale të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara (rreth 65,5 milion euro në vitin 2024 kundrejt rreth 41 milion euro në vitin 2023).

Volumi i hetimeve penale vijon të ketë një trend pozitive edhe për vitin 2024, me një rritje prej 9,7% krahasuar me vitin paraardhës. Kështu gjatë kësaj periudhe, janë nën hetim gjithsej 793 procedime (në 854 procedime të nën hetim gjithsej, 61 prej tyre janë bashkuar). Prej këtij totali, 526 procedime penale janë mbartur nga viti 2023, ndërsa 328 procedime penale janë regjistruar gjatë vitit 2024, si procedime penale të reja.

SPAK ka ruajtur të njëjtin trend pozitiv edhe në **qasjen pro aktive** të hetimeve. Gjatë vitit 2024 janë regjistruar 65 hetime të nisura kryesisht, edhe pse krahasuar me vitin 2023, vihet re një rënie në masën rreth 7,1% e interceptimit të pajisjeve fundore. Po kështu, evidentohet rritje e kërkesave për ndihmë juridike në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar me 45,8% për ato të ardhura nga jashtë vendit dhe me 34,7%, për ato drejtuar autoriteteve të huaja. Nga ana tjetër ky trend pozitiv, tregon për një rritje të nivelit të bashkëpunimit dhe të besueshmërisë të autoriteteve të huaja ligj zbatuese ndaj Prokurorisë së Posaçme.

Lufta **kundër krimit të organizuar edhe për këtë vit**, krahasuar me vitin paraardhës, ka shënuar arritje të rëndësishme me një rritje prej rreth 18,8% të regjistrimeve të këtyre procedimeve penale. Po kështu, është rritur edhe numri i personave të cilët janë nën hetim për këto procedime me rreth 21,6%, krahasuar me vitin 2023. Nga ana tjetër, ka një rënie me rreth 7,3% të çështjeve të dërguara për gjykim për shkak të volumit dhe kompleksitetit të tyre.

Për sa i përket **luftës kundër korrupsionit**, Prokuroria e Posaçme ka ndjekur një qasje aktive duke hetuar një numër të konsiderueshëm zyrtarësh të lartë. Gjatë vitit 2024, rezultojnë të jenë nën hetim 33 – ish zyrtarë të lartë (ku dy prej tyre janë të regjistruar në dy procedime të ndryshme secili), nga të cilët 19 zyrtarë janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim. Nga numri total i ish-zyrtarëve të lartë nën hetim, 19 prej tyre janë dërguar në gjykatë, që përfaqëson 52,9% të rasteve.

Bashkëpunimi nga institucionet publike në lidhje me referimet e ardhura prej tyre ka nevojë ende të përmirësohet. Kështu numri i procedimeve të filluara nga referimet e përcjella nga institucionet publike mbetet i ulët, duke zënë vetëm 15,1% të totalit të referimeve të dërguara pranë SPAK nga të gjitha subjektet publike dhe private. Është për t'u theksuar se, referimet e ardhura nga policia e shtetit, krahasuar me vitin 2023, kanë shënuar gjithashtu një rënie shqetësuese me 53,8%.

Nga ana tjetër vihet re një rritje e besimit të publikut tek SPAK në lidhje me referimet e veprave penale. Kështu për këtë vit, shumica e referimeve kanë ardhur nga shtetasit, numri i të cilave zë

të konfiskuara, është 938,079,626 euro + 27,202,300 lekë. Llogaritja e vlerës në euro është kryer duke patur parasysh kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë me datë 31.12.2024.

rreth 37% të totalit. Krahasuar me vitin 2023, numri i procedimeve të nisura nga referimet e ardhura nga shtetasit është rritur në masën rreth 36%.

Në lidhje me masat e sigurimit, SPAK ka aplikuar një politikë penale në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kështu për llojin e kërkesave të **masave të sigurimit** rezulton se, numri i të paraburgosurve nga SPAK që ndodhen pranë Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale **përbën vetëm 9,7% të totalit** (nga 2,791 të paraburgosur në Shqipëri, 270 prej tyre janë nën hetim nga SPAK). Ndërkohë, numri i të burgosurve, që janë dënuar me vuajtje dënimi me burg nga hetimet e SPAK përbën **vetëm 9,5% të totalit** (nga 1,722 të burgosur, 165 persona janë dënuar pas procedimeve të SPAK).

Përsa i përket masave të sigurimit **“arrest me burg”**, kjo masë krahasuar me llojin e masave të tjera të sigurimit, për veprat penale të korrupsionit **zë vetëm 5,1% të totalit** të masave, ndërsa për krimin e organizuar, kjo masë sigurie **zë 30,84% të totalit**.

Gjithashtu, efektiviteti në gjykim për zyrtarët e lartë, ka një rritje të numrit të dënimeve të formës së prerë për këtë kategori (nga 9 në vitin 2023, në 10 për vitin 2024). Megjithatë, në përgjithësi vendimet e fajësisë në shkallën e parë të Gjykatës për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO) kanë shënuar një rënie në masën 9% në raport me vitin 2023, ndërkohë që ato të Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJAKKO) janë thujt në të njëjtin nivel me vitin paraardhës.

Në lidhje me volumin e çështjeve në Gjykatën e Lartë, vihet re, një rritje e ndjeshme me më shumë se dyfishi e rekurseve të paraqitura pranë Kolegjit të Posaçëm të Gjykatës së Lartë për çështjet e hetuara nga SPAK (87 rekurse nga palët në gjykim për vitin 2024, nga 41 në vitin 2023), krahasuar me vitin paraardhës.

Një fokus të veçantë ka marrë edhe ndjekja penale e subjekteve të rivlerësimit kalimtar. Gjatë vitit 2024, pranë Prokurorisë së Posaçme janë referuar nga organet e rivlerësimit kalimtar 19 kallëzime për subjektet e rivlerësimit kalimtar. Pas verifikimit të këtyre kallëzimeve, është vendosur shpallja e mos kompetencës dhe dërgimi pranë prokurorive të rretheve të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm. Këto kallëzime penale kanë qenë për ish prokurorë dhe ish gjyqtarë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, që nuk janë subjekte në kompetencën e Prokurorisë së Posaçme. Njëkohësisht, nga kallëzimet penale kishte dyshime për veprën penale *“Refuzimi për deklarimin, mos deklarimin, fshehja ose deklarimi i rreme i pasurisë, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”*, të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal, vepër penale e cila nuk është në kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme.

Prokuroria e Posaçme ka qenë mjaft bashkëpunuese në marrëdhënie me kërkesat e bëra nga publiku dhe institucionet shtetërore, të cilat lidhen kryesisht me raportime në kuadër të strategjive kombëtare në luftën kundër korrupsionit, krimin të organizuar, pastrimit të parave dhe procesit të përmbylljes së kapitujve 23 dhe 24 me BE. Nga totali prej 4,422 kërkesa të përcjella nga institucionet shtetërore, organizata, avokatë, media, qytetarë, 982 kërkesa kanë ardhur nga institucionet shtetërore dhe 894 prej tyre kanë marrë përgjigje. Këtu përfshihen edhe mendime dhe përcjellje të dhënash për projekt-akte ligjore dhe nënligjore, si dhe për strategji ndër sektoriale në luftën kundër korrupsionit, krimin të organizuar, pastrimit të parave dhe për mbrojtjen e viktimave

të krimit, tek Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave, Ministria e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, etj.

Volum të konsiderueshëm pune ka pasur edhe në lidhje me kontrollin e integritetit të punonjësve të SPAK dhe gjykatave të posaçme. Gjatë vitit 2024, Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës, për Prokurorinë dhe Gjykatat e Posaçme ka përfunduar verifikimet e plota të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës për 58 kandidatë për personel administrativ në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si dhe për Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në këtë proces kanë përfunduar verifikimet dhe për kancelarin e Prokurorisë së Posaçme të kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Gjatë vitit 2024, SPAK në zbatim të funksioneve që i ka parashikuar Kushtetuta dhe ligji, është përpjekur të zhvillojë më tej kapacitetet njerëzore dhe teknike, të cilat janë reflektuar në cilësinë e hetimeve të kryera prej saj,

Në funksion të rritjes së efektivitetit të strukturave administrative mbështetëse dhe forcimit të etikës në punë, janë miratuar një sërë aktesh nënligjore si dhe është në proces puna për përfundimin e disa akteve të tjera, brenda një kohe sa më të shpejtë. Për sa i përket akteve administrative me karakter strategjik dhe rregullator, për vitin 2024, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka nxjerrë 21 akte administrative, ndër të cilat: 3 Dokumente Strategjike; 3 Rregullore të miratuara (Rregullore e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, etj.); 6 Marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara me institucionet publike dhe private në vend; 4 Urdhra të përbashkëta me Drejtorin e BKH-së; 2 Udhëzime të Përgjithshme (dhe udhëzimi për qarkullimin e dosjeve) dhe 3 Urdhra.

Po kështu, është vijuar me investimin dhe fuqizimin e Sektorit të Ekspertizës, duke siguruar që programet dhe pajisjet ekzaminuese të jenë gjithmonë të përditësuara, si dhe teknologjia që përdoret të jetë e fjalës së fundit.

Volumi dhe efektiviteti i analizave të brendshme ka qenë gjithashtu i konsiderueshëm. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka thirrur rregullisht mbledhje të prokurorëve për çështje që lidhen me funksionin e Prokurorisë së Posaçme, si dhe analiza të brendshme me stafin administrativ. Për gjatë vitit 2024, janë organizuar gjithashtu, edhe analiza me secilin prokuror dhe grupin e hetuesve përkatës, përfshirë dhe analiza tematike me Sektorin e Ekspertizës dhe Sektorin e Hetimit Financiar.

Në bashkëpunim BKH, Prokuroria e Posaçme ka kontribuar mbi hartimin e përshkrimit të punës të oficerëve të policisë gjyqësore; të procedurave për emërimin e oficerëve të policisë gjyqësore.

Aktualisht është në proces finalizimi “Rregullorja për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetit të hetuesve dhe oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore në Byronë Kombëtare të Hetimit”. Në proces diskutimi me ekspertët ndërkombëtar është edhe “Procesi i rekrutimit të shërbimeve të policisë gjyqësore” pranë BKH-së, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të Vendimit nr. 438 datë 19.07.2023 “Për miratimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve për trajtimin e punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit”.

Po vijohet gjithashtu, me rritjen e kapaciteteve njerëzore të hetuesve të BKH-së, me fokus në përdorimin e mjeteve dhe teknikave speciale të hetimit, provave digjitale etj. Në buxhetin e këtij viti është parashikuar një fond i posaçëm për blerjen e mjeteve teknike të cilët do të përdoren gjatë hetimeve.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe forcimit të komunikimit me publikun. Për këtë qëllim gjatë këtij viti u miratua Strategjia e Komunikimit me Publikun, e cila u përgatit në bashkëpunim të ngushtë me ekspertë ndërkombëtarë, duke ndjekur praktika të aplikuara nga agjencitë ligj zbatuese të ngjashme me SPAK-un.

Numri i kërkesave për informacion nga qytetarë, media, organizata të shoqërisë civile dhe subjekte të ndryshme, vijon të jetë i lartë edhe për vitin 2024. Gjatë kësaj periudhe, 128 kërkesa për informacion kanë marrë përgjigje të plotë dhe brenda afateve ligjore nga Koordinatori për Marrëdhënien me Mediat, pranë SPAK. Janë zhvilluar gjithashtu një sërë konferencash për shtyp në lidhje me forcimin e bashkëpunimeve të SPAK me autoritete gjyqësore të huaja dhe institucionet ndërkombëtare, lidhur me hetime komplekse, në kuadrin e ngritjes së skuadrave të përbashkëta hetimore.

Në kuadër të rritjes së transparencës me publikun, janë mbajtur takime periodike me gazetarët e kronikës, jashtë kamerave “*off the record*”, ku është diskutuar për çështjet më të rëndësishme, bashkëpunimin me autoritetet e huaja dhe institucionet ligj zbatuese ndërkombëtare, të cilët kanë luajtur një rol parësor në hetimet komplekse të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Më poshtë trajtohen në mënyrë të detajuar të dhënat statistikore të SPAK.

Seksioni i parë, fokusohet në adresimin e prioriteteve të shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritetit evropian, të cilat lidhen me funksionin e SPAK-ut, adresimin e Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si dhe adresimin e Rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave.

Në seksionin e dytë, jepet një vështrim i përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit duke përfshirë këtu format, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe tendencat e veprave penale që hetohen nga SPAK.

Në seksionin e tretë, bëhet një analizë krahasimore e veprimtarisë së Prokurorisë së Posaçme, duke nënvizuar të dhënat mbi efektivitetin e punës në hetim dhe gjykim të institucionit, përgjatë tre viteve të fundit.

Në seksionin e katërt, jepen të dhënat e volumit të punës për të gjithë sektorët, si dhe elementë të tjerë thelbësorë të veprimtarisë së institucionit për vitin 2024. Raporti bëhet publik nëpërmjet publikimit të tij në faqen zyrtare të SPAK.

Kopje të raportit i paraqiten gjithashtu, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Ministrisë së Drejtësisë.

PROBLEMATIKAT TË CILAT DUHEN ADRESUAR

Prokuroria e Posaçme, ka paraqitur disa problematika, që i ka hasur në punën e saj, të cilat përkthehen në propozime të mundshme për të kryer ndryshimet e nevojshme ligjore, qoftë në ligjin organik nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar, apo dhe në ligje të tjera, të cilët do të ndikojnë në cilësinë dhe mbarëvajtjen e punës së Prokurorisë së Posaçme. Edhe për vitin 2024, disa nga problematikat e paraqitura vijnë të mbeten. Ndërkohë janë shfaqur edhe disa problematika të tjera, të cilat së bashku paraqiten, si më poshtë:

- 1. Presioni i jashtëm ndaj SPAK nga krimi i organizuar, aktorë politikë dhe mediatik, i cili cenon pavarësinë e tij kushtetuese dhe efektivitetin në hetime.** Ndërhyrjet e jashtme rrezikojnë gjithashtu, integritetin e prokurorëve dhe të procesit hetimor. Për të garantuar pavarësinë e SPAK-ut, si dhe mbështetje për prokurorët në çështje të ndjeshme, nevojitet një reagim më i koordinuar dhe në kohë i të gjitha institucioneve, të cilat kanë përgjegjësinë e mbrojtjes së integritetit të SPAK.
- 2. Vijimi i mungesës së përcaktimit të qartë ligjor në lidhje me statusin e prokurorëve të posaçëm pas përfundimit të mandatit të tyre.** SPAK konstaton se, kjo problematikë nuk është adresuar ende dhe thekson se mos përcaktimi i qartë i këtij statusi mund të cenojë vijimësinë e ruajtjes së standardeve të larta profesionale të hetimit, të kërkuara nga publiku, Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe institucionet ndërkombëtare. Siç është nënvizuar edhe në raportin vjetor të SPAK për vitin 2023, nga mungesa e një statusi të qartë të prokurorëve të posaçëm do të cenohej gjithashtu dhe vazhdimësia e hetimeve të rëndësishme të kryera nga SPAK.
- 3. Vijimi i mos adresimit të akordimit të këshilltarëve ligjor** pranë Prokurorisë së Posaçme. Cilësojmë në mënyrë të përsëritur se, mungesa e këtij standardi burimi njerëzor vë në vështirësi cilësinë e hetimit dhe prapësimeve të SPAK në ndjekjen e çështjeve në të gjitha shkallët e gjykimit dhe në Gjykatën Kushtetuese.
- 4. Vijnë ende të ngelet problematike numri i ulët i referimeve nga institucionet publike, përfshirë policinë e shtetit në lidhje me veprat penale në kuadër të korrupsionit dhe krimin të organizuar.**
- 5. Përfundimi i ngritjes së sistemit të administrimit të çështjeve (Case Management System) mbetet një prioritet për Prokurorinë e Posaçme.** Sistemi ka një ndërtim modular dhe në dhjetor 2024 ka përfunduar zhvillimi/ndërtimi i moduleve. Për shkak të përfundimit të projektit mbështetës të ICITAP, ky proces është pezulluar dhe pritet të përmbyllet brenda vitit 2025, me fonde të BE-së.
- 6. Ngritja e njësisë së analizës së SPAK** që do të shpërbejë për të mbështetur hetimet komplekse, matjet e riskut, dhe raportimet në kuadër të negociatave me BE, Moneyval dhe raportime në kuadër të strategjive kombëtare të ndryshme, ngele një sfidë. Po bashkëpunohet me ekspertë ndërkombëtarë për të përshtatur një model sipas kërkesave dhe funksionimit të SPAK.
- 7. Vijnë të mbetet problematike statusi i specialistit Ndërlidhës në Sektorin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta,** i cili trajtohet si nëpunës civil

bazuar në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar. Kjo situatë është në kundërshtim me funksionet, që duhet të kryejë Specialisti Ndërlidhës sipas ligjit nr. 95/2016, siç është argumentuar në raportin vjetor të SPAK, për vitin 2023.

8. Vijon të ngelet e pa adresuar mungesa e kompetencës për shqyrtimin e kërkesave të autoriteteve të huaja lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale të huaja në Shqipëri në ngarkim të shtetasve shqiptarë për veprat penale, për të cilat Prokuroria e Posaçme ka në kompetencë, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Po kështu, paraqitja e kërkesave për njohjen dhe ekzekutimet e vendimeve penale të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nga një shtet i huaj, si dhe realizimi i procedurës të ekstradimit për jashtë të shtetasve shqiptarë.

9. Mungesa e kompetencës lëndore e Gjykatave të Posaçme për shqyrtimin e kërkesave në fazën e ekzekutimit të vendimit penal për subjektet e posaçme sipas parashikimeve të nenit 135, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 75/a, të Kodit të Procedurës Penale. Aktualisht këto kërkesa shqyrtohen nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm penal, siç është argumentuar në raportin vjetor të SPAK, për vitin 2023.

10. Vazhdon dhe mbetet problematike çështja e mos ekstradimit të shtetasve shqiptarë të lokalizuar apo arrestuar në Emiratet e Bashkuara Arabe, siç është argumentuar në raportin vjetor të SPAK për vitin 2023.

ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË BASHKIMIT EUROPIAN

Në Progres Raportin për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian ashtu sikundër dhe vitin e kaluar ka vlerësuar progresin e Shqipërisë “në një nivel të moderuar përgatitjeje në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore duke bërë disa përparime gjatë periudhës raportuese” në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Lidhur me luftën kundër korrupsionit vlerësohet se ka përparime, por mbetet një fushë shqetësimi serioze, ndërsa thekson se zbatimi i vazhdueshëm i vetting-ut ka pasur një ndikim pozitiv në luftën kundër korrupsionit në gjyqësor.

KE ka vlerësuar gjithashtu shumë punën e SPAK-ut gjatë vitit 2024, duke u shprehur se: *kjo strukturë ka vazhduar të japë rezultate të mira si dhe duke avancuar më tej hetimin e rasteve komplekse kundër korrupsionit, përfshirë hetimet ndaj nivelit të lartë të politikanëve dhe zyrtarëve, si dhe rastet që përfshijnë mbrojtjen e interesave financiare të BE-së.* Gjithashtu, Progres Raporti thekson qartë se, kapaciteti i SPAK-ut është rritur në hetimet financiare, si dhe për pasojë dhe i ai konfiskimeve të pasurive është përmirësuar.

Sipas Progres Raportit rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan pjesërisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme për vitin 2025 dhe konkretisht:

Rekomandimi nr. 1 - Forcimin e hetimit, ndjekjen penale, gjykimin dhe dënimin përfundimtar të rasteve të korrupsionit, në veçanti në nivel të lartë, përfshirë konfiskimin përfundimtar të

pasurive kriminale që rezultojnë nga shkeljet e lidhura me korrupsionin dhe rritja e referimit pro aktiv të institucioneve përkatëse të shtetit dhe agjencive ligj zbatuese në SPAK.

Eksperienca tashmë e konsoliduar e prokurorëve të posaçëm, hetuesve të BKH-së dhe hetuesve financiarë, trajnimi i tyre brenda dhe jashtë vendit, plotësimi i organikës gjatë vitit 2024 sa i përket numrit të prokurorëve nga 17 në 20 prokurorë, ka çuar në një rritje të ndjeshme të hetimit penal sa i përket luftës kundër korrupsionit dhe për pasojë gjykimit dhe dënimit të zyrtarëve të nivelit të lartë.

Për sa i përket luftës **kundër korrupsionit**, gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka shënuar një rritje me rreth 8% të numrit total të çështjeve të nën hetim krahasuar me vitin paraardhës (nga 447 çështje nën hetim për vitin 2023 në 483 çështje nën hetim për vitin 2024). Po kështu, është rritur me rreth 21%, edhe numri i personave të cilët që kanë qenë nën hetim për vitin 2024 në krahasim me ata të vitit paraardhës (nga 212 persona nën hetim në vitin 2023 në 257 persona nën hetim në vitin 2024). Rritje në masën rreth 8% ka shënuar gjithashtu, edhe numri i hetimeve të përfunduara dhe të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2023 (nga 38 në vitin 2023 në 41 në vitin 2024). Nga ana tjetër ka një rënie me rreth 15% të çështjeve të reja të regjistruara.

Rekomandimi nr. 2 - Vazhdimin e përdorimit sistematik të hetimeve paralele financiare kur kemi të bëjmë me krimin e organizuar, trafikimin e paligjshëm, terrorizmin dhe pastrimin e parave.

Në funksion të përmirësimit të punës së hetimeve paralele financiare dhe luftën kundër krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm, terrorizmit dhe pastrimit të parave, Prokuroria e Posaçme, ka miratuar me urdhrin e Drejtuesit të Prokurorisë nr. 1093 prot., datë 11.11.2024 Udhëzimin e Përgjithshëm “Për masat administrative dhe procedurale për kryerjen e hetimit financiar dhe pasuror në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”.

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i standardeve dhe unifikimi i mënyrës së ndjekjes së procedurave penale të ndërmarra nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe nga hetuesit e Sektorit të Hetimit Financiar, gjatë kryerjes së hetimit financiar dhe pasuror. Po ashtu ky udhëzim përcakton që për veprat penale të cilat janë në kompetencën e SPAK, krahas hetimit për veprën penale të nisë paralelisht dhe hetimi financiar.

Në vijim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Prokuroria e Posaçme ka arritur të sekuestrojë dhe konfiskojë gjatë vitit 2024 një portofol të diversifikuar asetesh. Këtu përfshihen pasuri të paluajtshme, vlera monetare, kuota tregtare, si dhe portofole kriptovalutash në një vlerë totale prej rreth 65,5 milion eurosh. Prej tyre, vlera e pasurive të sekuestruara zënë rreth 43,8% të totalit, ndërsa pasuritë e konfiskuara zënë rreth 56,2% të vlerës totale. Krahasuar me vitin 2023, vihet re një rritje në masën rreth 59,7% e vlerës totale të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara (rreth 65,5 milion euro në vitin 2024 kundrejt rreth 41 milion euro në vitin 2023).

Rekomandimi nr. 3 - Forcimin e mëtejshëm të luftës kundër krimit të organizuar, duke përfshirë edhe vazhdimin e bashkëpunimit me Shtetet Anëtare të BE-së dhe agjencitë e BE-së (përfshirë Europol, në kuadër të Platformës Multidisiplinare Evropiane kundër Kërcënimeve Kriminale

(EMPACT), dhe Eurojust), rritjen e kapacitetit për të luftuar krimin kibernetik dhe pastrimin e parave dhe për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e qenieve njerëzore.

Prokuroria e Posaçme i ka kushtuar rëndësi të veçantë bashkëpunimit ndërkombëtar, si një faktor kyç në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Gjatë vitit 2024 është rritur ndjeshëm edhe komunikimi i drejtpërdrejtë i Prokurorisë së Posaçme me autoritetet homologe evropiane, amerikane, të Rajonit dhe të Amerikës së Jugut. Po kështu, është intensifikuar shkëmbimi i informacionit nëpërmjet rrjeteve dhe kanaleve të sigurta të komunikimit me Eurojust, Interpol, Europol etj. Ka vijuar gjithashtu komunikimi intensiv me prokurorët dhe oficerët ndërlidhës që mbulojnë Shqipërinë, të atashuar pranë Ambasadave të Huaja në Tiranë, apo jashtë Shqipërisë, duke forcuar bashkëpunimin dhe rritur efektivitetin në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Në kuadër të projektit Eurojust, edhe gjatë vitit 2024 ka vijuar bashkëpunimi i frytshëm sa i përket skuadrave hetimore të përbashkëta. Gjatë këtij viti janë krijuar 10 skuadra të përbashkëta hetimore me autoritetet e huaja të drejtësisë dhe kanë vijuar hetimet përmes 27 skuadrave të përbashkëta hetimore, aktive në Prokurorinë e Posaçme që nga krijimi i saj.

ZBATIMI I REZOLUTËS SË KUVENDIT DHE REKOMANDIMEVE PRIORITARE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NË LUFTË KUNDËR KRIMINALITETIT

ZBATIMI I REZOLUTËS TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Kuvendi i Shqipërisë, në Rezolutën e miratuar në seancë plenare të datës 25.07.2024 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2023”, ka vlerësuar punën për përmbushjen e funksioneve që kanë të bëjnë me: përmirësimin e treguesve statistikorë të hetimeve, veçanërisht për ato të nisura kryesisht, rritjes së numrit dhe përmirësimit të hetimeve dhe konfiskimeve të pastrimit të parave, bashkëpunimit të mirë e të vazhdueshëm me agjencitë ligj zbatuese të BE-së, progresit të shënuar në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të lidhura me krimin e organizuar, sigurimit dhe forcimit të etikës në punë nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore konkrete, si dhe avancimit të mëtejshëm të punës për plotësimin e kuadrit rregullator për vlerësimin e riskut të brendshëm lidhur me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, fuqizimit të kapaciteteve hetimore, përmirësimit të bazës logjistike në drejtim të ekspertimit të provave digjitale dhe përditësimit të laboratorit ekzistues etj.

Përmes kësaj Rezolute, Kuvendi ka dhënë gjithashtu edhe rekomandimet për SPAK, të cilat kanë qenë në fokus të veprimtarisë së saj për vitin 2024, në funksion të përmbushjes me përgjegjësi dhe efektivitet të funksioneve dhe detyrave në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi.

Rekomandimi nr. 1 - Të hartohet një strategji e posaçme për prioritizimin e çështjeve dhe procedimeve të mbartura.

Prioritizimi i çështjeve dhe procedimeve të mbartura është pjesë e objektivit 5.1 “reduktimi i çështjeve të mbartura”¹³, i parashikuar në Planin Strategjik 2024 - 2027 për Prokurorinë e Posaçme dhe në masat për zbatimin e kësaj strategjie. Në funksion të realizimit të këtij rekomandimi, Prokuroria e Posaçme ka draftuar në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë të projektit EU4LEA dokumentin strategjik “Udhërrëfyesi dhe Plani i veprimit për reduktimin e çështjeve të prapambetura në Prokurorinë e Posaçme për vitin 2024 - 2027”.

Ky dokument përshkruan hap pas hapi metodologjinë që duhet të ndiqet nga Prokuroria e Posaçme, duke përfshirë analizën për të identifikuar problemin, masat për zgjidhjen e problemit, monitorimin e zbatimit dhe sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë për të parandaluar përsëritjen e tij, me qëllim reduktimin e çështjeve të prapambetura. Përmbyllja e draftimit dhe miratimi i këtij Udhërrëfyesi janë pezulluar për shkak të përfundimit të projektit dhe priten të përfundohen brenda vitit 2025, përmes fondeve të buxhetit të shtetit ose të asistencës ndërkombëtare.

Rekomandimi nr. 2 - Të intensifikohen hetimet paralele financiare për rastet e krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm, terrorizmit dhe pastrimit të parave.

Në funksion të realizimit të këtij rekomandimi, Prokuroria e Posaçme, ka miratuar Udhëzimin e Përgjithshëm “Për masat administrative dhe procedurale për kryerjen e hetimit financiar dhe pasuror në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”¹⁴. Ky udhëzim përcakton nisjen paralelisht edhe të hetimit financiar, krahas hetimit për veprën penale të cilat janë në kompetencën e SPAK,

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i standardeve dhe unifikimi i mënyrës së ndjekjes së procedurave penale të ndërmarra nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe nga hetuesit e Sektorit të Hetimit Financiar, gjatë kryerjes së hetimit financiar dhe pasuror.

Rekomandimi nr. 3 - Të vijojë angazhimin në sigurimin e aplikimit të uniformizuar të standardeve të hetimit dhe ndjekjes penale, duke garantuar barazinë para ligjit.

Në funksion të realizimit të këtij rekomandimi Prokuroria e Posaçme, ka vijuar me punën e saj, që në të gjitha rastet të respektohen të gjitha garancitë kushtetuese dhe procedurale penale për të gjithë personat nën hetim/të pandehurit. Janë marrë të gjithë masat duke siguruar aplikimin e standardeve dhe garancive më të larta gjatë procesit të hetimeve paraprake. Aplikimi i standardeve uniforme është fokus i qartë i të gjithë prokurorëve të posaçëm, hetuesve të BKH-së dhe hetuesve financiarë, gjatë punës së tyre në hetimin dhe ndjekjen e çështjeve penale.

Në këtë pikëpamje, Prokuroria e Posaçme, gjatë vlerësimit të hetimeve penale që ka kryer gjatë vitit 2024, ka vlerësuar riskun dhe ka zbatuar masat e sigurimit duke ndjekur së pari parimin e

¹³ Plani Strategjik 2024-2027 për Prokurorinë e Posaçme dhe në masat për zbatimin e kësaj strategjie, miratuar me Urdhrin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme nr. 818, datë 3.9.2024. Marrë nga <https://spak.gov.al/korniza-strategjike/> fq. 17.

¹⁴ Shih Urdhrin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme nr. 1093., datë 11.11.2024. Marrë nga <https://spak.gov.al/udhezime-2/>

ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, ku theksojmë se të gjitha masat e sigurimit janë vlerësuar nga GJKKO. Prokuroria e Posaçme ka vijuar të mbajë të njëjtën qasje, si në vitet e mëparshme, në vendosjen e masave të sigurimit, duke garantuar kështu standardet e hetimit, shpërndarjen e tyre në mënyrë proporcionale në llojet e masave të aplikuar, në varësi të tipologjisë së çështjeve, rëndësisë dhe rrezikshmërisë së tyre.

Rekomandimi nr. 4 - Të vijohet me forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike me fokus hetimet financiare e të kriptovalutave.

Në funksion të realizimit të këtij rekomandimi si dhe në zbatim të planit të trajnimeve 2023-2026¹⁵, gjatë vitit 2024 janë zhvilluar trajnime në fushën e pastrimit të parave, duke përfshirë të gjitha temat që janë të lidhura me nenin 287 të Kodit Penal, hetimet paralele financiare, rikuperimin e aseteve dhe dispozitat e ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Këto trajnime janë zhvilluar në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtarë, Shkollën e Magjistraturës, agjenci të tjera ligj zbatuese si Agjencia e Inteligjencës Financiare apo Agjencia e Administrimit dhe Konfiskimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Prokurorët e posaçëm, hetuesit financiarë, hetuesit e BKH-së si dhe oficerët e policisë gjyqësore, kanë shprehur interes për pjesëmarrje në këto trajnime vazhdues, të cilat ofrojnë përfitësime me zhvillimet më të fundit në fushë si dhe shkëmbim eksperiencash me praktikantët më të mira ndërkombëtarë. Disa nga temat e trajnimeve të kryera këtë vit, me rëndësi për hetimet financiare dhe kriptovalutave, janë evidentuar si më poshtë:

- Monedhat virtuale dhe krimi kibernetik.
- Teknikat e hetimit financiar.
- Mbështetje për rikuperimin e pasurive në Ballkanin Perëndimor.
- Provat digjitale.
- Kriptovalutat.
- Asetet virtuale.
- Përmirësimi i aftësive financiare dhe të kontabilitetit për gjyqtarët dhe prokurorët.
- Tryezë e rumbullakët mbi komunikimet në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Rekomandimi nr. 5 - T’u kushtohet vëmendje krimeve zgjedhore, veçanërisht fakteve të bëra publike në media para, gjatë dhe pas procesit zgjedhor, për të filluar hetimin kryesisht në rastet kur ka njoftime publike për kryerjen e një veprë penale.

Në ushtrimin e hetimit të veprave penale në kuadër të krimit zgjedhor, si dhe në zbatim të këtij rekomandimi, Prokuroria e Posaçme, në bashkëpunim dhe me partnerët ndërkombëtarë, ka

¹⁵ Urdhër nr. 679, datë 09.10.2023 i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme “Për miratimin e planit të trajnimit të personelit administrativ sipas kategorive për vitin 2023-2026”.

miratuar “Strategjinë e Hetimit dhe Parandalimit të Krimit Zgjedhor gjatë Zgjedhjeve për Kuvendin 2025”¹⁶.

Në ndjekje të planit të masave, me qëllim zbatimin e ligjit, garantimin e transparencës zgjedhore dhe rritjen e besimit të publikut, janë parashikuar një sërë veprimesh, që do të kryhen nga SPAK për zgjedhjet parlamentare të vitit 2025. Një vëmendje e veçantë i kushtohet fakteve të bëra publike në media para, gjatë dhe pas procesit zgjedhor, me qëllim, nisjen e hetimit kryesisht, kur ka njoftime publike për kryerjen e një vepre penale. SPAK do të monitorojë edhe përdorimin e buxhetit dhe investimeve publike, të cilat nuk lejohen të kryhen gjatë periudhës zgjedhore nga subjektet e posaçme.

Kjo Strategji dhe plani i saj i veprimit, vënë theksin gjithashtu tek rëndësia e kontributit të institucioneve shtetërore dhe private, shoqërisë civile, mediave dhe qytetarëve, përmes angazhimit aktiv në mbështetje të këtij procesi.

Rekomandimi nr. 6 - Të tregohet një vëmendje e shtuar ndaj denoncimeve që vijnë nga publiku, si dhe të rritet numri i hetimeve të kryera nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme për çështje me ndjeshmëri të lartë publike.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në përmbushje të misionit të saj themelor, siç është lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përveç vijimit të hetimeve të referuara nga burime të ndryshme si, publiku, shoqëria civile, e organe të tjera ligj zbatuese, i ka kushtuar një rëndësi të veçantë regjistrimit të procedimeve kryesisht.

Në zbatim të këtij rekomandimi Prokuroria e Posaçme edhe gjatë vitit 2024, është angazhuar që çdo denoncim i paraqitur nga qytetarët të adresohet menjëherë më të njëjtën mënyrë sikundër denoncimet zyrtare, gjithashtu, çdo çështje me ndjeshmëri publike analizohet menjëherë, merr drejtim në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse. Koordinatori për Marrëdhënien me Mediat, me porosi të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, i adreson qytetarët që i janë drejtuar institucionit të raportojnë/kallëzojnë çdo problematikë të paraqitur drejt strukturave të specializuara të Prokurorisë së Posaçme, të cilat orientohen për hapat e mëtejshëm.

Rekomandimi nr. 7 - Të angazhohet në plotësimin e vakancave me qëllim funksionimin me efikasitet të plotë të Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Në funksion të realizimit të këtij rekomandimi, Prokuroria e Posaçme është angazhuar për plotësimin e vendeve të paplotësuara, me qëllim funksionimin me efektivitet të plotë. Ajo ka vijuar me ndjekjen e procedurave ligjore për plotësimin e vendeve të paplotësuara, sipas sektorëve dhe drejtorive përkatëse, duke e vënë prioritetin tek sektorët ku ka pasur më shumë ndjeshmëri. Gjatë vitit 2024, në Prokurorinë e Posaçme kanë ushtruar detyrën 114 punonjës, nga të cilët 20 prokurorë

¹⁶ Urdhër nr. 2419, datë 24.01.2025 i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme “Për miratimin e Strategjisë së Hetimit dhe Parandalimit të Krimit Zgjedhor gjatë Zgjedhjeve për Kuvendin 2025”¹⁶.

të emëruar, 12 hetues financiarë, 80 punonjës administrativë dhe 2 punonjës me kontratë të përkohshme.

Në mënyrë specifike, gjatë këtij viti janë shpallur dhe zhvilluar procedura të punësimit për 12 pozicione pune dhe janë punësuar 11 punonjës, nga të cilët:

- 3 punonjës janë emëruar me kontratë pune, nga të cilët: 1 Koordinator për Marrëdhënien me Mediat pranë Kabinetit të Drejtuesit, 1 Ekspert dhe 1 punonjës informacioni në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse;
- 8 punonjës të emëruar me procedura sipas ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”, nga të cilët: 3 punonjës të emëruar me procedurën “pranim në shërbimin civil”, 2 punonjës të emëruar me procedurën “lëvizje paralele” dhe 3 punonjës të emëruar me procedurën “ngritje në detyrë”;
- 2 punonjës me kontratë pune, me kohëzgjatje 6 orë në ditë, me afat 1 vjeçar, në mbështetje të VKM nr. 39, datë 24.01.2024 “Për përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024, në njësitë e qeverisjes së qendrore”.

Disa pozicione të paplotësuara ende, për shkak të kufizimeve logjistike (pamjaftueshmëria e ambienteve dhe zyrave) janë planifikuar të zhvillohen gjatë vitit 2025. Gjatë vitit 2024, janë zhvilluar gjithashtu edhe procedurat e nevojshme si rezultat i largimit të punonjësve ekzistues, mbushjes së moshës për pension pleqërie apo për arsye të tjera objektive.

Për sa i takon BKH-së, struktura organizative e saj është miratuar me Urdhrin e Përbashkët nr. 978 prot., datë 28.12.2023, të Drejtorit të BKH-se dhe nr. 1090/4, prot., datë 28.12.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme “Për Organizimin e Brendshëm të Byrosë Kombëtare të Hetimit”. Në këto akte janë përcaktuar 138 pozicione pune, nga të cilët, 1 pozicion drejtori, 110 hetues dhe oficerë të shërbimeve të policisë gjyqësore dhe 27 punonjës administrativë.

Gjatë vitit 2024 janë shpallur procedurat për 13 funksione administrative, nga të cilët:

- 4 funksione janë plotësuar dhe punonjësit administrativë kanë përmbushur edhe kushtin e sigurisë;
- për 5 funksione janë kryer procedurat e shërbimit civil, por kandidatët janë ende në proces verifikimi të kushteve të sigurisë;
- janë kryer procedurat e parashikuara për shërbimin civil për 4 funksione, por ato nuk kanë rezultuar me kandidatë fitues dhe janë anuluar.

Bazuar në strukturën aktuale, viti 2024 është mbyllur me disa vakanca: 1 në kabinetin e Drejtorit të BKH-së, 50 në pozicionet e shërbimeve të policisë gjyqësore, 40 hetues dhe 11 në stafin administrativ.

Rekomandimi nr. 8 - Të përmbyllë procesin e hartimit dhe miratimit të akteve të tjera nënligjore, të cilat rezultojnë të pa miratuara, për të përfunduar plotësimin e kornizës strategjike institucionale .

Gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka hartuar dhe miratuar një sërë aktesh nënligjore për mirëfunksionimin e veprimtarisë institucionale, në funksion të përforsimit të kuadrit rregullator të institucionit saj, siç janë:

- Plani Strategjik 2024-2027, për Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
- Strategjia e TIK-ut dhe Sigurisë Kibernetike.
- Strategjia e Komunikimit me Median 2025-2028.
- Strategjia e Hetimit dhe Parandalimit të Krimit Zgjedhor.

Janë miratuar gjithashtu edhe akte nënligjorë të rëndësishme si:

- Urdhër nr. 130, datë 6.2.2024 për Miratimin e Rregullores për Hetimin Administrativ të Sinjalizimit dhe Mbrojtjes së Konfidencialitetit.
- Urdhër nr. 131, datë 6.2.2024 për Miratimin e Rregullores për Hetimin Administrativ të Kërkesës së Sinjalizuesit për Mbrojtjen nga Hakmarrja.
- Urdhër nr. 134, datë 7.2.2024 për Miratimin e Dokumentit “Strategjia e Burimeve Njerëzore për vitin 2024-2026, në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”.
- Udhëzimi i Përgjithshëm “Për masat administrative dhe procedurale për kryerjen e hetimit financiar dhe pasuror në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”
- Udhëzimi i Përbashkët ndërmjet Prokurorisë së Posaçme, Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme për përcaktimin e Rregullave të Detajuara për Formën e Kërkesës, Procedurën dhe Përkthimin e Akteve në Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale, nënshkruar më datë 01.08.2024.
- Rregullore e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë së Posaçme.
- Urdhër nr. 645, datë 17.07.2024 për Miratimin e Dokumentit “Për Fillimin e Fazës së Pilotimit të Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Dosjeve”.
- Urdhër nr. 726, datë 07.08.2024 për Miratimin e Dokumentit “Për Miratimin e Procedure Standarde të Punës për Përdorimin e Armëve të Zjarrit nga Punonjësit e BKH dhe Procedurave Standarde të Punës për Përdorimin e Forcës nga Punonjësit e BKH”.

Janë hartuar gjithashtu dhe priten të miratohen në vitin 2025, “Udhërrëfyeni dhe Plani i veprimit për reduktimin e çështjeve të prapambetura në Prokurorinë e Posaçme për vitin 2024-2027” si dhe Udhëzimi i Përgjithshëm “Për qarkullimin e brendshëm të dosjeve”.

Rekomandimi nr. 9 - Të angazhohet në pilotimin dhe testimin e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve me qëllim vënien në efikasitet brenda vitit 2024 duke pasur parasysh rëndësinë e këtij sistemi në punën e prokurorëve dhe hetuesve të strukturës.

Në funksion të realizimit të këtij rekomandimi, gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka vijuar të ndjekë me përparësi pilotimin dhe testimin e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve. Objektivi i përgjithshëm është zhvillimi dhe implementimi i një sistemi të menaxhimit të gjitha çështjeve të trajtuara nga SPAK, krijimin e një regjistri elektronik /baze të dhënash, i cili mundëson ndjekje

dhe administrim më të mirë të çështjeve, ndarje më të mirë të detyrave dhe përgjegjësi midis Prokurorëve, Hetuesve të BKH, zyrës së regjistrimit, komunikimin me gjykatën dhe analizimin e këtij informacioni, për të nxjerrë raporte dhe statistika të sakta dhe në kohë reale. Mbi të gjitha për të krijuar një bazë të dhënash të domosdoshme për përditshmërinë, por edhe vazhdimësinë e punës.

Sistemi ka një ndërtim modular dhe ka përfunduar zhvillimi/ndërtimi i moduleve. Aktualisht është bërë e mundur vënia në funksion e këtij sistemi pothuajse në tërësinë e moduleve të tij (Portali, Protokoli, Zyra e Drejtuesit, Prokurori, Regjistri dhe Hetuesi). Brenda vitit 2025 parashikohet të përfundojë vënia në funksion edhe e moduleve të tjera si, raporte e statistika, regjistri i ekzekutimeve dhe regjistri i letër porosive, si dhe të fillojë zbatimin e sistemit elektronik të Menaxhimit të Çështjeve.

Rekomandimi nr. 10 - Të angazhohet për përmbushjen me efektivitet të detyrimeve institucionale në kuadër të raportimeve gjatë procesit të integritetit në Bashkimin Evropian.

Në funksion të realizimit të këtij rekomandimi, Prokuroria e Posaçme ka përmbushur me efektivitet të gjitha detyrimet institucionale në kuadër të raportimeve gjatë procesit të integritetit në BE. Gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka punësuar/rekrutuar 2 specialiste për Raportimet pranë Bashkimit Evropian, në Sektorin e Raportimeve pranë Bashkimit Evropian, me qëllim angazhimin maksimal dhe me shumë prioritet të raportimeve në drejtim të integritetit të vendit në BE.

Gjatë vitit 2024, SPAK, ka kontribuar në raportime përmes përcjelljes dhe analizës së të dhënave statistikore, dhënies së mendimeve/rekomandimeve, ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve vendase dhe ndërkombëtare, në kuadër të:

- Progresi i Raportit Vjetor të Komisionit Evropian;
- Nënkomitetit “Drejtësia Liria dhe Siguria”;
- Raportimeve periodike për Kapitullin 23 dhe 24;
- Udhërrëfyesit të Shtetit të së Drejtës, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 736 datë 13.12.2023;
- Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 787, datë 18.12.2023;
- Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024-2030, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 859, datë 26.12.2024;
- Strategjisë Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1140, datë 24.12.2020;
- Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 729, datë 13.12.2023;
- Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024-2030, të miratuar me Vendimin nr. 1, datë 24.07.2024, të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave;
- Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Terrorizmit 2023-2025;

- Takimit të 18-të i Komisionit Parlamentar të Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri, i organizuar në datë 29 tetor 2024.
- Përditësimet e të dhënave për periudha të ndryshme raportimi.

Po kështu, gjatë vitit 2024, SPAK ka dhënë kontribut në kohë në raportimet në kuadër të procesit të integritetit në BE, përmes pjesëmarrjes aktive në aktivitet, takimet dhe trajnimet si më poshtë:

- Nënkomiteti BE – Shqipëri për Drejtësi, Liri dhe Siguri, në Bruksel;
- Takimet bilaterale për shtetin e së drejtës, Bruksel;
- Këshillit Kombëtar i Integritetit Evropian;
- Tryezat e organizuara nga Ministri i Drejtësisë në kuadër të Pozicionit të Përbashkët të BE-së;
- Tryezat e organizuara nga Agjencia e Inteligjencës Financiare në kuadër të Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës “Për funksionimin e Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave” dhe Strategjisë Kombëtare “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit 2024-2030”, etj.;
- Takimet e organizuara nga Agjencia e Inteligjencës Financiare mbi kontributin që duhet të japin autoritetet shqiptare për Prospektusin e EUROBOND.

ZBATIMI I REKOMANDIMEVE PRIORITARE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMINALITETIT

Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 243, datë 17.4.2024 ka vlerësuar punën e SPAK për vitin 2023 në drejtim të forcimit të besimit të publikut tek drejtësia e re, në forcimin e bashkëpunimit me organet e tjera ligj zbatuese brenda dhe jashtë vendit, në intensifikimin e ndërveprimit me autoritetet gjyqësore vendase dhe të huaja si dhe në vendosjen e bashkëpunimit me organizmat dhe partnerët rajonalë e ndërkombëtarë. Ai ka miratuar gjithashtu rekomandimet prioritet për SPAK për vitin 2024, të cilat janë ndjekur dhe përmbushur nga SPAK si më poshtë.

Rekomandimet sa i përket luftës kundër korrupsionit

Rekomandimi nr. 1 - Rritjen e numrit dhe të cilësisë së hetimeve për veprat penale në fushën e korrupsionit, referuar kompetencës lëndore të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme, duke mbajtur në konsideratë ndarjen e kompetencës lëndore për këto vepra me qëllim garantimin e efektivitetit dhe shpejtësisë në hetimin e çështjeve.

Ky rekomandim është përmbushur si në terma cilësorë ashtu edhe në terma sasiorë.

Për sa i përket **luftës kundër korrupsionit**, Prokuroria e Posaçme ka ndjekur një qasje aktive duke hetuar një numër të konsiderueshëm zyrtarësh të lartë. Gjatë vitit 2024, rezultojnë ish - 33 zyrtarë të lartë nën hetim (ku dy prej tyre janë të regjistruar në dy procedime të ndryshme secili), nga të cilët 19 zyrtarë janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim. Nga numri total i ish-zyrtarëve të lartë nën hetim, 19 prej tyre janë dërguar në gjykatë, që përfaqëson 52,9% të rasteve.

Lidhur me volumin e çështjeve nën hetim për veprat penale në fushën e korrupsionit, gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka shënuar një rritje me rreth 8% krahasuar me vitin paraardhës (nga

447 çështje nën hetim për vitin 2023 në 483 çështje nën hetim për vitin 2024). Po kështu, është rritur me rreth 20%, edhe numri i personave të cilët që kanë qenë nën hetim për vitin 2024 në krahasim me ata të vitit paraardhës (nga 212 persona nën hetim në vitin 2023, në 257 persona nën hetim në vitin 2024). Rritje në masën rreth 8% ka shënuar gjithashtu, edhe numri i hetimeve të përfunduara dhe të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2023 (nga 38 në vitin 2023, në 41 në vitin 2024).

Rekomandimi nr. 2 - Rritjen e rasteve të përdorimit me efikasitet të teknikave pro aktive të hetimit për aq sa është e mundur, vijimin e rritjes së numrit të personave të hetuar dhe të dërguar për gjykim për këto vepra penale, si dhe ndjekjen me vendosmëri të kërkimeve për dënimin e autorëve të këtyre veprave.

Rekomandimi nr. 3 - Rritjen e numrit të hetimeve të çështjeve të filluara kryesisht, rekomandim i përsëritur ndër vite (numri i të cilave vijon të jetë i ulët), me qëllim rritjen e rolit të prokurorit në drejtimin dhe kontrollin e hetimit.

Në përgjigje të Rekomandimeve nr. 2 dhe 3 të Këshillit të Ministrave, Prokuroria e Posaçme ka ruajtur të njëjtin trend pozitiv edhe në qasjen pro aktive të hetimeve, ku gjatë vitit 2024, janë regjistruar 65 hetime të nisura kryesisht.

Në kuadër të përdorimit dhe rritjes së metodave proaktive për ndjekjen e hetimeve penale, theksojmë se bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë si metodë hetimi, nëpërmjet krijimit të skuadrave të përbashkëta hetimore, është intensifikuar. Vetëm gjatë vitit 2024, ndërmjet Prokurorisë së Posaçme dhe shteteve të huaja janë krijuar 10 skuadra të përbashkëta hetimore të reja, nga 27 skuadra në total, të cilat janë aktive në Prokurorinë e Posaçme, që nga krijimi i saj.

Në mënyrë specifike, kërkesat për ndihmë juridike të ardhura nga jashtë vendit janë rritur me 45,8% (nga 48 në vitin 2023, në 70 në vitin 2024) ndërsa kërkesat për ndihmë juridike të dërguara jashtë vendit janë rritur me 34,7% (nga 121 në vitin 2023, në 163 në vitin 2024). Për sa i përket skuadrave të përbashkëta hetimore me autoritetet e huaja, gjatë vitit 2024 janë ngritur 10 skuadra të reja, ndërkohë që vijojnë hetimet edhe në kuadër të 27 skuadrave të përbashkëta hetimore të ngritura në periudhën paraardhëse.

Po kështu theksojmë se, ka pasur një rritje të aplikimit të metodave të hetimit pro aktiv, në rastin e përgjimeve telefonike dhe gjithashtu, edhe aplikimi i metodave të posaçme të hetimit si, vëzhgime, kontrole, simulime, sekuestrimi i provave materiale, letër porosi, agjentë të infiltruar, etj.

Gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka përdorur metodën e përgjimit për 163 procedime penale ku janë interceptuar 3096 pajisje fundore (pajisja/numri telefonik i subjektit në përgjim). Krahasuar me vitin 2023, numri i pajisjeve fundore të interceptuara është 7,1% më i ulët (3335 pajisje fundore të interceptuara gjatë vitit 2023).

Për vitin 2024 janë ekzekutuar 2046 vendime gjykate, e cila shënon një rritje në masën rreth 22,6% (në krahasim me 1669 vendime gjykate për vitin 2023).

Rekomandimi nr. 4 - Rritjen e numrit të hetimeve financiare sistematike për veprat penale që gjenerojnë produkte/të ardhura, duke mbajtur në konsideratë fillimin e hetimit financiar paralel në momentin e regjistrimit të procedimit penal.

Rekomandimi nr. 5 - Shtimin e rasteve të gjurmimit të produkteve të veprave penale/aseteve dhe rritjen e numrit të sekuestrimeve/konfiskimeve, përfshirë rastet e tjetërsimit të tyre nga persona të tretë; si dhe bashkëpunimin me institucionet përkatëse për menaxhimin e këtyre produkteve/aseteve

Në përgjigje të Rekomandimeve nr. 4 dhe 5 të Këshillit të Ministrave, siç dhe Raport-Progresi i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2024) evidenton, “Kapaciteti i SPAK-ut në hetimet financiare **është rritur** dhe përdorimi sistematik i hetimeve financiare dhe sekuestrimeve të pasurisë është përmirësuar”¹⁷.

Prokuroria e Posaçme ka miratuar gjithashtu, Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 1093, datë 11.11.2024 “Për masat administrative dhe procedurale për kryerjen e hetimit financiar dhe pasuror në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”¹⁸. Prokuroria e Posaçme në zbatim të ligjit, ka ushtruar fillimin e hetimit financiar dhe pasuror paralel në pjesën më të madhe të hetimeve penale.

Prokuroria e Posaçme kryen veprimtarinë e saj në bashkëpunim të ngushtë me agjencitë e zbatimit të ligjit vendase dhe të huaja. Në funksion të menaxhimit të aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara, Prokuroria e Posaçme vijon bashkëpunimin e ngushtë me Agjencinë e Administrimit dhe Konfiskimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Sikurse evidentohet nga të dhënat statistikore, rezulton se në vitin 2024, numri i procedimeve të regjistruara në kuadër të luftës kundër “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” nga ana Prokurorisë së Posaçme, është rritur me 34% në krahasim më vitin 2023 (nga 35 në vitin 2023, në 47 në vitin 2024), ndërsa krahasimisht me vitin 2021, këto procedime janë mbi trefishuar. Konkretisht, në vitin 2021 ishin regjistruar 15 procedime për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” ndërsa, në vitin 2024 ky numër është mbi trefishuar duke arritur në 47 procedime.

Hetimet pasurore dhe financiare janë konsideruar prioritet i Prokurorisë së Posaçme, qasje e cila është reflektuar edhe në rritjen e vlerës së aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara gjatë vitit 2024, në vlerën prej rreth 65,5 milion euro. Prej tyre, vlera e pasurive të sekuestruara është në shumën rreth 28,7 milion euro, ndërkohë që për pasuritë e konfiskuara kjo vlerë arrin në shumën rreth 36,8 milion euro. Kështu vëllimi i aseteve të sekuestruara zë rreth 43,8% të vlerës totale, ndërsa pasuritë e konfiskuara zënë rreth 56,2% të vlerës totale. Krahasuar me vitin 2023, vihet re një rritje në masën rreth 59,7% e vlerës totale të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara (rreth 65,5 milion euro në vitin 2024, kundrejt rreth 41 milion euro në vitin 2023).

¹⁷ Komisioni Evropian (2024). Dokument i Punës i Stafit të Komisionit: Raporti i Shqipërisë 2024. Shoqëruar me Komunikatën për Politikën e Zgjerimit të BE-së. Marrë nga: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf, fq. 6.

¹⁸ Shih në linkun <https://spak.gov.al/udhezime-2/>

Rekomandimi nr. 6 - Vijimin e zhvillimit të kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe të oficerëve të policisë gjyqësore nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me fokus në luftën kundër korrupsionit me agjencitë e zbatimit të ligjit; si dhe hetimeve pasurore veçanërisht me fokus në format e reja të nxitura nga zhvillimet teknologjike.

Në zbatim të planit të trajnimeve 2023-2026¹⁹, gjatë vitit 2024 janë parashikuar dhe kryer trajnime specifike sa i përket hetimeve financiare dhe kriptovalutave. Ato janë zhvilluar në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, agjencitë ligj zbatuese vendase (si Agjencia e Inteligjencës Financiare, Agjencia e Administrimit dhe Konfiskimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara) si dhe të huaja (si FBI, Eurojust etj.). Gjatë kësaj periudhe, Prokuroria e Posaçme ka zhvilluar gjithashtu takime me donatorë ndërkombëtarë të cilët ofrojnë ekspertizë për mbështetje në fusha të ndryshme të trajnimeve dhe veçanërisht në fushën e hetimit financiar. Ekspertiza e marrë në këto trajnime ka shërbyer për identifikimin e transaksioneve të kryera në sistemin e kriptovalutave, duke aplikuar formula efikase në hetimet financiar, si dhe duke përdorur metodat më të mira për kryerjen e analizës financiare.

Rekomandimet sa i përket luftës kundër krimit të organizuar

Rekomandimi nr. 1 - Rritjen e numrit të procedimeve të regjistruara dhe të dërguara për gjykim dhe cilësisë së hetimit për veprat penale në fushën e narkotikëve dhe trafikeve të paligjshme, si dhe ashpërsimin e politikës së dënimit dhe masave të sigurimit personal për këto vepra penale.

Gjatë vitit 2024 numri i çështjeve të regjistruara nga Prokuroria e Posaçme për veprën penale të trafikut të drogës, në kuadrin e grupit të strukturuar kriminal, është 35 çështje me 35 persona nën hetim. Numri i çështjeve nën hetim për këtë vepër penale gjatë këtij viti (mbartur dhe regjistruar gjatë vitit 2024), është 124 çështje me 72 persona nën hetim. Gjatë vitit 2024, numri i këtyre çështjeve të dërguara në gjykatë me kërkesë për gjykim, është 5 çështje me 33 të pandehur.

Krahasuar me vitin 2023, numri i çështjeve nën hetim për veprën penale të trafikut të drogës, në kuadrin e grupit të strukturuar kriminal, (283/a/2, 333/a, 334) është rritur në masën 3,3% (nga 120 në vitin 2023 në 124 në vitin 2024).

Rekomandimi nr. 2 - Marrjen e masave për evidentimin dhe rritjen e numrit të procedimeve për veprat penale në fushën e terrorizmit, përfshirë dhe rastet e mbrojtjes së sigurisë kombëtare, veçanërisht duke mbajtur në konsideratë zhvillimet ndërkombëtare.

Për sa i përket numrit të procedimeve për veprat penale në fushën e terrorizmit në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, gjatë vitit 2024 rezulton të jetë 2 çështje nën hetim (e mbartur dhe regjistruar). Është dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim për veprën penale të financimit të terrorizmit neni 230/a, 1 çështje me 1 person të pandehur.

¹⁹ Urdhër nr. 679, datë 09.10.2023 i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme “Për miratimin e planit të trajnimit të personelit administrativ sipas kategorive për vitin 2023-2026”. Marrë nga: <https://spak.gov.al/kuadri-ligjor-regullator/>

Rekomandimi nr. 3 - Rritjen e numrit dhe cilësisë së hetimeve financiare për veprat penale të pastrimit të parave dhe produkteve të veprës penale dhe atë në funksion të rritjes së numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim, si dhe rritjes së numrit të sekuestreimeve/konfiskimeve.

Lidhur me këtë rekomandim, vlejné konsideratat e evidentuara më lart në zbatimin e rekomandimeve nr. 4 dhe nr. 6 të Këshillit të Ministrave. Për sa i përket miratimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 1093, datë 11.11.2024 “Për masat administrative dhe procedurale për kryerjen e hetimit financiar dhe pasuror në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, ky akt nënligjor përbën rëndësi sa i përket intensifikimit të hetimeve paralele financiare, mënyrës së hetimit nga prokurorët e posaçëm, oficerët e BKH-së dhe hetuesit financiarë si dhe përcaktimit të rregullave të qarta lidhur me mënyrën dhe procedurën e hetimit financiar.

Në kuadër të rritjes së cilësisë së hetimeve financiare, theksohet zbatimi i planit të trajnimeve 2023-2026²⁰ i miratuar nga Prokuroria e Posaçme, ku janë parashikuar dhe kryer trajnime specifike në fushën e hetimeve financiare, përfshirë ato që lidhen me pastrimin e parave dhe produkteve të veprës penale.

Krahasuar me vitin 2023, vihet re një rritje në masën me rreth 34% i numrit të procedimeve të regjistruara në kuadër të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” (nga 35 procedime në vitin 2023, në 47 procedime në vitin 2024).

Në vijim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Prokuroria e Posaçme ka arritur të sekuestrojë dhe konfiskojë gjatë vitit 2024 një portofol të diversifikuar asetesh. Këtu përfshihen pasuri të paluajtshme, vlera monetare, kuota tregtare si dhe portofole kriptovalutash në një vlerë totale prej rreth 65,5 milion eurosh. Prej tyre, vlera e pasurive të sekuestruara zënë rreth 43,8% të totalit, ndërsa pasuritë e konfiskuara zënë rreth 56,2% të vlerës totale. Krahasuar me vitin 2023, vihet re një rritje në masën rreth 59,7% e vlerës totale të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara (rreth 65,5 milion euro në vitin 2024 kundrejt rreth 41 milion euro në vitin 2023).

Rekomandimi nr. 4 - Vijimin e zbatimit të masave për përmbushjen e rekomandimeve të MONEYVAL për pastrimin e parave/luftimin e financimit të terrorizmit, të bashkëpunimit me Eurojust, si dhe të bashkëpunimit rajonal në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore.

Kontributi i SPAK në luftën kundër pastrimit të parave është vlerësuar më herët si faktor kryesor në rezultatin për daljen e Shqipërisë nga lista e vendeve nën monitorim të shtuar ndryshe “lista gri”. Gjatë gjithë vitit 2024 zbatimi i masave në përmbushje të rekomandimeve të MONEYVAL ka qenë ndër objektivat kryesorë duke raportuar në vijimësi për ecurinë e zbatimit të tyre në bashkëpunim të ngushtë edhe me Agjencinë e Inteligjencës Financiare.

²⁰ Urdhër nr. 679, datë 09.10.2023 i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme “Për miratimin e planit të trajnimit të personelit administrativ sipas kategorive për vitin 2023-2026”. Marrë nga: <https://spak.gov.al/kuadri-ligjor-regullator/>

Prokuroria e Posaçme, për secilën kategori të veprave penale që janë në kompetencën e saj, vijon të kryejë hetim financiar dhe pasuror paralel, i cili sjell për pasojë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të autorëve të veprave penale.

Lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar, nën koordinimin edhe të Eurojust, edhe gjatë vitit 2024 ka vijuar bashkëpunimi i frytshëm sa i përket krijimit të skuadrave të reja të përbashkëta hetimore dhe vazhdimit të veprimtarisë së atyre ekzistuese. Vetëm gjatë vitit 2024, ndërmjet Prokurorisë së Posaçme dhe autoriteteve të huaja janë krijuar 10 skuadra të përbashkëta hetimore të reja. Në total, numri i skuadrave të përbashkëta hetimore aktive në Prokurorinë e Posaçme, që nga krijimi i saj deri në vitin 2024, është 27. Gjatë vitit 2024, veprimtaria e këtyre skuadrave është fokusuar në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit, përfshirë edhe trafikimin e qenieve njerëzore.

Në kuadër të veprimtarisë së Skuadrave të Përbashkëta Hetimore, gjatë vitit 2024 janë mbajtur 18 takime koordinuese me autoritetet e huaja palë në këto skuadra, përveç mbledhjeve të përbashkëta të realizuara nëpërmjet video-konferencës. Kjo veprimtari ka çuar në regjistrimin e 166 shtetasve si persona nën hetim si dhe në vendosjen nga ana e gjykatave të 147 masave të sigurimit personal.

Vlen të theksojmë se gjatë vitit 2024, është rritur ndjeshëm edhe komunikimi i drejtpërdrejtë i Prokurorisë së Posaçme me autoritetet homologe evropiane, amerikane, të Rajonit dhe të Amerikës së Jugut. Po kështu, është intensifikuar shkëmbimi i informacionit nëpërmjet rrjeteve dhe kanaleve të sigurta të komunikimit me Eurojust, Interpol, Europol etj. Ka vijuar gjithashtu komunikimi intensiv me prokurorët dhe oficerët ndërlidhës që mbulojnë Shqipërinë, të atashuar pranë Ambasadave të huaja në Tiranë, apo jashtë Shqipërisë, duke forcuar bashkëpunimin dhe rritur efektivitetin në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Rekomandimi nr. 5 - Marrjen e masave për rritjen e rasteve të përdorimit të teknikave speciale të hetimit, veçanërisht në rastet e hetimeve pasurore, por dhe në rastet e trafikimit dhe krimit të organizuar.

Gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka përdorur metodën e përgjimit për 163 procedime penale ku janë interceptuar 3096 pajisje fundore (pajisja/numri telefonik i subjektit në përgjim). Krahasuar me vitin 2023, numri i pajisjeve fundore të interceptuara është 7,1% më i ulët (3335 pajisje fundore të interceptuara gjatë vitit 2023). Për vitin 2024 janë ekzekutuar 2046 vendime gjyqësore, e cila shënon një rritje në masën rreth 22,6% (në krahasim me 1669 vendime gjyqësore për vitin 2023).

Rekomandimi nr. 6 - Vijimin e forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet strukturave të prokurorisë së juridiksioneve të përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme, policisë gjyqësore, policisë së shtetit dhe agjencive të tjera shtetërore, për zbatimin e objektit dhe qëllimin e ligjit për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike.

Prokuroria e Posaçme ka vijuar bashkëpunimin ndërinstitucional me Prokurorinë e Përgjithshme, prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, policinë gjyqësore, policinë e shtetit dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit. Ky bashkëpunim ka qenë i vazhdueshëm dhe pa pengesa, në funksion të

zbatimit të ligjit për luftën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, parandalimit dhe ndëshkimit të autorëve të veprave të tilla penale.

Gjatë vitit 2024, numri i hetimeve të filluara nga Prokuroria e Posaçme për shkak të kallëzimeve nga institucionet publike është ka pësuar një rritje me rreth 66,6 % krahasuar me vitin paraardhës (nga 12 në vitin 2023, në 20 në vitin 2024), ndërkohë që hetimet e filluara për shkak të kallëzimeve nga policia e shtetit kanë pësuar një rënie në masën rreth 70,8%. Për këtë periudhë, pranë Prokurorisë së Posaçme janë depozituar në total 300 kallëzime penale, prej të cilave rreth 8,3% e rasteve nuk kanë qenë në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme.

Në funksion të ndjekjes penale dhe në respektim të dispozitave ligjore të ndarjes së kompetencës lëndore për veprat penale, gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme, pasi ka kryer hetimet e plota, ka transferuar pranë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore 87 procedime penale me 114 persona të nën hetim. Ky numër procedimesh është i njëjtë me atë të vitit paraardhës.

Rekomandimi nr. 7 - Vijimin e forcimit të bashkëpunimit me organet ligj zbatuese ndërkombëtare, në kuadër të forcimit të luftës kundër krimit të organizuar, trafikimit dhe krimeve të tjera të rënda.

Me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka nënshkruar 3 marrëveshjeve të reja bashkëpunimi me prokuroritë e shteteve të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe Rajonit dhe konkretisht:

- ✓ Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare kundër Krimit të Mbretërisë së Bashkuar të Mbretërisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (NCA) dhe Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nënshkruar më datë 22.02.2024;
- ✓ Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Bashkëpunimin ndërmjet Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Republikës së Shqipërisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Mbretërisë së Spanjës, nënshkruar më datë 11.04.2024;
- ✓ Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Bashkëpunimin ndërmjet Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Republikës së Shqipërisë dhe Prokurorisë Speciale të Malit të Zi, nënshkruar më datë 17.12.2024.

Gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka vijuar bashkëpunimin ndërkombëtar me autoritet e huaja, bazuar në konventat e Këshillit të Evropës dhe Konventat e të Kombeve të Bashkuara, si dhe në marrëveshjeve dypalëshe ku Republika e Shqipërisë është palë.

Për nevoja të hetimeve në kuadër të forcimit të luftës kundër krimit të organizuar, trafikimit dhe krimeve të tjera të rënda, gjatë këtij viti Prokuroria e Posaçme i ka dërguar autoriteteve gjyqësore të huaja 163 kërkesa për ndihmë juridike të ndërsjellë dhe ka trajtuar gjithashtu 70 kërkesa për ndihmë juridike të ndërsjellë, të transmetuara nga autoritetet gjyqësore të huaja.

Ndarja sipas objektit të këtyre 70 kërkesave është si vijon: 60 kërkesa me objekt kryerjen e veprimeve të ndryshme hetimore; 7 kërkesa me objekt kontroll ambientesh; 3 kërkesa me objekt sekuestrimin e pasurive.

Nga totali i kërkesave të transmetuara nga autoritetet e huaja janë ekzekutuar 56 kërkesa për ndihmë juridike. Ndërkohë 14 kërkesa për ndihmë juridike të cilat janë administruar në fund të vitit 2024, janë mbartur në vitin 2025 dhe janë në fazë ekzekutimi.

Rekomandimi nr. 8 - Rritjen e kapaciteteve profesionale për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore nëpërmjet trajnimeve të posaçme në këtë fushë, duke përfshirë edhe trajnime të përbashkëta me struktura të tjera ligj zbatuese.

Lidhur me këtë rekomandim, vlejnë konsideratat e evidentuara më lart në zbatimin e Rekomandimeve nr. 3, nr. 4 dhe nr. 6 të Këshillit të Ministrave. Për sa i përket miratimit të udhëzimit të përgjithshëm nr.1093, datë 11.11.2024 “Për masat administrative dhe procedurale për kryerjen e hetimit financiar dhe pasuror në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”, ky akt nënligjor përbën rëndësi sa i përket intensifikimit të hetimeve paralele financiare por dhe mënyrës së hetimit nga prokurorët e posaçëm, oficerët e BKH-së si dhe hetuesit financiarë, pasi përcakton rregulla të qarta dhe të sakta lidhur me mënyrën dhe procedurën e hetimit financiar. Lidhur me zbatimin e planit të trajnimeve 2023-2026²¹, janë parashikuar dhe kryer trajnime specifike në fushën e hetimeve financiare, përfshirë ato në kuadër të forcimit të luftës kundër krimit të organizuar, trafikimit dhe krimeve të tjera të rënda.

Rekomandimi nr. 9 - Përditësimin e sistemit statistikor të monitorimit të çështjeve të pastrimit të parave dhe asetëve të sekuestruara për të siguruar tregues efektivë dhe të matshëm të punës së kryer në hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin për këto vepra penale.

Gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka vendosur në funksion pothuajse në tërësinë e moduleve të tij (Portali, Protokolli, Zyra e Drejtuesit, Prokurori, Regjistri dhe Hetuesi), Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Çështjeve, i cili do të përmirësojë edhe përditësimin e të dhënave statistikore. Gjatë vitit 2025 parashikohet të përfundojë vënien në funksion edhe e moduleve të tjera si, raporte e statistika, regjistri i ekzekutimeve dhe regjistri i letër porosive si dhe të fillojë zbatimin e këtij sistemi.

Lidhur me përditësimin e të dhënave statistikore, gjatë këtij viti, numri i çështjeve të regjistruara në Prokurorinë e Posaçme për veprat penale të parashikuara nga nenet 287, 287/a, 287/b, pastrimi produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale të kryera në kuadër të grupit të strukturuar kriminal është 38 çështje, me 37 persona nën hetim.

Ndërkohë, numri i çështjeve nën hetim gjatë vitit 2024 (mbartur dhe regjistruar) për veprat penale të parashikuara nga nenet 287, 287/a, 287/b, të kryera në kuadër të grupit të strukturuar kriminal është 90 çështje, me 49 persona nën hetim.

Për sa i përket, numrit të çështjeve të dërguara në gjykatë me kërkesë për gjykim për vitin 2024, për veprat penale të parashikuara nga nenet 287, 287/a, 287/b për vitin 2024, të kryera në kuadër të grupit të strukturuar kriminal është 3 çështje, me 8 të pandehur.

²¹ Urdhër nr. 679, datë 09.10.2023 i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme “Për miratimin e planit të trajnimit të personelit administrativ sipas kategorive për vitin 2023-2026”. Marrë nga: <https://spak.gov.al/kuadri-ligjor-regullator/>

Sikundër evidentuar edhe në komentet e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave mbi luftën kundër korrupsionit dhe kriminalitetit (shih Rekomandimin nr. 4), vlera asetëve të sekuestruara dhe konfiskuara gjatë vitit 2024 arrin në shumën rreth 65,5 milion euro.

SITUATA E KRIMINALITETIT

Në këtë kapitull të raportit zhvillohet një analizë përmbledhëse e tendencave të krimit të organizuar dhe korrupsionit të zyrtarëve të lartë, duke përfshirë dhe mënyrat më tipike të pastrimit të produkteve të veprave penale. Duhet cilësuar se për të evituar përsëritjet me raportin e vitit 2023, në raportin e këtij viti, do t'ju jepet më shumë theks formave komplekse të krimit të organizuar dhe terrorizimit, korrupsionit të funksionarëve publike dhe pastrimit të parave. Analiza është bazuar në të dhënat e marra nga hetimet e kryera dhe përshkrimi i gjendjes së kriminalitetit do të ketë natyrë shpjeguese me shumë sesa evidencuese në terma statistikorë. Të dhënat e detajuara paraqiten në kapitujt vijues të raportit të këtij viti sipas fushave dhe sektorëve përkatës të SPAK.

1. KRIMI I ORGANIZUAR

Grupet kriminale shqiptare vijojnë të kenë një rol shumë të rëndësishëm në tregjet kriminale ndërkombëtare kryesisht në trafikun e drogave të forta, kontrabandimin e qenieve njerëzore dhe krimin kompjuterik.

1.1. Analiza e të Dhënave

Të dhënat statistikore për vitin 2024 evidentojnë një përpjekje të rëndësishme të SPAK në hetimin dhe ndjekjen penale të organizatave dhe grupeve të strukturuar kriminale. Këto të dhëna tregojnë se nga totali i çështjeve nën hetim vetëm **4.9%** janë transferuar, **3%** janë pushuar, **5.6%** janë pezulluar, ndërsa **70.3%** e çështjeve mbeten pjesë e hetimit për vitin 2025.

Nga ana tjetër, numri i të pandehurve të dërguarve në gjykatë përbën rreth 34% të totalit të atyre nën hetim.

Kategoria	Nr. i Çështjeve	Nr. i Personave
Të regjistruara në vitin 2024	101	263
Totali çështjeve në hetim (të transferuara nga viti 2023 dhe të regjistruara në vitin 2024)	266	400
Të bashkuara	21	-
Të hetuara gjithsej	245	400
Dërguar në gjykatë	21	134
Kërkesë për pushim	8	8
Transferuar në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm	13	-
Pezulluar	16	-
Mbartur për hetim për vitin 2025	187	258

2.2 Trafiku i Drogës

Grupet kriminale shqiptare vijojnë të jenë aktive dhe kryesisht në trafikun e kokainës dhe të kanabisit. Këto grupe janë aktive në disa shtetet të Bashkimit Evropian (BE), kryesisht në Itali, Spanjë, Belgjikë, Holandë, Francë, Gjermani, si dhe në vende të tjera si Norvegjia, Zvicra dhe Mbretëria e Bashkuar (MB). Këto gjetje përputhen edhe me gjetjet raporti të vitit 2024 i Europol.²² Siç kemi theksuar edhe në raportin vjetor të SPAK për vitin 2023, grupet kriminale shqiptare kanë arritur tashmë të sigurojnë blerjen e kokainës në vendet e prodhimit të tyre në Amerikën Latine. Kokaina kryesisht porositet në sasi të konsiderueshme në Bolivi, Meksikë, Peru, Ekuador, dhe Paraguai. Shtetas shqiptarë, anëtarë të grupeve kriminale shqiptare, me banim në Brazil, Paraguai, Ekuador dhe Surinam, në disa raste në role drejtuese të grupit kriminal ose në disa raste në role dytësore (kryesisht koordinuese) ndjekin të gjithë procesin e transferimit të ngarkesës nga vendi i origjinës deri në destinacion. Këto dërgesa kalojnë në BE dhe Ballkanin Perëndimor kryesisht nëpër porteve hyrëse të Gioia Tauro (Itali), Rotterdam (Holandë), Antwerp (Belgjikë), Algeciras (Spanjë), Pire (Greqi), si dhe nëpërmjet porteve të Durrësit (Shqipëri) dhe Tivarit (Mal i Zi). Shumë prej eksponentëve kryesorë të këtyre grupeve janë vendosur në Dubai të Emirateve të Bashkuara Arabe.

Megjithëse në një shkallë më të ulët, grupet kriminale shqiptare janë gjithashtu të përfshira në kontrabandën e qenieve njerëzore dhe krimin kibernetikë, të cilat janë pjesë e tregjeve ndërkombëtare të BE-së, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA).

1.2. Grupet Kriminale me rrezikshmëri të lartë

Sipas vlerësimit të brendshëm të SPAK, janë identifikuar rreth **16 grupe kriminale me rrezikshmëri të lartë shoqërore**, të cilat janë të mbështetur në lidhje familjare dhe miqësore dhe janë të përfshirë edhe në tregjet ndërkombëtare kriminale, kryesisht në trafikun e kokainës. Këto grupe janë aktive në qarqet e Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Kukësit, Lezhës, Elbasanit dhe Vlorës. SPAK ka arritur të provojë me sukses 10 prej këtyre grupeve kriminale me aktivitete kriminale në disa qytete të vendit si Tiranë (3); Durrës (2); Elbasan (2); Shkodër (1), Lezhë (1) dhe Kukës (1). Nga veçoritë dalluese të këtyre grupeve kriminale është struktura e tyre hierarkike, ndarja e roleve, përfshirja në anëtarësinë e tyre të përfaqësuesve të gjyqësorit, prokurorisë, policisë së shtetit, medias dhe botës akademike. Disa tipare të tjera të veçorive të këtyre grupeve janë përdorimi i komunikimeve të koduara si SKY ECC dhe pastrimi i parave nëpërmjet kriptovalutave.

1.3. Komunikimi i koduar “Sky ECC”

Administrimi i të dhënave nga Sky ECC, i kombinuar edhe me prova të tjera, ka mundësuar identifikimin e të paktën 9 prej këtyre grupeve kriminale. Analiza e thelluar e komunikimeve të dekriptuara, mundëson jo vetëm identifikimin e aktivitete kriminale dhe të *modus operandi*, por edhe për të kuptuar më mirë mënyrat e veprimit, lidhjet me grupet e tjera kriminale brenda dhe

²² Europol (2024), Decoding the EU’s most threatening criminal networks, Publications Office of the European Union, Luxembourg, fq.20. Marrë nga

<https://www.europol.europa.eu/cms/sites/default/files/documents/Europol%20report%20on%20Decoding%20the%20EU-s%20most%20threatening%20criminal%20networks.pdf>

jashtë vendit dhe për të analizuar mënyrën e lëvizjes së drogës dhe format e qarkullimit të parave. Ky proces është realizuar nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë me Europol dhe agjenci të tjera ligj zbatuese të cilat kanë ofruar të dhënat e dekrituara, duke siguruar përputhshmëri me standardet ligjore për provueshmërinë e provave në gjykatë. Edhe jurisprudenca shqiptare ka mbajtur të njëjtin qëndrim në lidhje me vlefshmërinë e këtyre provave sikurse ato të gjykatave të larta të shteteve anëtare të BE-së.²³

1.4. Mashtrimi kompjuterik në kuadër të krimit të organizuar

Një ndër aktivitetet kriminale që vijon të ngelet shqetësues dhe që ka qenë subjekt i hetimeve të SPAK, është edhe “Mashtrimi kompjuterik”, në dëm të disa personave, në formën e veçantë të bashkëpunim atë të grupit të strukturuar kriminal. Ai përfshin një numër të konsiderueshëm anëtarësh, ka ndikim të lartë në dëmet ekonomike tek viktimat dhe është i shtrirë në shumë shtete. Hetimet e kryera nga SPAK në bashkëpunim me agjenci të tjera partnere dhe të koordinuara nga EUROJUST, tregojnë se ky lloj aktiviteti kriminal shkakton dëme ekonomike shumë të larta. Në këto skema të mashtrimit kompjuterik është zbuluar se fillimisht ngrihen kompani të fokusuara në këtë lloj aktiviteti të cilat më pas administrojnë platforma kinse të dedikuara për investime si (p.sh. rasti i platformave “Absolut Global Markets”, “AurumPro” dhe “Finaxis”, etj.). Këto platforma, përmes *call center*-eve në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Ukrainë dhe Gjeorgji, mashtrojnë qytetarë të ndryshëm, kryesisht nga shtetet e BE-së me investime fiktive, duke shkaktuar dëme ekonomike të cilat mendohet të tejkalonin 6 milionë euro. Hetimet e SPAK gjatë vitit 2024, tregojnë se Shqipëria është kthyer në një pikë të rëndësishme për rrjete kriminale që shfrytëzojnë hapësirat ligjore, teknologjinë dhe krahun e lirë të punës, për të kryer mashtrime kompjuterike masive. Grupet kriminale janë të lidhura ngushtë me tregun e zi kibernetik, duke operuar jo vetëm me mashtrime financiare, por edhe me trafikimin e të dhënave personale.

1.5. Kontrabandimi i Qenieve Njerëzore

Në rastet e hetimit të grupeve kriminale të përfshira në trafikimin e qenieve njerëzore gjatë vitit 2024 janë evidentuar grupe kriminale në fushën e kontrabandimit të qenieve njerëzore, të cilat kanë struktura të mirë organizuar me ndarje rolesh dhe me kryerje veprimesh të sofistikuar për të shmangur drejtësinë. Janë vërejtur dy forma kontrabandimi të qenieve njerëzore.

Forma e parë lidhet me kontrabandimin e shtetasve shqiptar, të cilët kërkojnë të udhëtojnë në mënyrë të paligjshme drejt Mbretërisë së Bashkuar, Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë. Grupet kriminale kryejnë të gjithë ciklin, duke filluar që nga prodhimi i dokumenteve të falsifikuara të identifikimit, kryesisht të dokumenteve të vendeve të BE-së (pasaporta, karta identiteti, leje drejtimi e dokumente të tjera), në gjetjen apo ndërmjetësimin e shtetasve shqiptarë që kërkojnë të udhëtojnë në mënyrë të paligjshme, në transportimin e personave, në akomodimin dhe udhëzimin e këtyre shtetasve mbi itinerarin që duhet ndjekur, etj. Ka rezultuar se, dokumentet falsifikohen kryesisht në Spanjë dhe aktiviteti kriminal administrohet duke u fshehur pas agjencive të

²³ Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. 12 (P) 2024 i Regjistrimit Themeltar, Nr. 86 i Vendimit, datë 30 Dhjetor, 2024

udhëtimit. Vihet re gjithashtu se, grupet kriminale kanë arritur të përdorin teknologji mjaft të avancuar për falsifikimin e dokumenteve të përdorura për kontrabandimin e personave. Nga ana tjetër, format e kryerjes së pagesave janë sofistikuar, duke përfshirë edhe pagesa nëpërmjet kriptovalutave, kryesisht në Bitcoin.

Forma e dytë karakterizohet me kontrabandimin e shtetasve të cilët vijnë nga vende të treta, kryesisht nga Bangladeshi, të cilët përdorin Shqipërinë si pikë tranziti, për t'u larguar më pas në mënyrë të paligjshme drejt vendeve të BE-së. Janë evidentuar të paktën dy grupe të strukturuar kriminale, pjesë e rrjetit ndërkombëtar të kontrabandimit të qenieve njerëzore, të cilat kanë kryer aplikime për leje unike pune dhe më pas aplikime për pajisje me vizë të tipit “D”, për shtetas të huaj me të drejtë punësimi në Shqipëri. Grupet kriminale kanë përdorur agjencitë e ndërmjetësimit të punësimit, në bashkëpunim me shoqëri tregtare me objekt veprimtarie kryesisht fasonerinë, me seli në qytetet Vlorës dhe Durrësit. Këto procedura janë kryer në mënyrë fiktive, pasi qëllimi nuk ka qenë punësimi i tyre, por pajisja me vizë, në mënyrë që më pas këto shtetas të huaj të kontrabandoheshin në shtetet e BE-së. Personat të cilët do të kontrabandoheshin priteshin në Aeroportin “Nënë Tereza” në Tiranë, dhe pas një qëndrimi të shkurtër në Shqipëri, kalonin në territorin e BE-së nëpërmjet qytetit të Kukësit, Kosovës dhe më pas në Serbi.

1.6. Pastrimi i parave

Pastrimi i parave është një ndër aktivitet kriminale kryesore që shoqëron aktivitetet e grupeve kriminale të mirë organizuara. Ky aktivitet kriminal aplikohet kryesisht nga grupet kriminale që veprojnë kryesisht në fushën e narkotikëve dhe që janë pjesë e rrjeteve ndërkombëtare të veprimtarive kriminale me aktivitet kriminal në Shqipëri, Itali, Gjermani, Spanjë, Belgjikë, dhe Mbretërinë e Bashkuar. Një ndër tendencat e theksuara të pastrimit të parave është **përdorimi gjithnjë e më në rritje i kryerjes së pagesave të blerjes së sasive të konsiderueshme të kokainës nëpërmjet kriptovalutave.**

Ka pasur gjithashtu raste të grupeve kriminale, me aktivitet kriminal Shqipëri, kryesisht në qytetet e Tiranës, Fierit, Vlorës, Durrësit, Lezhës, Fushë - Krujës dhe Rrëshenit.

Disa nga veçoritë më tipike të këtyre skemave janë:

Fillimi i procesit: Futja e parave në sistem (Placement)

- Skema fillojnë me përdorimin e parave në dorë, ose pagesave nëpërmjet kriptovalutave, teknika klasike për të shmangur kontrollin e autoriteteve financiare. Këto fonde të dyshimta hidhen në qarkullim përmes shoqërive tregtare të ngritura ose në bashkëpunim me grupet kriminale të cilat funksionojnë si një mbulim ligjor në dukje për aktivitetin e vërtetë kriminal. Shumat e mëdha të parave më pas konvertohen në transaksione të cilat kryhen nëpërmjet shoqërive tregtare që u konvertuan në transaksione të ligjshme në letër, duke i dhënë atyre pamjen e veprimeve legjitime financiare. Pagesat nëpërmjet kriptovalutave kryhen ose direkt ose nëpërmjet shoqërive të këmbimit valutor.

Mekanizmi i shtresëzimit (Layering)

- Për të shmangur vëmendjen e autoriteteve, grupet kriminale kanë përdorur një seri teknikash të mirë menduara. Fillimisht, organizojnë kryerjen e një serie të shumtë

veprimesh nëpërmjet bankave midis llogarive të shoqërisë dhe atyre personale, duke krijuar një mjegullnajë financiare që do të bënte të vështirë ndjekjen e origjinës së vërtetë të parave. Përveç kësaj, përdoren **fatura fiktive**, ku shoqëritë tregtare të ngritura për të maskuar pastrimin e parave lëshojnë dokumente të falsifikuara për të justifikuar transaksione që në realitet nuk kanë ndodhur kurrë. Këto fatura shërbenin si justifikim për lëvizjen e parave brenda dhe jashtë kompanisë, duke maskuar burimin e tyre të vërtetë.

Legjitimimi përmes investimeve (*Integration*)

- Pasi paratë e pastruara maskohen me sukses, ato më pas investohen në pasuri të paluajtshme. Pasuritë e blera shpesh përfshiheshin në **shitblerje të përsëritura** apo **marrëveshje huadhënieje**, duke krijuar një zinxhir të rremë transaksionesh që legjitimonin të ardhurat.

Investimet

- Nga analiza e disa skemave kriminale të pastrimit të parave, investimet kryesisht maskohen në blerje të një shumëllojshmërie asetesh të shpërndara në disa qytete, kryesisht apartamente, njësi tregtare, ullishte, pemëtore, shoqëri tregtare, automjete luksoze, automjete të blinduara, bizhuteri, flori, ora të markave të shtrenjta, kriptovaluta, etj.

2. TERRORIZMI

Gjatë vitit 2024 **janë regjistruar 9 çështje të reja** nga ku vetëm 1 çështje është dërguar në gjykatë, ndërkohë që **6 çështje janë pezulluar** dhe **21 çështje vijnë për hetim** në vitin 2025. Referuar rastit të çuar për gjykim kjo çështje lidhet me hetimin e financimit të terrorizmit. Në këtë hetim ka rezultuar se i pandehuri ka dërguar një shumë prej 864 Euro në favor të një shtetasi sirian, i cili e ka përdorur këtë shumë për të ndihmuar të afërmin të pandehurit i cili rezultonte anëtar i organizatës terroriste “ISIS”. I pandehuri kishte përdorur një kartë identiteti të huaj për të fshehur identitetin e tij dhe për të kaluar paratë në një mënyrë të tërthortë.

Kategoria	Nr. i Çështjeve	Nr. i Personave
Të regjistruara në vitin 2024	9	-
Totali çështjeve në hetim (të transferuara nga viti 2023 dhe të regjistruara në vitin 2024)	29	1
Të bashkuara	-	-
Të hetuara gjithsej	29	1
Dërguar në gjykatë	1	1
Kërkesë për pushim	-	-
Transferuar në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm	1	-
Pezulluar	6	-
Transferohen për hetim në vitin 2025	21	-

3. MATJA E RISKUT

Vihet re se grupet kriminale shqiptare vijojnë të jenë aktive në rrjetet ndërkombëtare të trafikut të drogës dhe kontrabandës së qenieve njerëzore. Pastrimi i parave përbën një ndër mënyrat kryesore të legalizimit të produkteve të paligjshme dhe fuqizimit të tyre ekonomik. Veprat penale në kuadër të terrorizmit janë të ulëta në raport me krimet e tjera. Sidoqoftë ato mbeten në vëmendje të Prokurorisë së Posaçme për shkak të nivelit të lartë rrezikshmërisë së tyre për stabilitetin e sigurisë në vend dhe rajon.

Krimi i organizuar dhe Terrorizmi

Kategoria	Niveli i Rrezikut	Përshkrimi
Neni 287 Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale	 I Lartë Viti 2023: 35 raste (▲ 75% krahasuar me vitin 2022) Viti 2024: 47 raste (▲ 34% krahasuar me vitin 2023)	Pastrimi i parave në kuadër të krimit të organizuar ka një rritje të qëndrueshme, duke treguar një zhvillim të skemave më komplekse të pastrimit të parave dhe një rritje të veprimtarisë së krimit të organizuar. Pastrimi parave evidentohet të jetë më i pranishëm nga grupet kriminale të përfshira në trafikun e narkotikëve, ku për këtë vepër penale, nr. i regjistrimeve të hetimit për pastrim parash është rritur në vitin 2023 (20 raste) me 185% krahasuar me vitin 2022) dhe ka një rënie të lehtë në vitin 2024 (16 raste), me 20% krahasuar me vitin 2023).
Neni 333/a Grupe të strukturuar kriminale, ku përfshihen dhe ata me rrezikshmëri të lartë	 I Lartë Viti 2023: 85 raste (▲ 7.6% krahasuar me vitin 2022) Viti 2024: 101 raste (▲ 18.8% krahasuar me vitin 2023)	Rritja e vazhdueshme e procedimeve për grupet e strukturuar kriminale tregon vijimin e aktiviteteve të tyre në juridiksione të ndryshme si: Amerikë Latine BE (Itali, Francë, Benelux, Spanjë, etj.) Mbretëri e Bashkuar Shqipëri (Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Kukës)
Neni 143/b Mashtrimi Kompjuterik	 I Lartë Viti 2023: 0 raste (📉 100% krahasuar me vitin 2022) Viti 2024: 7 raste (▲ rritje e lartë nga 0 në 2023)	Konsiderohet një aktivitet kriminale i cili ka njohur luhatje por me trend rritës. Është një vepër penale me pasoja të konsiderueshme ekonomike dhe e shtrirë në disa juridiksione, kryesisht në: BE (Spanjë, Gjermani, Suedi) Shqipëri (Tiranë, Durrës, Vlorë)
Neni 283/a Trafikimi i Narkotikëve	 I Lartë Viti 2023: 46 raste (▲ 100% krahasuar me vitin 2022) Viti 2024: 37 raste (📉 19.6% krahasuar me vitin 2023)	Rritja e ndjeshme në 2023 sugjeron një zgjerim të operacioneve të trafikut të narkotikëve, ndërsa ulja në 2024 vlerësohet se vjen nga efekti parandalues i goditjeve të suksesshme nga agjencive ligjzbatuese dhe ndryshimeve në rrugët e trafikut. Kryesisht rrugët e trafikut të narkotikëve janë: Amerike Latine (Brazil, Bolivi, Meksikë, Peru, Ekuador, dhe Paraguai) BE (Itali, Spanjë, Holandë, Gjermani, Belgjikë, Greqi)

		Vende të tjera (Mbretëri e Bashkuar, Norvegji, Zvicër, Emirate e Bashkuara Arabe) Shqipëri (Durrës) Mal i Zi (Tivar)
Nenet 110/a & 128/b Trafiku/Kontrabanda e Qenieve Njerëzore	 Mesatar Viti 2023: 1 rast  50% krahasuar me vitin 2022) Viti 2024: 1 rast (e njëjte krahasuar me vitin 2023)	Ka një rënie në vitin 2023 krahasuar me 2022, që mund të tregojë një reduktim të rasteve të identifikuara ose përmirësim të mekanizmave të parandalimit. Por ka një stabilizim në vitin 2024, me të njëjtin numër rastesh si në 2023. Shtetet ku synohet kontrabandimi janë: SHBA Kanada BE (Spanjë) Mbretëri e Bashkuar Konsideruar kompleksitetin e këtij krimi, nga pikpamja e riskut, ky krim do të konsiderohet mesatar me tendencë në rritje.
Neni 230 –vijim Terrorizmi	 Mesatar – i Ulët Viti 2023: 13 raste ( 85.7% krahasuar me vitin 2022) Viti 2024: 9 raste ( 30.8% krahasuar me vitin 2023)	Terrorizmi ka njohur një rritje të ndjeshme në 2023, por ka pësuar një ulje të moderuar në vitin 2024. Konsiderohet si një aktivitet kriminal me tendencë zbritjeje.

4. KORRUPSIONI

Nga hetimet e vitit 2024 rezulton se korrupsioni i zyrtarëve të lartë zhvillohet në një terren kompleks, përmes manipulimit të procedurave publike dhe shfrytëzimit të pozicioneve zyrtare për përfitime personale. Veprat penale më të evidentuara përfshijnë ushtrimin e ndikimit të paligjshëm, shkeljen e barazisë në tendera, falsifikimin e dokumenteve, korrupsionin aktiv e pasiv, pastrimin e produkteve të veprës penale, shpërdorimin e detyrës dhe falsifikimin e vulave etj. Hetimet kanë treguar ngritjen e shoqërive tregtare të cilat janë përdorur për të përfituar në mënyrë të parregullt kontrata publike duke shkelur ligjin dhe rregullat e prokurimit. Kjo ka sjellë përfitime monetare të cilat më pas janë fshehur përmes veprimeve fiktive financiare dhe janë përvetësuar nga pronarët e shoqërisë. Në mënyrë të veçantë, është evidentuar se një pjesë e këtyre fondeve është tërhequr jashtë sistemit bankar në formë “cash”, ndërsa një pjesë tjetër është ri-investuar në aktivitete tregtare dhe në blerjen e pasurive të paluajtshme. Ky *modus operandi* tregon për një tipologji të korrupsionit në formë të sofistikuar, ku krijimi i skemave të fshehta financiare dhe përdorimi i ndërmjetësve luajnë një rol kyç në shmangien e zbulimit nga autoritetet.

Disa nga veçoritë e vërejtura në këto skema korruptive janë:

Strukturimi i skemës dhe koordinimi i aktorëve

- Skema përfshin bashkëpunimin mes aktorëve publikë dhe privatë, ku zyrtar publik manipulojnë procedurat ligjore, ndërsa subjektet private përfitojnë në mënyrë të paligjshme

nga fondet publike. Ky bashkëpunim e bën korrupsionin të qëndrueshëm dhe të vështirë për t'u zbuluar.

Shkelja e procedurave të prokurimit

- Një nga aspektet kryesore është përdorimi i tenderëve publikë si mjet për shpërndarjen e paligjshme të fondeve. Shkelja e barazisë në tendera krijon një avantazh artificial për subjekte të caktuara, duke ndikuar negativisht në konkurrencën e ndershme dhe cilësinë e projekteve publike.

Përdorimi i ndërmjetësve dhe mbështetja institucionale

- Skema nuk funksionon vetëm si një akt individual i korrupsionit, por mbështetet nga një rrjet i sofistikuar, i cili përfshin ndërmjetës financiarë dhe kompani të lidhura. Ky mekanizëm vështirëson identifikimin e përfituesve të fundit dhe pengon ndjekjen penale efektive.

Pastrimi i parave

- Pastrimi i parave përmes transaksioneve fiktive dhe investimeve të fshehta është një element thelbësor i kësaj skeme. Përdorimi i “cash”-it për të shmangur gjurmët financiare dhe ri-investimi i fondeve në aktivitete të tjera ekonomike tregon për një nivel të lartë të sofistikimit.

4.1. Analiza e të dhënave

Treguesit e vitit 2024 tregojnë një tendencë në rritje të luftë kundër korrupsionit të funksionarëve publik. Këto të dhëna tregojnë se nga totali i çështjeve nën hetim, vetëm **5.88%** janë kërkuar të pushohen, **12.35%** janë transferuar në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, , **0.98%** janë pezulluar, ndërsa **67.45%** e çështjeve mbeten pjesë e hetimit për vitin 2025. Nga ana tjetër, numri i personave të dërguar në gjykatë përbën rreth **35.2%** të totalit të individëve nën hetim.

Në vitin 2024, janë 10 funksionarë të lartë publik për të cilët ka pasur vendime të gjykatave të cilat kanë marrë formë të prerë.

Korrupsioni

Kategoria	Nr. i Çështjeve	Nr. i Personave
Të regjistruara në vitin 2024	186	193
Totali çështjeve në hetim (të transferuara nga viti 2023 dhe të regjistruara në vitin 2024)	510	257
Të bashkuara	27	
Të hetuara gjithsej	483	257
Dërguar në gjykatë	41	141
Kërkesë për pushim	30	3
Transferuar në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm	63	13
Pezulluar	5	
Transferohen për hetim në vitin 2025	344	100

Vihet re një tendencë për sofistikimin e skemave korruptive të abuzimit me fondet publike në nivel qendror dhe lokal. Disa nga veçoritë e këtyre skemave janë:

Krijimi i subjekteve tregtare fiktive. Krijohen shoqëri tregtare fiktive të cilat ngrihen dhe kontrollohen nga zyrtarët publik me qëllim të përfitimit të fondeve publike, në shkelje të ligjit duke manipuluar dhe kontrolluar të gjithë procesin e tenderimit qoftë nga ana e institucioneve publike në nivel qendror ose lokal, por qoftë edhe të subjektit tregtar që aplikon për këto fonde.

Roli i ortakëve të fshehtë: Ortakët *de facto* të shoqërive tregtare të cilat aplikojnë për fondet publike, fshihen dhe nuk dalin në pah por përdorin persona të tjerë si ortakë fiktivë, *de jure* në dokumentacionin e shoqërisë.

Manipulimi i procedurave të prokurimit: Zyrtarët publikë shkelin rregullat e prokurimit publik për të favorizuar subjektin tregtar i cili është paracaktuar për ta fituar tenderin publik. Ky manipulim përfshin:

- Pjesëmarrjen dhe shpalljen fituese të subjektit në disa procedura prokurimi të realizuara nga autoriteti kontraktor publik.
- Caktimin e anëtarëve të komisioneve të vlerësimit të ofertave, duke përfshirë edhe njëritjetrin, për të siguruar që oferta e subjektit tregtar të paracaktuar të shpallet fituese.
- Nënshkrimin e kontratave të sipërmarrjes në mënyrë të paligjshme, duke përfshirë kontroll të plotë mbi procedurat e prokurimit.

Favorizimi në nivele të ndryshme: Subjekti tregtar i paracaktuar merr pjesë në disa tendera duke u shpallur fitues edhe në procedura të tjera të prokurimit të zhvilluara nga institucioni publik përkatës dhe/ose autoritete të tjera në varësi të saj, duke favorizuar subjektin privat të paracaktuar në mënyrë të parregullt ku:

- Zyrtarët publik që marrin pjesë në këto procedura prokurimi, ndihmojnë në shpalljen fitues të subjektit tregtar të paracaktuar, duke manipuluar vlerësimet dhe duke i krijuar avantazhe të padrejta.
- Këto favorizime realizohen në shkelje të rregullave të prokurimit publik, përfshirë shpalljen fituese të kompanisë në mënyrë të parregullt, duke i dhënë kështu një mundësi të padrejtë këtij subjekti për të fituar kontrata publike.

Konflikti i interesit: Një tjetër aspekt i skemës korruptive është bashkëpunimi i drejtpërdrejtë midis zyrtarëve të autoriteteve kontraktore dhe përfaqësuesve të subjektit tregtar të paracaktuar. Vlerësimi i ofertave manipulohet, pasi realizohet me ndihmën apo ndikimin e subjektit tregtar të paracaktuar. Ky është një tregues i qartë i konfliktit të interesit dhe i përdorimit të institucioneve publike për qëllime private.

4.2. Pastrimi i parave

Nga hetimi i veprave penale në kuadër të korrupsionit janë evidentuar disa tipologji të pastrimit të parave si më poshtë:

Pastrimi i parave nëpërmjet kalimit indirekt të fondeve publike:

- Në këtë tipologji, zyrtari publik përdor pozitat e tij drejtuese për të favorizuar një shoqëri tregtare, me qëllim përfitimin e fondeve publike të institucionit që ai drejton. Pas përfitimit të paligjshëm, të ardhurat kalojnë një subjekt privat përfitues tek një tjetër subjekt privat, i cili ka lidhje indirekte me zyrtarin publik. Këto fonde më pas investohen në pasuri të paluajtshme.

Pagimi për punime fiktive dhe investimi në pasuri të paluajtshme:

- Shoqëritë tregtare të ngritura qëllimisht për të përfituar në mënyrë të paligjshme fondet publike, kontrollohen nga zyrtarët publike. Fondet publike, nëpërmjet skemave të pagesave për punime fiktive, nxirren më pas nga sistemi bankar në formën e parave "cash". Një pjesë tjetër e parave ri-investohet në aktivitetet tregtare të shoqërisë ose në pasuri të paluajtshme, duke e bërë më të vështirë identifikimin e origjinës së paligjshme të parave.

Falsifikimi i dokumenteve:

- Individë të lidhur me skemën korruptive, përdorin dokumente të falsifikuara për të regjistruar pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme me ndihmën e zyrtarit publik. Pasuria transferohet më pas në pronësi të një përfituesi tjetër. Ky i fundit e shet/tjetëron, duke e fshehur kështu lidhjen direkte midis zyrtarit publik dhe përfitimit të parregullt por dhe duke legalizuar produktet e veprës penale.

Pastrimi i parave përmes kontratave dhe investimeve:

- Në këto raste përdoret influenca politike për hartimin e ligjeve dhe marrjen e vendimeve për të favorizuar disa shoqëri tregtare/subjekte private të përfitojnë prona dhe fonde publike në shkelje të ligjit. Më pas këto shoqëri tregtare kanë kryer pagesa për interesa të zyrtarëve publikë ose ju kanë dhënë prona të patundshme me çmime të cilat janë nën vlerën e tregut. Të gjitha këto veprime kryhen për të fshehur veprimet korruptive dhe pastruar produktet e veprave penale përmes transaksioneve të ndryshme që fshehin origjinën e tyre.

5. MATJA E RISKUT

Hetimet e vitit 2024 tregojnë se korrupsioni i zyrtarëve të lartë zhvillohet përmes skemave të sofistikuar, ku faktorë si ndikimi institucional, përfshirja e rrjeteve kriminale dhe pastrimi i parave rrisin nivelin e rrezikut. Vlerësimi i riskut bazohet në elementë si përhapja e fenomenit, ndikimi i tij në shoqëri, në ekonomi dhe në garantimin e shtetit të së drejtës, si dhe kompleksiteti i mekanizmave të përdorur për fshehjen e veprimtarisë korruptive. Tabela më poshtë paraqet një kategorizim të nivelit të rrezikut për veprat kryesore penale të lidhura me korrupsionin.

Korrupsioni

Kategoritë	Niveli i Rrezikut	Përshkrimi
Neni 287 Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale	 I Lartë Viti 2023: numri 4 raste  300% , krahasuar me vitin 2022);	Rritja e rasteve të pastrimit të parave nga 2022 në 2024 tregon se kjo vepër penale ka rrezikshmëri të lartë. Lidhja me veprat penale të korrupsionit të mëposhtme tregon se të ardhurat e përfituara nga korrupsioni po kanalizohen drejt integritetit të tyre në ekonominë formale.

	Viti 2024: 8 raste (▲ 100% krahasuar me vitin 2023).	
Neni 258 Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera dhe ankande publike	● I Lartë Viti 2023: 28 raste (▼ 3.45% krahasuar me 2022); Viti 2024: 51 raste (▲ 82.14% krahasuar me 2023).	Përbën një ndër format më të përhapura të abuzimit me fondet publike. Ka përdorim të subjekteve tregtare në mënyrë fiktive.
Neni 259 Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike	● Mesatar - i Lartë Viti 2023: 38 raste (-5% krahasuar me 2022); Viti 2024: 40 raste (+5.26% krahasuar me 2023).	Vijon të ngelet një vepër penale kryesore dhe përcaktuese në fushën e korrupsionit.
Neni 245/1 Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike	● Mesatar Viti 2023: 13 raste (▼ 18.75% krahasuar me 2022); Viti 2024: 11 raste (▼ 15.38% krahasuar me 2023).	Përdorimi i pozicioneve zyrtare për përfitime personale dhe krijimi i skemave të fshehta, që vështirësojnë hetimin dhe sjellin ndikim të madh në proceset publike.
Neni 260 Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendor	● Mesatar Viti 2023: 6 raste (▲ 200% krahasuar me 2022); Viti 2024: 4 raste (▼ 33.33% krahasuar me 2023).	Vijon të ngelet një vepër penale kryesore dhe përcaktuese në fushën e korrupsionit
Neni 319 Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë	● Mesatar Viti 2023: 8 raste (▲ 300% krahasuar me 2022); Viti 2024: 6 raste (▼ 25% krahasuar me 2023).	Paçka se ne trend rënës, hetimi i kësaj vepre penale konsiderohet prioritet pasi paraqet një rrezik shumë të lartë për integritetin e sistemit të drejtësisë.
Neni 319/ç Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë	● Mesatar Viti 2023: 9 raste (▲ 200% krahasuar me 2022); Viti 2024: 7 raste (▼ 22.22% krahasuar me 2023).	Ka një trend rënës por për rëndësinë që ka konsiderohet një vepër penale me rrezikshmëri të lartë dhe me prioritet në hetim.

ANALIZA KRAHASIMORE E EFEKTIVITETIT

Në këtë pjesë të raportit do të zhvillohet një analizë krahasimore e veprimtarisë së Prokurorisë së Posaçme, duke u fokusuar në efektivitetin në hetim dhe gjykim të çështjeve, si dhe volumi i punës në hetimin e pastrimit të produkteve të veprave penale.

Procedime me kallëzime dhe referime nga individë dhe institucione

Gjatë vitit 2024 konstatohen në total 132 hetime të filluara me kallëzime dhe referime nga individë dhe institucione. Nga këto, hetimet e filluara me kallëzime nga shtetas dhe nga persona juridikë zënë rreth 46% të totalit për vitin 2024.

Gjatë këtij vitit rezulton se hetimet e filluara me kallëzime dhe referime nga shtetas dhe persona juridikë janë rritur me rreth 36% krahasuar me vitin paraardhës.

Sa më sipër rezulton se, për të tretin vit radhazi janë rritur kallëzimet nga këto subjekte, çka përkthehet në rritje të besimit të publikut tek institucioni i Prokurorisë së Posaçme.

Nga ana tjetër, vërehet rënie e hetimeve të filluara me kallëzime nga policia e shtetit, nga 65 në vitin 2023 në 30 në vitin 2024.

Hetime	2021	2022	2023	2024	Total
Hetime të filluara me kallëzime nga policia e shtetit	68	44	65	30	207
Hetime të filluara me kallëzime nga institucionet publike	19	20	12	20	71
Hetime të filluara me kallëzime nga subjekte politike	57	10	23	21	111
Hetime të filluara me kallëzime nga shtetas	42	28	36	49	155
Hetime të filluara me kallëzime nga persona juridik	23	15	9	12	59

EFEKTIVITETIT NË HETIM


Gjatë periudhës kohore 2021-2024, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar një numër relativisht të lartë të procedimeve penale të reja me një trend rritës, kryesisht gjatë tre viteve të fundit. Vetëm gjatë vitit 2024 janë regjistruar 328 procedime penale të reja, duke shënuar një rritje me rreth 9.7% të procedimeve penale të reja të regjistruara krahasuar me vitin paraardhës.

Gjatë vitit 2024 janë përfunduar 218 çështje/hetime duke shënuar një rritje me rreth 13% në krahasim me çështjet/hetimet e përfunduara gjatë vitit 2023.

Çështje të reja	2021	2022	2023	2024
	Çështje	Çështje	Çështje	Çështje
Procedime penale të reja të regjistruara	363	257	299	328
Çështjet/hetime të përfunduara	226	196	193	218

Këto të dhëna tregojnë përmirësime në efektivitetin e hetimit të Prokurorisë së Posaçme, me një balancim mes hetimeve të hapura dhe atyre të përfunduara, duke synuar një menaxhim më të qëndrueshëm të volumit të punës.

Procedimet e regjistruara kundrejt procedimeve të përfunduara 2021-2024



MASAT E SIGURIMIT PËR PERSONAT E REGJISTRUAR

Gjatë vitit 2024 lidhur me politikën penale të ndjekur nga Prokuroria e Posaçme, për llojin e kërkesave të masave të sigurimit, rezulton se, institucioni ka shënuar një rritje të masave të sigurimit për personat e regjistruar. Referuar të dhënave statistikore rezulton një rritje me rreth 66% në masat e sigurimit të dhëna gjatë vitit 2024, krahasuar me masat e dhëna gjatë vitit 2023.

Pavarësisht trendit rritës të këtyre masave, vërehet se masa e sigurimit “arrest me burg” në raport me totalin e masave të dhëna në vitin 2024, ka pësuar një rënie me rreth 11% krahasuar me vitin 2023 (nga 48.5 % në vitin 2023 në raport me totalin e masave në 37.5% në vitin 2024).

Sa i përket masave të tjera të sigurimit si, “masë sigurimi në mungesë”, “arrest shtëpie”, dhe “detyrim paraqitje” rezulton se, gjatë vitit 2024 këto masa sigurimi kanë një trend në rënie në raport me totalin e masave të dhëna për këtë vit krahasuar me vitin 2023.

Ndërsa lidhur me masat e sigurimit, “ndalim dalje jashtë vendit” dhe “pezullim ushtrim detyre”, ka rezultuar një rritje gjatë vitit 2024 sikurse paraqitet dhe në tabelën në vijim.

Referuar të dhënave statistikore për vitin 2024, rastet pa masë sigurimi kanë pasur një rritje me rreth 20% në raport me totalin krahasuar me vitin 2023.

Veprat penale të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit				
Llojet e masave	2021	2022	2023	2024
Masë Sigurimi Arrest me Burg	127	189	184	236
Masë Sigurimi në Mungesë	0	22	28	38
Masë Sigurimi Arrest Shtëpie	31	37	51	46
Masë Sigurimi Detyrim paraqitje	8	15	41	53
Masë Sigurimi Ndalim dalje jashtë vendit	1	1	1	6

Masë Sigurimi Pezullim ushtrim detyre	3	4	1	4
Pa masë sigurimi	134	159	73	246
Total	304	427	379	629

Sa i përket masave të sigurimit për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, sipas të dhënave rezultojnë se, janë regjistruar gjithsej 328 procedime me 629 persona nën hetim, të cilat të shpërndara sipas veprave penale janë si vijon:


Llojet e masave	Numri i personave për veprat penale të Krimit të Organizuar	Numri i personave për veprat penale të Korrupsionit	Numri i personave për veprat penale të tjera	Numri i personave të regjistruar për vitin 2024
Masë Sigurimi Arrest me Burg	195	31	10	236
Masë Sigurimi në Mungesë	30	6	2	38
Masë Sigurimi Arrest Shtëpie	8	23	15	46
Masë Sigurimi Detyrim paraqitje	1	22	30	53
Masë Sigurimi Ndalim dalje jashtë vendit		6		6
Masë Sigurimi Pezullim ushtrim detyre		3	1	4
Pa masë sigurimi	29	102	115	246
Total	263	193	173	629

Masa e sigurimit “Arrest me burg” është aplikuar për 236 persona, nga të cilët rreth 82% ose 195 persona, rezultojnë të hetuar për veprat penale të krimit të organizuar. Lidhur me rastet e korrupsionit, gjatë vitit 2024 rezultojnë se, në masën “arrest me burg” janë vendosur 31 persona ose 13.5% e numrit total të personave që vuajnë këtë masë.

Referuar të dhënave, rezultojnë se një numër i konsiderueshëm personash, 246 raste ose rreth 40% e totalit të personave nën hetim për vitin 2024 janë hetuar pa masë sigurimi. Nga personat e hetuar pa masë sigurimi rreth 41% i përket veprave penale të korrupsionit, rreth 12% i përket veprave penale të krimit të organizuar dhe rreth 47% janë persona nën hetim për vepra penale të tjera.

Kjo shpërndarje e masave përgjatë vitit 2024 tregon se, krimi i organizuar ka marrë trajtim më të ashpër, ndërsa për rastet e korrupsionit vërehet një prirje më e madhe drejt masave alternative, si “arrest shtëpie”, “detyrim paraqitje” dhe “pezullim nga detyra”.

Masat e sigurimit përgjatë vitit 2024



VOLUMI I PUNËS NË MBYLLJEN E HETIMEVE


Sa i përket çështjeve/hetimeve të përfunduara nga Prokuroria e Posaçme, në vitin 2024, vërehet një tendencë në rritje në numrin e çështjeve të dërguara në gjykatë me kërkesë për pushim, çështjeve të pezulluara, si dhe çështjeve të dërguara në gjykatë me kërkesë për gjykim krahasuar me vitin 2023. Sa i takon çështjeve të transferuara, gjatë vitit 2024 ka qenë i njëjti numër çështjesh si ai i vitit 2023.

Referuar të dhënave statistikore të Prokurorisë së Posaçme, gjatë vitit 2024 evidentohen në total 218 raste, duke shënuar një rritje prej rreth 13% nga viti 2023 ku janë shënuar në total 193 çështje/hetime të përfunduara.

Çështje/hetime të përfunduara	2021	2022	2023	2024
Kërkesa për pushim	37	38	29	41
Vendim pezullimi	34	19	24	27
Transferim	107	82	87	87
Kërkesa për gjykim	48	57	53	63
Totali	226	196	193	218

Peshën kryesore në numrin e çështjeve/hetimeve të përfunduar, edhe për vitin 2024 e zënë çështjet, të cilat janë çuar për “transferim” në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm në masën rreth 40% duke u ndjekur nga çështjet, të cilat janë çuar në gjykatë “për gjykim”, në masën rreth 29% kundrejt totalit. Ky transferim është një veprim i zakonshëm në rastet ku hetimet janë zhvilluar nga Prokuroria e Posaçme, por pas zbardhjes së autorëve të veprave penale, ka rezultuar që kompetenca lëndore për ndjekjen e çështjes nuk është në juridiksionin e Prokurorisë së Posaçme. Kjo tregon një angazhim të lartë hetimor, pasi prokurorët e posaçëm kanë kryer hetime të hollësishme dhe kanë zbuluar autorët, për të transferuar çështjet më pas në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.

Çështjet e përfunduara për vitin 2024



Volumi i hetimit të korrupsionit

Gjatë vitit 2024, sa i përket hetimeve të regjistruara kundrejt atyre të përfunduara në kuadër të korrupsionit, rezultojnë në total 186 çështje/hetime të regjistruara dhe 139 çështje/hetime të përfunduara, duke u evidentuar një rënie e lehtë krahasimisht me vitin 2023, nga 214 çështje/hetime të regjistruara në vitin 2023, në 186 çështje/hetime të regjistruara në vitin 2024. Një rënie vërehet edhe sa i përket çështjeve/hetimeve të përfunduara përgjatë vitit 2024, nga 150 çështje/hetime të përfunduara në vitin 2023, në 139 çështje/hetime të përfunduara në vitin 2024.

Vepra penale	2022		2023		2024	
	Çështje/hetime të regjistruara	Çështje/hetime të përfunduara	Çështje/hetime të regjistruara	Çështje/hetime të përfunduara	Çështje/hetime të regjistruara	Çështje/hetime të përfunduara
Numri	178	160	214	150	186	139

Pavarësisht sa më sipër, konstatohet se, numri i çështjeve të përfunduara mbetet relativisht i lartë, duke treguar se hetimet janë në rrugë të mbarë dhe kapaciteti hetimor është i qëndrueshëm. Këto të dhëna tregojnë një menaxhim të mirë të volumin të punës dhe se Prokuroria e Posaçme po arrin të ruajë një balancë midis hetimeve të reja dhe atyre që përfundojnë.

Në luftën kundër korrupsionit të **zyrtarëve të lartë publike**, Prokuroria e Posaçme ka ndjekur një qasje aktive, duke hetuar një numër të konsiderueshëm të tyre.

Zyrtarët të Lartë nën hetim dhe gjykim

Nr.	Kategoria	Nën Hetim	Në Gjykim
1	ish-Kryetar Kuvendi	1	1
2	ish-Kryeministër	1	-

3	ish- Ministra	3	2
4	Ish- Zv.ministër	1	1
5	Ish-Deputet	1	-
6	Deputet	4	1
7	Ish-Kryetar Bashkie	7	4
8	Kryetar Bashkie	3	2
9	Ish-Gjyqtar	4	1
10	ish-Prokuror	2	2
11	ish-Prefekt	2	2
12	Ish-Sekretar të Përgjithshëm	3	3
13	ish-Drejtor	1	-
Totali		33	19

Gjatë vitit 2024, rezultojnë **33 zyrtarë të lartë nën hetim** (ku dy prej tyre janë të regjistruar në dy procedime të ndryshme secili), nga të cilët **19 zyrtarë janë dërguar në gjykatë** me kërkesë për gjykim. Siç shihet dhe nga tabela e mësipërme, nga numri total i ish zyrtarëve të lartë nën hetim, **19 prej tyre janë dërguar në gjykatë**, që përfaqëson **52.9%** të rasteve. Kjo e dhënë tregon një nivel të lartë të përfundimit të hetimeve, me ngritje akuzash konkrete për këtë nivel të sofistikuar korrupsioni.

Volumi i hetimit të krimit të organizuar

Për sa i përket hetimeve për veprat penale që lidhen me krimin e organizuar, gjatë vitit 2024 Prokuroria e Posaçme ka pasur një trend rritës, si në çështje/hetime të regjistruara ashtu dhe në çështje/hetime të përfunduara, detajuar në tabelën më poshtë:


Vepra penale	2022		2023		2024	
	Çështje/hetime të reregjistruara	Çështje/hetime të përfunduara	Çështje/hetime të reregjistruara	Çështje/hetime të përfunduara	Çështje/hetime të reregjistruara	Çështje/hetime të përfunduara
Numri	79	36	85	43	101	58

Krahasimisht gjatë vitit 2024, për çështjet/hetimet e regjistruara në kuadër të Krimit të Organizuar, evidentohet një rritje në masën rreth 19% kundrejt vitit 2023.


Gjithashtu, një rritje vërehet edhe lidhur me çështjet/hetimet e përfunduara, ku në krahasim me vitin 2023, gjatë vitit 2024 ka pasur një rritje prej rreth 35%.

Kjo rritje e numrit të çështjeve/hetimeve të regjistruara dhe çështjeve/hetimeve të përfunduara, tregon një përpjekje të shtuar në luftën kundër krimit të organizuar dhe një përmirësim të vazhdueshëm në menaxhimin dhe përfundimin e hetimeve. Kjo gjithashtu mund të reflektojë një përmirësim të kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse, si dhe një angazhim më të madh në ndjekjen dhe zbulimin e grupeve kriminale të strukturuar.

Krahasimi i çështjeve/hetimeve të regjistruara në kuadër të Krimit të Organizuar 2023 - 2024



Krahasimi i çështjeve/hetimeve të përfunduara në kuadër të Krimit të Organizuar 2023 - 2024




Volumi i hetimit të pastrimit të parave

Gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar gjithsej 47 procedime në kuadër të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”.

Përgjatë periudhës 2021-2024, procedimet për veprat penale që lidhen me “Pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, kanë pasur një trend rritës sikurse është paraqitur në vijim. Nga të dhënat statistikore, rezulton se, në vitin 2024 numri i procedimeve të regjistruara në kuadër të luftës kundër “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, nga ana Prokurorisë së Posaçme, është rritur me rreth 34% në krahasim me vitin 2023, ndërsa krahasimesh me vitin 2021, këto procedime janë trefishuar.

Neni 287, Kodi Penal	Viti			
	2021	2022	2023	2024
Procedime të regjistruara në kuadër të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”	15	20	35	47

Procedime të regjistruara në hetimin e pastrimit të parave



Kjo rritje e numrit të procedimeve reflekton një angazhim të shtuar të Prokurorisë së Posaçme në luftën kundër pastrimit të parave dhe veprimtarive të lidhura me pastrimin e produkteve të veprës penale, çka pasqyron forcimin e strategjive hetimore dhe të resurseve të dedikuara për këtë fushë, si dhe përpjekjeve për të zbuluar dhe ndëshkuar këtë lloj aktiviteti kriminal.

SEKUESTRIMI DHE KONFISKIMI I PRODUKTEVE TË VEPRAVE PENALE


Për sa i përket sekuestrimeve dhe konfiskimeve nga produktet e veprave penale të hetuara nga Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2024, referuar të dhënave statistikore, evidentohet rritje e numrit të sekuestrimeve sipas Kodit Penal, ndërsa vërehet një rënie për sa i përket numrit të konfiskimeve krahasuar me vitin 2023.

Kjo ka ardhur për shkak se, disa nga rastet e sekuestrimeve sipas Kodit Penal kanë qenë ende në fazën e hetimit dhe në proces gjykim, si dhe gjatë vitit 2024, nuk ka përfunduar ende procesi gjyqësor me vendim përfundimtar. Në këto raste, gjykimi i kërkesave për konfiskimin e pasurive kryhet së bashku me gjykimin e akuzave për kryerjen e veprave penale dhe fajësinë e personave të akuzuar. Në këtë mënyrë ecuria e procedurës së konfiskimit është e varur nga ecuria e gjykimit të çështjes në themel. Gjithashtu, rënia e mësipërme i referohet numrit të rasteve, ndërkohë që vlera e pasurive të konfiskuara në vitin 2024, është më e lartë se vlera e pasurive të konfiskuara në vitin 2023.

Akte Ligjore	2021		2022		2023		2024	
	Sekuestri me	Konfiski me	Sekuestri me	Konfiski me	Sekuestri me	Konfiski me	Sekuestri me	Konfiski me
Ligji-Anti Mafia	14	4	5	10	8	5	8	3
Kodi Penal	5	4	7	20	8	20	17	11
Akt Normativ (OFL)	28	54	0	32	0	14	0	6
Total	47	62	12	62	16	39	25	20

Në vijim paraqitet evidenca e sekuestrimeve dhe konfiskimeve për periudhën 2021-2024.

Evidenca e sekuestrimeve dhe konfiskimeve



Lidhur me sekuestrimet në kuadër të ligjit Anti-Mafia, gjatë vitit 2024, vërehet që numri i sekuestrimeve është i njëjtë me sekuestrimet e vitit 2023, ndërsa në kuadër të sekuestrimeve në bazë të Kodit Penal evidentohet një rritje nga 8 sekuestrime në vitin 2023, në 17 sekuestrime në vitin 2024 ose ndryshe janë dyfishuar.

Akte Ligjore	Sekuestrime	Sekuestrime	Sekuestrime	Sekuestrime
	2021	2022	2023	2024
Ligji Anti Mafia	14	5	8	8
Kodi Penal	5	7	8	17
Akt Normativ (OFL)	28	0	0	0
Total	47	12	16	25

Lidhur me konfiskimet në kuadër të ligjit Anti-Mafia, gjatë vitit 2024 në krahasim me vitin 2023, vërehet një ulje e numrit të këtyre konfiskimeve, nga 5 konfiskime në vitin 2023, në 3 konfiskime në vitin 2024.

Gjithashtu, vërehet një rënie e numrit të konfiskimeve sipas Kodit Penal, nga 20 vendime konfiskimi në vitin 2023, në 11 vendime konfiskimi në vitin 2024.

Të dhënat e pasurive të konfiskuara sipas Kodit Penal ju referohen vendimeve gjyqësore që kanë marr formë të prerë në vitin 2024. Këtu nuk përfshihen vendimet e konfiskimit që ka vendosur GJKKO, për të cilat ende nuk ka përfunduar në shkallën e dytë të gjykimit në GJAKKO dhe ende nuk kanë marrë formë të prerë.

Të dhënat e pasurive të konfiskuara sipas Akti Normativ (OFL) dhe ligji Anti Mafia, i referohen të dhënave në bazë të vendimeve gjyqësore të GJKKO, pasi për këto lloj gjykimesh, vendimi i konfiskimit ekzekutohet në momentin që përfundon gjykimi në gjykatën e shkallës së parë, pa qenë e nevojshme që vendimi të marr formë të prerë.

Aktet Ligjore	Konfiskime	Konfiskime	Konfiskime	Konfiskime
	2021	2022	2023	2024
Ligji Anti Mafia	4	10	5	3

Kodi Penal	4	20	20	11
Akt Normativ (OFL)	54	32	14	6
Total	62	62	39	20

Vlera e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara

Vlera e asetëve të sekuestruara dhe konfiskuara për vitin 2024, përlogaritët në vlerën afërsisht prej 65,5 milion euro. Këtu përfshihet vlera e asetëve të sekuestruara dhe konfiskuara në kuadër të Ligjit Anti-Mafia, Kodit Penal dhe Aktit Normativ (OFL). Nga totali rreth 36,8 milion euro është vlera e asetëve të konfiskuara dhe rreth 28,7 milionë euro është vlera e asetëve të sekuestruara.

Vlera e pasurive të sekuestruara ka shënuar një rritje të ndjeshme në vitin 2024, prej rreth 47%, konkretisht nga 1.9 miliardë lekë²⁴ në vitin 2023, në vlerën rreth 2.8 miliardë lekë në vitin 2024.

Për sa i përket pasurive të konfiskuara gjatë vitit 2024, edhe pse evidentohet rënie e numrit të pasurive të konfiskuara, nga ana tjetër **evidentohet një rritje e ndjeshme e vlerës në lekë/euro të pasurive të konfiskuara krahasimisht me vitin 2023**²⁵.

Konkretisht vlera e pasurive të konfiskuara gjatë vitit 2024, është në vlerën rreth **938 milion lekë** nga 440 milion lekë që ishte në vitin 2023, dhe **27 milion euro** nga rreth 18 milion euro që ishte në vitin 2023.

2024				
Aktet Ligjore	Sekuestime		Konfiskime	
	Në monedhën Lekë	Në monedhën Euro	Në monedhën Lekë	Në monedhën Euro
Ligji Anti Mafia	1,239,896,351		427,254,062	-
Kodi Penal	1,169,336,403		510,825,564	27,202,300
Akt Normativ (OFL)	391,472,758			
Totali	2,800,705,512	0	938,079,626	27,202,300


2023				
Aktet Ligjore	Sekuestime		Konfiskime	
	Në monedhën Lekë	Në monedhën Euro	Në monedhën Lekë	Në monedhën Euro
Ligji Anti Mafia	275,553,016	-	64,341,850	-
Kodi Penal	1,711,258,000	-	5,800,000	18,350,000
Akt Normativ (OFL)	-	-	370,718,221	
Totali	1,986,811,016	-	440,860,071	18,350,000

Evidentohet se, në vlerën totale të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, vlerën më të lartë e zënë ato të proceduara sipas Kodit Penal dhe Ligjit Anti Mafia.

²⁴ Burimi: Raporti vjetor 2023.

²⁵ Burimi: Raporti vjetor 2023.

Raporti midis masës së konfiskimeve dhe sekuestrimeve



Sa i përket vlerave të pasurive të konfiskuara dhe sekuestruara nga Prokuroria e Posaçme gjatë viti 2024, rezulton se rreth 30 milionë euro, ose rreth 45,8% të vlerës totale të pasurive të konfiskuara dhe sekuestruara përgjatë këtij viti, e zënë pasuritë që ju përkasin zyrtarëve të lartë.

EFEKTIVITETI NË GJYKIM

Gjatë vitit 2024, volumi i punës për sa i përket çështjeve të çuara për gjykim nga Prokuroria e Posaçme, sikurse rezulton dhe nga të dhënat statistikore ka qenë i lartë me një trend të vazhdueshëm rritës. Në total janë 217 çështje të gjykuara/në gjykim gjatë vitit 2024 krahasuar me 178 çështje të vitit 2023, duke shënuar një rritje me rreth 22% krahasimisht me vitin paraardhës.


Gjatë vitit 2024, është dyfishuar numri i rekurseve të shqyrtuara nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, janë dhënë 65 vendim fajësie në GJKKO dhe 56 vendim fajësie në GJAKKO, duke shënuar një rënie të lehtë të tyre, krahasuar me vitin 2023.

Një rënie evidentohet gjithashtu, edhe për vendimet e pafajësisë të dhëna gjatë vitit 2024 nga GJAKKO-ja, krahasimisht me vitin 2023, nga 8 vendime pafajësie të dhëna në vitin 2023, në 7 vendime të dhëna në vitin 2024, paraqitur në mënyrë tabelore, si më poshtë.

Vendimet e dënimit	2021	2022	2023	2024
	çështje	çështje	çështje	çështje
Vendim fajësie në GJKKO	75	47	72	65
Vendim fajësie në GJAKKO	41	37	57	56
Rekurse të paraqitura pranë Kolegjit të Posaçëm të Gjykatës së Lartë	0	29	41	89
Vendime pafajësie dhënë nga GJKKO	2	3	8	7
Totali	118	116	178	217

Më poshtë një paraqitje grafike e vendimeve të dënimit të dhëna gjatë vitit 2024 dhe pesha e tyre në raport me totalin.

Vendimet e dënimit gjatë vitit 2024



ANALIZA E VOLUMIT TË PUNËS TË PROKURORISË SË POSAÇME PËR VITIN 2024

VOLUMI I PUNËS NË HETIM

Në Prokurorinë e Posaçme për periudhën e vitit 2024, janë hetuar gjithsej **854** procedime penale, nga të cilat **526** procedime penale janë mbartur nga viti 2023, ndërsa **328** procedime penale janë regjistruar gjatë vitit 2024, si procedime penale të reja.

Nga numri total i procedimeve penale të hetuara, për **61** procedime penale është vendosur bashkimi i çështjes, duke pasur në hetim për këtë periudhë kohore gjithsej **793** procedime penale me **844** persona nën hetim.

Nga **328** procedime penale të regjistruara për vitin 2024, 61 procedime penale kanë ardhur për kompetencë nga Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm, 65 procedime janë të regjistruara kryesisht. Ndërkohë, janë filluar mbi bazën e referimeve penale të shërbimeve të policisë gjyqësore, të kallëzimeve penale të institucioneve të ndryshme vendase dhe autoriteteve të huaja, enteve private të shtetasve etj., 202 procedime penale.

Nga 65 procedime penale të regjistruara kryesisht me 29 persona në hetim, 4 procedime janë bashkuar me procedimet e tjera.

Është vendosur mospranimi i akteve për **18** procedime penale të dërguara për kompetencë lëndore nga Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm, të cilat janë ridërguar në Prokuroritë kompetente.

Janë regjistruar gjithsej, 300 kallëzime nga të cilat, për 127 kallëzime është vendosur mos fillim procedimi penal, për 8 kallëzime penale, nuk është marrë vendimmarrje gjatë vitit 2024 dhe janë mbartur në vitin 2025 (për dy kallëzime është vendosur mos fillim procedimi penal në vitin 2025

dhe për 6 kallëzime penale, është regjistruar procedim penal në vitin 2025), për 138 kallëzime penale është vendosur regjistrimi i procedimit penal, për 2 kallëzime penale të vitit 2024 është vendosur bashkimi me procedim penale të tjera dhe për 25 kallëzime penale është vendosur mos kompetencë.

Në lidhje me vendimet e mos fillimit të procedimit penal, është paraqitur ankim në Gjykatë në 64 raste, nga të cilat për 2 vendime është vendosur lënia në fuqi, për 42 vendime mos fillimi vazhdon gjykimi në Gjykatën e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe për 20 vendime mos fillimi vazhdon gjykimi në Gjykatën e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Nga **793** procedime penale në hetim me **844** persona nën hetim, rezulton se gjatë vitit 2024 kanë përfunduar hetimet për **218** procedime penale me **444** persona nën hetim/të pandehur, ku për **63** procedime me **311** të pandehur është paraqitur kërkesë për gjykim, për **41** procedime penale me **19** persona në hetim është paraqitur kërkesë për pushimin e çështjes, **87** procedime penale me **114** persona në hetim janë transferuar për kompetencë në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe për **27** procedime penale është vendosur pezullimi i hetimeve. Ndërsa **575** procedime penale me **400** persona në hetim janë mbartur për vitin 2025.

Në lidhje me hetimin të veprave penale në fushën e **korrupsionit**, Prokuroria e Posaçme ka hetuar gjithsej **483 çështje** (mbartur dhe regjistruar) me 257 persona. Nga këto janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim **41** çështje me 141 të pandehur.

Në lidhje me hetimin të veprave penale në fushën e **krimit të organizuar**, Prokuroria e Posaçme ka hetuar gjithsej **245 çështje** me 400 persona. Nga këto janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim **21** çështje me 134 të pandehur.

Në lidhje me **kërkesat për gjykim**, rezulton të jenë dërguar në gjykatë **63** kërkesa për gjykim me **311** të pandehur nga të cilat **21** kërkesa për gjykim me **134** të pandehur për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar, **41** kërkesa për gjykim me **141** të pandehur për vepra penale të lidhen me korrupsionin dhe për **1** kërkesë për gjykim me **36** të pandehur për vepra penale të tjera.

Në **41** procedimet penale për të cilët është paraqitur **kërkesë për pushimin** e çështjes kanë qenë nën hetim **19** persona, nga të cilët **8** kërkesa për pushim me **8** persona nën hetim për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar, **30** kërkesa për pushim me **3** persona nën hetim për vepra penale të lidhen me korrupsionin, dhe për **3** kërkesa për pushim me **8** persona nën hetim për vepra për vepra penale të tjera.

Në **87 procedimet penale, që janë transferuar** në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm kanë qenë **114** persona nën hetim, **13** procedime penale për vepra në fushën e krimit të organizuar, për **63** procedime penale me **13** persona nën hetim për vepra në fushën e korrupsionit, për **11** procedime penale me **101** persona nën hetim për vepra penale të tjera.

Në lidhje me **pezullimin e hetimeve** rezulton se, për **27** procedimet penale është vendosur pezullimi i hetimeve nga të cilat rezulton se, kemi **16** procedime të pezulluara për veprat penale në kuadrin e krimit të organizuar, **5** procedime të pezulluara për veprat penale që lidhen me korrupsionin dhe kemi **6** procedime të pezulluara për vepra penal të tjera.

Nga numri prej **844** persona nën hetim, **586** prej tyre janë hetuar me **masë sigurimi**, ndërsa **258** persona nën hetim janë hetuar në **gjendje të lirë**.

412 personat nën hetim janë hetuar me **masë sigurimi**, “arrest me burg”, nga të cilët **340** masa janë ekzekutuar, ndërsa për **72** persona është vendosur masa e sigurimit “arrest në burg” në mungesë.

Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” është vendosur për **76** persona nën hetim, **85** persona nën hetim janë hetuar me masën e sigurimit “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, **7** persona për masën e sigurimit “ndalimi i daljes jashtë shtetit”, **6** persona me masën e sigurimit “pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik”.

Për vitin 2025 **janë mbartur** në hetim **575** procedime penale me **400** persona në hetim.

Nga 575 procedime penale të mbartura, 187 procedime penale janë të regjistruara për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar me 258 persona nën hetim, nga të cilët 220 prej tyre hetohen me masën e sigurimit “arrest në burg” dhe 344 procedime penale, me 100 persona nën hetim janë të regjistruar për vepra penale të korrupsionit. Ndërsa, 44 procedime penale, me 42 persona nën hetim janë të regjistruar për vepra penale të tjera.

Nga 400 persona nën hetim në procedimet penale të mbartura, 255 persona nën hetim janë duke u hetuar me masën e sigurimit “arrest në burg”, 34 persona me masë sigurimi “arrest në shtëpi”, 28 persona me masën e sigurimit “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, 7 persona me masën e sigurimit “ndalimi i daljes jashtë shtetit” dhe 76 persona në gjendje të lirë pa ndonjë masë sigurimi.

1. Veprat penale që lidhen me zgjedhjet, për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024

Për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, janë hetuar (mbartur dhe regjistruar) gjithsej 43 procedime penale, për 7 persona nën hetim, për veprat penale që lidhen me krimet zgjedhore, nga të cilat rezultojnë se:

- 1 procedim, me 1 të pandehur është dërguar në Gjykatë me kërkesë për gjykim;
- 13 procedime penale, me 2 persona nën hetim janë dërguar në Gjykatë me kërkesë për pushim;
- 5 procedime janë transferuar për kompetencë në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm;
- 2 procedime janë pezulluar.

Aktualisht në hetim janë 22 procedime penale, me 4 persona.

2. Procedimet që lidhen me veprat penale me qëllime terroriste, për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024

Për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, janë hetuar (mbartur dhe regjistruar) gjithsej 29 procedime penale, për 1 person nën hetim, për veprat penale me qëllime terroriste, nga të cilat rezultojnë se:

- 1 procedim, me 1 të pandehur është dërguar në Gjykatë me kërkesë për gjykim;
- 1 procedim është transferuar për kompetencë në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm;
- 6 procedime janë pezulluar.

Aktualisht në hetim janë 21 procedime penale

Të dhënat për hetimet pasurore për vitin 2024

- Prokuroria e Posaçme, në vijim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, nëpërmjet ndjekjes penale, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive kriminale që rezultojnë nga veprat penale, gjatë vitit 2024 ka arritur të sekuestrojë dhe konfiskojë një portofol të diversifikuar asetesh, si pasuri të paluajtshme, vlera monetare, kuota tregtare, si dhe portofole kriptovalutash, më konkretisht:

- **Në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009**, përgjatë vitit 2024, janë regjistruar 17 procedime pasurore.

Përsa i përket kërkesave për sekuestrimin e pasurisë, gjatë vitit 2024, janë paraqitur në gjykatë 5 kërkesa për sekuestrimin e pasurive dhe janë dhënë nga gjykata 8 vendime për sekuestrim pasurie, duke sekuestruar përkatësisht, 60 pasuri të luajtshme, 69 pasuri të paluajtshme, 33 subjekte tregtare dhe rreth 200 llogari bankare.

Pasuritë e sekuestruara sipas ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*” vlerësohen rreth 1.239.896.351 Lekë.

Po kështu, janë paraqitur në gjykatë 6 kërkesa për konfiskimin e pasurive, ndërkohë që janë dhënë nga gjykata 3 vendime për konfiskim të pasurive duke konfiskuar përkatësisht: 8 pasuri të luajtshme, 8 pasuri të paluajtshme, llogari bankare dhe vlera monetare prej 660.854 Euro dhe rreth 7.574.664 Lekë.

Pasuritë e konfiskuara sipas ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*” vlerësohen rreth 419.679.398 Lekë.

- **Në zbatim të Aktit Normativ Nr. 1, datë 31.01.2020**, janë dhënë nga GJKKO 6 vendime me objekt konfiskimi, duke konfiskuar përkatësisht, 42 pasuri të paluajtshme, 9 pasuri të luajtshme, 2 subjekte tregtare.

Pasuritë e konfiskuara sipas Aktit Normativ Nr. 1, datë 31.01.2020, “*Për Masat Parandaluese në Kuadër të Forcimit të Luftës Kundër Terrorizmit, Krimit të Organizuar, Krimeve të Rënda dhe Konsolidimit të Rendit e Sigurisë Publike*” vlerësohen rreth 391.472.758 Lekë.

- **Në zbatim të Kodit të Procedurës Penale, gjatë procesit penal**, me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme, janë marrë 17 vendime për sekuestrim pasurie. Në total janë sekuestruar rreth 58 pasuri të paluajtshme, 33 pasuri të luajtshme, 8 subjekte tregtare, nga të cilët 4 subjekte tregtare të sekuestruara plotësisht dhe kuotat përkatëse të personave nën hetim për 4 subjekte tregtare, rreth 5 milionë Euro në shumë monetare dhe rreth 10 milionë dollarë kriptovaluta.

Pasuritë e sekuestruara sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë vlerësohen rreth 1.169.336.403 Lekë.

Konfiskim i pasurisë në proces penal

Është dhënë konfiskim pasurie në proces penal, në 11 vendime penale.

1. Pasuri të paluajtshme të konfiskuara

- 17 pasuri të paluajtshme
- 2. **Vlera monetare të konfiskuara në Lekë, Euro dhe Dollar.**
 - 395.000 Lekë
 - 38.000 Euro
- 3. **Pasuri të luajtshme të konfiskuara**
 - 2 pasuri të luajtshme
- 4. **Subjekte tregtare të konfiskuara**
 - 7 subjekte tregtare, nga të cilët 6 subjekte tregtare të sekuestruara plotësisht dhe kuotat përkatëse të personave të pandehur për 1 subjekt tregtar.

Pasuritë e konfiskuara sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë vlerësohen rreth 27,202,300 Euro dhe 510.825.564 Lekë.

VOLUMI I PUNËS NË GJYKIM

Për vitin 2024, në GJKKO, janë gjykuar 145 çështje me 736 persona të pandehur, nga të cilat rezulton se, ka përfunduar gjykimi i themelit për 54 çështje, me 292 persona. Për 91 çështje penale themeli, me 444 persona të pandehur vazhdon gjykimi, duke u mbartur për t'u gjykuar në vitin 2025.

Për vitin 2024, nga GJKKO, janë dhënë gjithsej 78 vendime, me 299 persona. Për 4 vendime, me 10 persona të pandehur është vendosur shpallja e mos kompetencës lëndore dhe janë dërguar për kompetencë në Gjykatat e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatat e Huaja. Për 4 vendime, me 25 të pandehur është vendosur pushimi i gjykimit në GJKKO. Për 1 vendim, me 1 të pandehur është vendosur mospranimi i marrëveshjes së fajësisë dhe për 1 vendim, me 1 të pandehur është vendosur mjekim i detyrueshëm ambulator. Për vitin 2024, nga GJKKO janë dhënë 65 vendime dënimi me 242 persona të dënuar. Përveç vendimeve penale të mësipërme, GJKKO ka dhënë 3 vendime penale me të dëmtuar akuzues, që kanë paraqitur kërkesë drejtpërsëdrejti në gjykatë, me 5 persona të akuzuar.

Për vitin 2024, nga GJKKO, janë dhënë gjithsej 65 vendime dënimi, me 242 persona të dënuar. Nga këto, 27 çështje penale, me 130 persona kanë qenë për vepra penale në fushën e krimit të organizuar, ndërsa 38 çështje penale, me 112 persona kanë qenë për vepra penale në fushën e korrupsionit dhe vepra penale të tjera.

Pafajësitë. Gjatë vitit 2024, nga GJKKO janë deklaruar të pafajshëm 20 të pandehur.

Në lidhje me pafajësitë e dhëna nga GJKKO rezulton se, nga 6 çështje me 75 persona të gjykuar është vendosur pafajësi e plotë për 19 persona të pandehur, ndërsa për 56 të pandehur është vendosur fajësi sipas akuzës përkatëse.

Prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë në **6094 seanca gjyqësore** të zhvilluara në këtë shkallë gjykimi, nga të cilat **3337 seanca** të regjistruara me sistem audio.

Në **GJAKKO**, për vitin 2024, prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë në gjykimin e çështjeve penale të themelit, si dhe në gjykimin e ankimeve ndaj vendimeve të GJKKO për kërkesat e prokurorisë gjatë fazës së hetimeve paraprake. Për vitin 2024, nga GJAKKO, janë dhënë gjithsej 56 vendime dënimi, me 192 të pandehur. Nga këto, 19 çështje penale, me 60 persona kanë qenë për vepra penale në fushën e krimit të organizuar, ndërsa 37 çështje penale, me 121 persona kanë qenë për vepra penale në fushën e korrupsionit dhe vepra penale të tjera. Gjatë vitit 2024, GJAKKO ka deklaruar të pafajshëm 7 të pandehur. Për 3 të pandehur është vendosur pushimi i gjykit për shkak të ligjit të amnistisë dhe për 1 të pandehur është vendosur pushimi i gjykit për shkak se ka ndërruar jetë.

Numri i ankimeve, rekurseve dhe zgjidhja përkatëse

1. Gjatë vitit 2024, janë ushtruar gjithsej **60** ankime ndaj vendimeve të dhëna nga GJKKO.
 - Për **56** ankime ka përfunduar gjykimi në GJAKKO.
 - Për **4** ankime vazhdon gjykimi në GJAKKO.
2. Gjatë vitit 2024, janë ushtruar gjithsej **89** rekurse nga palët në gjykim ndaj vendimeve penale, nga të cilat 2 prej tyre janë ushtruar nga Prokuroria e Posaçme.

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE

Prokuroria e Posaçme në ushtrimin e kompetencave të saj, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale.

Gjatë vitit 2024 janë ekzekutuar gjithsej 79 vendime penale të formës së prerë, me 235 të dënuar, nga këto:

- 20 vendime kanë marrë formë të prerë në GJKKO;
- 56 vendime kanë marrë formë të prerë në GJAKKO;
- 3 vendime kanë marrë formë të prerë në Gjykatën e Lartë.

Janë dënuar 235 persona me vendim të formës së prerë, nga këto:

- 162 të dënuar me burg;
- 38 të dënuar me kusht/kohë prove, 2 të dënuar që përfaqësojnë 2 shoqëri, me masë “mbarim personi juridik”;
- 10 të dënuar me orë pune;
- 13 të dënuar pushuar vendimi i dënimit, për të cilët 12 për efekt amnistie dhe 1 për mjekim i detyruar ambulator;
- 8 ish të dënuar dhënë pafajësi.

Gjatë vitit 2024, është dhënë dënimi plotësues “**ndalimi për të ushtruar funksion publik**”, në bazë të nenit 35 të Kodit Penal për **53 persona dhe shoqëri**.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është kërkuar vendosja në regjim të posaçëm për 26 të dënuar. Për 8 të dënuar është refuzim i kërkesës, ndërsa për 6 të dënuar vijon procesi i shqyrtimit

të kërkesës. Janë paraqitur kërkesa nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për vendosje në regjim të posaçëm për 12 të dënuar, miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është kërkuar vendosja në regjim të posaçëm të dënuarve, si dhe vendimmarrja përkatëse e Ministrit të Drejtësisë, pasqyrohet si më poshtë:

- për 26 të dënuar është kërkuar vendosja në regjim të posaçëm dhe për 2 të dënuar është kërkuar zgjatje të afateve për regjim të posaçëm.
- për 12 të dënuar janë paraqitur kërkesa nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për vendosjen në regjim të posaçëm dhe është konfirmuar vendosja në regjim të posaçëm me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë, për 12 prej tyre. Gjithashtu, për 1 të dënuar është paraqitur kërkesa për zgjatje afati, e cila është konfirmuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë.
- për 8 të dënuar është vendosur refuzimi i kërkesës për vendosje në regjim të posaçëm.
- për 6 të dënuar vijon procesi i shqyrtimit të kërkesës në Prokurorinë e Posaçme.
- është bërë ankim në gjykatë kundër Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë për vendosje në regjim të posaçëm nga 12 të dënuar, si dhe nga 1 i dënuar për zgjatje të afatit për regjim të posaçëm.
- për 1 të dënuar GJAKKO ka vendosur ndryshimin e vendimit të GJKKO dhe mospranimin e Urdhrit të Ministrit, duke vendosur daljen nga regjimi i posaçëm të tij.
- për 235 të dënuar janë nxjerrë urdhra për ekzekutimin e vendimeve penale.
- janë nxjerrë 305 vendime, për miratimin e takimeve të paraburgosurve me familjarët e tyre, sipas kërkesave të paraburgosurve apo avokatëve të zgjedhur prej tyre.
- për 96 të dënuar janë nxjerrë vendimet nga prokurori për përfundimin e vuajtjes së dënimit alternativ.

PJESA KRAHASIMORE PËR TË DHËNAT PËR VITIN 2021-2024

Numri i ekzekutimit të vendimeve penale të formës së prerë, si dhe numri i të dënuarve:

Nr.	Të dhënat	2021	2022	2023	2024
1.	numri i vendimeve penale të formës së prerë	77	55	79	79
2.	numri i të dënuarve me vendim formës së prerë	171	207	269	235
3.	numri i të dënuarve për të cilët është dhënë “ndalim për të ushtruar funksione publike”	13	29	85	53

Numri i ankimeve/ rekurseve kundër vendime të Gjykatave:

Nr.	Të dhënat	2022	2023	2024
1.	numri i ankimeve kundër vendime të Gjykatave	37	64	60
2.	numri i rekurseve kundër vendime të Gjykatave	29	92	89

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE HETIMET E PËRBASHKËTA

Sektori është përgjegjës për koordinimin e punës me autoritetet e shteteve të huaja. Sektori shërben si ndërlidhës me autoritetet e huaja në shërbim të ecurisë së hetimeve apo hetimeve të përbashkëta, ekstradimeve, marrëdhënieve me Ministrinë e Drejtësisë, Zyrën Qendrore të Interpol-it, Prokurorin Shqiptar Ndërlidhës në Eurojust, Oficerët Ndërlidhës atashuar pranë Ambasadave të huaja në Tiranë, etj.

I. KËRKESAT PËR NDIHMË JURIDIKE NGA JASHTË VENDIT

Gjatë vitit 2024, nga ana e Sektorit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta, janë trajtuar **70** kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike transmetuar nga autoritetet gjyqësore të huaja, në bazë të konventave të Këshillit të Europës dhe Konventave të Kombeve të Bashkuara, si dhe marrëveshjeve dypalëshe ku Republika e Shqipërisë është palë. Nga totali i kërkesave të transmetuara nga autoritetet e huaja janë ekzekutuar **56** kërkesa për ndihmë juridike. Ndërkohë **14** kërkesa për ndihmë juridike, të cilat janë administruar në fund të vitit 2024, janë mbartur në vitin 2025 dhe janë në fazë ekzekutimi.

Objekti i kërkesave për ndihmë juridike është kryerja e veprimeve të ndryshme hetimore në territorin e Republikës së Shqipërisë për llogari të autoriteteve të huaja, kontrolli i ambienteve apo sekuestrimi i pasurive të luajtshme, të paluajtshme apo vlerave monetare në Cash. Ndarja sipas objektit të këtyre 70 kërkesave është si më poshtë:


- **60** kërkesa me objekt kryerjen e veprimeve të ndryshme hetimore;
- **7** kërkesa me objekt kontroll ambientesh;
- **3** kërkesa me objekt sekuestrimin e pasurive.

Kohëzgjatja e ekzekutimit të këtyre kërkesave varion nga 2 javë deri në 6 muaj, kjo në varësi të objektit të kërkesës, apo numrit të madh të personave, për të cilët kërkohet kryerja e veprimeve.

Gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të kërkesave, Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar është në kontakt të vazhdueshëm me autoritetet e huaja, si dhe autoritetet e zbatimit ligjit në Shqipëri, me qëllim koordinimin e punës për ekzekutimin në kohë dhe brenda standardeve ligjore të këtyre kërkesave. Konstatohet rritja e rasteve, që autoritetet e huaja marrin pjesë dhe drejtpërdrejt në ekzekutimin e kërkesave, në bashkëpunim me Prokurorinë e Posaçme, Byronë Kombëtare të Hetimit dhe Policinë e Shtetit. Në shumë raste është aplikuar gjithashtu dhe dorëzimi drejtpërdrejt autoriteteve të huaja të akteve të administruara, përfshirë dhe prova materiale të sekuestruara, në ekzekutim të kërkesës për ndihmë juridike.

Kërkesat për ndihmë juridike janë drejtuar nga ana e autoriteteve gjyqësore të huaja të vendeve Evropiane, Rajonit, si dhe vendeve të Amerikës Latine, për kryerjen e veprimeve hetimore në Republikën e Shqipërisë lidhur me hetime në kuadër të hetimeve për veprat penale kryesisht në fushën e trafikimeve të lëndës narkotike, pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale, terrorizmit, mashtrimit, mashtrimit kompjuterik, vjedhje, të kryera në formën e bashkëpunimit, asaj të grupit të strukturuar kriminal, etj., parashikuar nga nenet 283/a, 287, 230, 143, 143/b, 134, 28, 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

Ndarja sipas shteteve do të ishte, Italia me numrin më të madh të kërkesave 13 kërkesa, Belgjika dhe Gjermania me nga 10 kërkesa, Franca 7 kërkesa, Holanda 5 kërkesa, Kosova 4 kërkesa, Peruja, Spanja, Anglia dhe Maqedonia e Veriut me nga 3 kërkesa, Polonia dhe Ekuadori me nga 2 kërkesa dhe Greqia, Serbia, Austria, Zvicra dhe Çekia me nga 1 kërkesë.




II. KËRKESAT PËR NDIHMË JURIDIKE PËR JASHTË VENDIT

Për nevoja të hetimeve nga Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme në vitin 2024, janë përpiluar 163 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike drejtuar autoriteteve gjyqësore të huaja, për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar, si vijon: “shpërdorimi i detyrës”, “shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, “korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, “refuzimi për deklarimin, mos deklarimin, fshehjen ose deklarimin e rremë të pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër, që ka detyrimin ligjor për deklarim”, “ekspertimi i rremë”, “korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, “korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, “trafikimit të narkotikëve”, “pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale”, “mashttrimit”, “mashttrimit kompjuterik”, “organizata terroriste”, “pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj”, “vrasje me paramendim e mbetur ne tentative”, “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, “vrasje e funksionarëve publikë”, “vjedhje”, “vjedhje me dhunë”, “vjedhje me armë”, “falsifikimit të dokumenteve”, etj., vepra këto të kryera në forma të veçanta të bashkëpunimit asaj të grupit të organizuar apo të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 248, 258, 260, 257/a, 309, 319, 319/ç, 283/a, 287, 143, 143/b, 234/a, 265/a, 78, 79, 79/a, 134, 139, 140 186, 28, 333/a dhe 334, të Kodit Penal.

Ndarja sipas shteteve për kërkesat për ndihmë juridike të dërguara nga Prokuroria e Posaçme do të ishte: Franca 40 kërkesa, Italia 21 kërkesa, Holanda 14 kërkesa, Anglia 11 kërkesa, SHBA 9 kërkesa, Greqia 7 kërkesa, Gjermania, Brazili dhe Kosova me nga 6 kërkesa, Spanjë, Belgjikë dhe

Zvicër me nga 4 kërkesa, Ekuador dhe Serbi, me nga 3 kërkesa, Austria dhe Maqedonia e Veriut me nga 2 kërkesa, Kroacia, Malta, Portugali, San Marino, Bosnje Hercegovinë, Danimarka, Kolumbia, Hungaria, Singapori, Bullgaria, Paraguaji, Malajzia, Republika Domenikane, Mali i Zi dhe Polonia me nga 1 kërkesë.



Nga totali prej 163 kërkesa për ndihmë juridike të dërguara nga Prokuroria e Posaçme, autoritetet e huaja kanë ekzekutuar 42 kërkesa, të cilat të detajuara sipas shteteve do të ishin: Franca 8 kërkesa, Italia 5 kërkesa, Greqia dhe Kosova 4 kërkesa, Holanda, Spanja dhe Gjermania 3 kërkesa, SHBA, Austria dhe Maqedonia e Veriut 2 kërkesa, Turqia, Danimarka, Zvicra, Hungaria, Bosnje Hercegovina dhe San Marino 1 kërkesë. Ndërsa 9 kërkesa janë ekzekutuar pjesërisht, të detajuara sipas shteteve do të ishin: SHBA dhe Holandë 2 kërkesa, Brazili, Portugalia, Bullgaria, Turqia, dhe Italia 1 kërkesë.

III. TRANSFERIMET E PROCEDIMEVE PENALE

Gjatë vitit 2024 autoritetet e huaja të drejtësisë dhe konkretisht Belgjika, Gjermania dhe Franca, kanë transferuar 3 procedime penale, për të cilat janë regjistruar procedimet penale përkatëse në Prokurorinë e Posaçme. Ndërkohë, Prokuroria e Posaçme ka vendosur transferimin e një procedimi penal për tek autoritetet e drejtësisë të Maqedonisë së Veriut.

IV. HETIMET PASURORE

Spektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar ka vlerësuar kërkesat për ndihmë juridike, të transmetuara nga autoritetet e huaja, edhe si një mundësi për të regjistruar hetime pasurore, bazuar në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar. Gjatë vitit 2024, janë evidentuar nga Spektori dhe në vijim janë regjistruar nga prokurorët e posaçëm **5 kërkesa për**

verifikim pasuror. Këto verifikime pasurore, për të cilat vazhdojnë hetimet, janë bërë bazuar në 1 kërkesë për ndihmë juridike e ardhur nga Gjermania dhe në 4 kërkesa për ndihmë juridike të ardhura nga Belgjika.

V. SEKUESTRIMET

Në vitin 2024, në zbatim të kërkesave për ndihmë juridike të autoriteteve të huaja me objekt sekuestrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe në vijim të vendimeve gjyqësore të cilat kanë lejuar ekzekutimin e tyre, është vijuar edhe me sekuestrimet e pasurive për llogari të këtyre autoriteteve. Janë sekuestruar në total 6 Pasuri të paluajtshme, 1 Automjet, si dhe vlera monetare në llogari bankare prej 100.646,00 Euro, cash në shumat prej 44.750 Euro dhe 6,000 Paund. Më konkretisht:

1. Për llogari të autoriteteve italiane – 5 pasuri të paluajtshme, 1 automjet, si dhe cash në shumat prej 44.750 Euro dhe 6,000 Paund;
2. Për llogari të autoriteteve belge – 1 pasuri e paluajtshme, si dhe llogari bankare me vlerë monetare prej 100. 646,00 Euro;

Këto pasuri të sekuestruara, po administrohen dhe menaxhohen nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në zbatim të ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”.

SHËNIM:

Nga ana e Prokurorisë së Posaçme në mënyrë të vazhdueshme i është kërkuar informacion autoriteteve të huaja të drejtësisë, për llogari të cilave janë bërë sekuestrimet, në lidhje me ecurinë e proceseve gjyqësore, me qëllim administrimin e vendimeve përfundimtare për këto pasuri të sekuestruara, si dhe përcaktimin e mënyrës se si do të procedohet me to në rast konfiskimi.

VI. KONTROLLET E AMBIENTEVE

Nga autoritetet gjyqësore të huaja për vitin 2024, janë paraqitur 7 kërkesa për ndihmë juridike me objekt jo vetëm kryerjen e veprimeve hetimore, por dhe për kontrollin e ambienteve të ndryshme (private apo biznese) në territorin e Republikës së Shqipërisë. Pas marrjes së vendimit të lejimit të kontrolleve nga gjykata, në të gjitha rastet Sektori ka bërë koordinimin e punës ndërmjet autoriteteve të huaja me hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe punonjësit e Policisë së Shtetit, me qëllim realizimin sa më efektiv të kontrolleve dhe administrimin e provave të sekuestruara gjatë kontrolleve. Shtetet të cilat kanë kërkuar kontrollin e ambienteve janë, Gjermania, Italia, Belgjika, Holanda.

VII. SKUADRAT E PËRBASHKËTA HETIMORE

Një tjetër fushë shumë e rëndësishme e bashkëpunimit ndërkombëtar, është dhe krijimi i Skuadrave të Përbashkëta Hetimore. Në vitin 2024 janë krijuar 10 Skuadra të Përbashkëta Hetimore me autoritetet e huaja të drejtësisë. Gjatë vitit 2024, kanë vijuar hetimet për 27 Skuadra të Përbashkëta Hetimore, aktive të krijuara gjatë viteve 2020-2024, në funksion të hetimeve për veprat penale të “trafikimit të narkotikëve”, “pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale”, “mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, “trafikimit të personave”, “falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave ose i vizave”,

“ndihma për kalim të paligjshëm”, “kontrabanda me mallra për të cilët paguhet akcizë ose më pezullim të plotë apo të pjesshëm nga detyrimet doganore ose të akcizës”, “mashttrimi kompjuterik”, vepra të kryera në formën e bashkëpunimit të veçantë të grupit të organizuar dhe strukturuar kriminal, parashikuar nga Kodi Penal, në nenet 110/a 283/a, 28, 287, 278, 189, 298, 172, 143/b, 333/a dhe 334.

Ndarja sipas shteteve për skuadrat e krijuara në vitin 2024 do të ishte, **Italia** me numrin më të madh me 5 Skuadra të Përbashkëta, dhe **Anglia, Spanja, Ekuadori, Kosova dhe Gjermania** me nga 1 Skuadër të Përbashkët Hetimore.

Në kuadër të Skuadrave të Përbashkëta Hetimore, gjatë vitit 2024, janë mbajtur 18 takime koordinuese me autoritetet e huaja palë në këto skuadra, përveç mbledhjeve të përbashkëta të realizuara nëpërmjet video-konferencës.

Përsa i përket efektivitetit të aksioneve/operacioneve të përbashkëta realizuar me partnerët ndërkombëtarë në kuadër të skuadrave të përbashkëta hetimore rezulton se, gjatë vitit 2024 janë regjistruar emrat për 166 shtetas si persona nën hetim, si dhe janë caktuar nga gjykatat 147 masa sigurimi personal. Të detajuara të dhënat si më poshtë:

1. Në kuadër të Procedimit Penal Nr. 270, të vitit 2021 dhe Skuadrës të Përbashkët Hetimore me autoritetet italiane, nën Koordinimin e Eurojust është zhvilluar një operacion i përbashkët gjatë së cilit janë caktuar 92 masa sigurimi penal, 6 prej të cilave në Shqipëri. Nga këto 92 masa sigurimi, 65 prej tyre janë caktuar për shtetas shqiptarë;
2. Në kuadër të Procedimit Penal Nr. 301/1, të vitit 2021 dhe Skuadrës të Përbashkët Hetimore janë nën hetim 5 persona, ku nga këto janë caktuar 4 masa sigurimi “arrest në burg” dhe 1 masë sigurimi “arrest shtëpie”;
3. Në kuadër të Procedimit Penal Nr. 296, të vitit 2021 dhe Skuadrës të Përbashkët Hetimore me autoritetet e Italisë dhe Ekuadorit, janë nën hetim 2 persona;
4. Në kuadër të Procedimit Penal Nr. 38, të vitit 2023 dhe Skuadrës të Përbashkët Hetimore me autoritetet e Francës janë caktuar 3 masa sigurimi “arrest në burg”;
5. Në kuadër të Procedimit Penal Nr. 188, të vitit 2023 dhe Skuadrës të Përbashkët Hetimore me autoritetet e Kosovës janë 27 persona nën hetim, ku nga këto janë caktuar 21 masa sigurimi “arrest në burg”, 3 masa sigurimi “arrest në shtëpi” dhe 2 masa “detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore”;
6. Në kuadër të Procedimit Penal Nr. 177, të vitit 2022 dhe Skuadrës të Përbashkët Hetimore me autoritetet e Spanjës janë 37 persona nën hetim, ku nga këto janë caktuar 27 masa sigurimi “arrest në burg”, 9 masa sigurimi “arrest në shtëpi” dhe 1 masë “detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore”;

VIII. URDHRAT PËR SHPALLJEN NË KËRKIM NDËRKOMBËTAR

Në vitin 2024, prokurorët e Prokurorisë së Posaçme kanë bërë procedurën e shpalljes në kërkim ndërkombëtar për 117 persona. Nga prokurorët e posaçëm është plotësuar dokumentacioni i nevojshëm dhe në vijim është bashkëpunuar ngushtësisht me Ministrinë e Drejtësisë, Zyrën

Qendrore të Interpol-it, Prokurorët dhe Oficerët Ndërlidhës të autoriteteve të huaja, që mbulojnë Shqipërinë me qëllim identifikimin e shtetasve të shpallur në kërkim ndërkombëtar dhe arritjen e kapjes dhe ekstradimit të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, në zbatim të ekzekutimit vendimeve të gjykatës për caktimin e masave të sigurimit apo vendimeve të formës së prerë të dënimeve. Veprat penale për të cilat janë akuzuar personat e shpallur në kërkim ndërkombëtar kanë qenë kryesisht ato të parashikuara nga nenet, 78, 79/dh, 80, 143/b, 189, 190, 245, 259, 278, 284, 287, 283/a, 298/2, 319/ç, 28/4, 333/a, 334 të Kodit Penal.

IX. EKSTRADIMET

Prokuroria e Posaçme, gjatë vitit 2024, ka transmetuar pranë Ministrisë së Drejtësisë **41** kërkesa për ekstradim nga jashtë vendit në Shqipëri, kryesisht për shtetas të akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet, 78, 79/a-22, 79/dh, 80, 109, 134, 189, 243, 258-25, 278, 283/a, 284, 287, 298, 319, 28/4, 333/a dhe 334, të Kodit Penal.

TABELA KRAHASUESE PËR VITET 2021-2024

LLOJI I KËRKESAVE	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
Kërkesa për Ndihmë Juridike nga Jashtë Vendit	77	54	48	70
Kërkesa për Ndihmë Juridike për Jashtë Vendit	51	62	121	163
Skuadrat e Përbashkëta Hetimore	5	10	10	10
Shpalljet në kërkim ndërkombëtar	15	42	72	117
Kërkesat për ekstradim	17	10	39	41

Duke iu referuar tabelës së lartpërmendur vërehet një rritje e ndjeshme e volumit të punës të Sektorit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Ndërlidhës në Hetimet e Përbashkëta, si dhe Prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme në vitin 2024, e pasqyruar kjo në rritjen e ndjeshme të numrit të kërkesave për ndihmë juridike transmetuar nga autoritetet e huaja, në rritjen e ndjeshme të numrit të kërkesave për ndihmë juridike drejtuar autoriteteve të huaja, në operacionet e përbashkëta me autoritetet e huaja në kuadër të Skuadrave të Përbashkëta Hetimore, në shpalljet e personave në kërkim ndërkombëtar, si rrjedhojë edhe rritjen e kërkesave për ekstradim.

Është rritur ndjeshëm edhe komunikimi i drejtpërdrejtë i Prokurorisë së Posaçme me autoritetet homologe Evropiane, të Rajonit, Amerikane, gjithashtu, edhe me autoritetet homologe të vendeve të Amerikës Jugut. Është rritur ndjeshëm shkëmbimi informacionit edhe nëpërmjet rrjeteve dhe kanaleve të sigurta të komunikimit si, Eurojust, Interpol, Europol, etj. Vazhdon gjithashtu intensiv dhe në rritje komunikimi me prokurorët dhe oficerët ndërlidhës, që mbulojnë Shqipërinë, të atashuar pranë Ambasadave të Huaja në Tiranë, apo jashtë Shqipërisë. Ky lloj komunikimi i drejtpërdrejtë ndikon në forcimin e bashkëpunimit dhe rritjen e efektivitetit në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

X. PROJEKTET NDËRKOMBËTARE NË MBËSHTETJE TË SPAK

Edhe gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme, ka vazhduar të asistohet në punën e saj nga programe të mbështetura SH.B.A., të cilat synojnë përmirësimin e drejtësisë kriminale të Shqipërisë dhe

sektorin e zbatimit të ligjit — Programi Tejoqeanik i Ndhmës dhe i Trajnimit të Zhvillimit të Prokurorisë (OPDAT) dhe Programi Ndërkombëtar i Ndhmës së Trajnimit të Hetimit Kriminal (ICITAP), përfaqësues të së cilave janë të vendosur dhe fizikisht në ambientet e kësaj prokurorie.

Misioni OPDAT është përfshirë në rishikimin e legjislacionit të drejtësisë kriminale, trajnimin e prokurorëve, gjyqtarëve, oficerëve të policisë, në dhënien e pajisjeve për zbatuesit e ligjit dhe dhënia e ndihmës teknike që synon vendosjen e strukturave më efektive të zbatimit të ligjit. Ky misioni me anë të Këshilltarëve Ligjor të Përherëshëm, gjatë periudhës, që nga krijimi e në vazhdim, ka ofruar ekspertizë dhe asistencë të bazuar në çështje konkrete për prokurorët në veçanti, por edhe më gjerë në sistemin e drejtësisë dhe në ndihmën për marrëdhëniet e kësaj prokurorie ndërkombëtarisht, me synimin për ta ndihmuar në luftën e saj kundër krimit ndërkombëtar, korrupsionit dhe terrorizmit.

Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnimet për Hetimet Kriminale ICITAP, është një program, i cila ka si synim zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve të zbatimit të ligjit, në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. ICITAP edhe gjatë vitit 2024, ka mbështetur Byronë Kombëtare të Hetimit duke organizuar një sërë trajnimesh të specializuara për përmirësimin e kapaciteteve hetimore, si dhe ka mbështetur të gjithë strukturën e Prokurorisë së Posaçme, me mjete logjistike, pajisje elektronike Software, sisteme informatike etj.

Projekti EU4FOCAL, i financuar nga Bashkimi Europian, në kuadër të programi të asistencës IPA 2020, *“Lufta kundër Krimit të Organizuar në Shqipëri nëpërmjet Hetimit Penal dhe atij Financiar”*, vijon të mbështesë SPAK edhe për vitin 2024. Ky projekt është përfshirë në draftimin e një manuali, me qëllim azhurnimin e të dhënave përsa i përket pastrimit të parave dhe konfiskimit të aseteve me prejardhje kriminale. Për realizimin e këtij objekti është krijuar një grup pune me prokurorë nga Prokuroria e Përgjithshme, SPAK, si dhe ekspertë të huaj, të cilët kanë kryer një sërë aktiviteteve të ndryshme.

Projekti EU4LEA është një projekt asistencë teknike i financuar nga BE me një mundësi për të ofruar pajisje, i projektuar për të mbështetur dhe ndihmuar agjencitë kryesore të zbatimit të ligjit shqiptar në veçanti Policinë e Shtetit Shqiptar, Ministrinë e Brendshme, Prokurorinë e Posaçme dhe BKH, Prokurorinë e Përgjithshme, përfshirë ato të Juridiksionit të Përgjithshëm, në arritjen e objektivave të tyre dhe përafrimin e performancës së tyre me standardet më të mira të BE-së. Objekti i përgjithshëm i projektit EU4LEA është të kontribuojë në fuqizimin e zbatimit të ligjit në Shqipëri. Objektivat specifike të projektit EU4LEA janë:

1. Përmirësimi i performancës të Policisë së Shtetit Shqiptar (PSHSH), SPAK-ut, Prokurorisë të Përgjithshme dhe agjencive përkatëse në luftën kundër krimit të organizuar/krimit të rëndë, korrupsionit në nivele të larta dhe krimit mjedisor.

2. Përmirësimi i Menaxhimit të Integruar të Kufirit Kombëtar.

Për të përmbushur objektivat e përcaktuara, fokusi i projektit ka qenë, si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor. Projekti ka hartuar dhe zbatuar trajnime të përshtatura, duke përfshirë trajnimin në punë dhe asistencën për zhvillimin e kapaciteteve, me objektiv forcimin e bashkëpunimit ndërmjet policisë, prokurorëve, qeverive vendore dhe palëve të tjera të interesuara.

Gjithashtu, janë kryer lloje të ndryshme aktiviteteve, mbështetje këshillimore si teknike dhe strategjike, vlerësime/analiza ligjore, përmbledhje e *acquis*-it përkatëse të BE-së, gamë e gjerë trajnimesh/seminaresh, ushtrime praktike simuluese në nivel qendror dhe vendor, vizita studimore në agjencitë e BE-së /vendeve anëtare të BE-së, rishikim/monitorim i rasteve penale, vizita në terren, etj.

Projekti EU4FAST (Mbështetje për Parandalimin dhe Luftimin e Kontrabandës së Emigrantëve dhe Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Ballkanin Perëndimor).

Qëllim i këtij projekti është përmirësimi i kushteve për parandalimin dhe luftimin e kontrabandës së emigrantëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore në Ballkanin Perëndimor.

Ky projekt synon të forcojë aftësinë e autoriteteve ligj zbatuese dhe gjyqësore të Ballkanit Perëndimor për të luftuar kontrabandën e emigrantëve dhe trafikimin e qenieve njerëzore, aftësinë e aktorëve të zbatimit të ligjit të Ballkanit Perëndimor për të bashkëpunuar me Shtetet Anëtare, dhe aktorët e zbatimit të ligjit jo anëtarë në BE në aktivitetet, që lidhen me kontrabandën e emigrantëve dhe trafikimin e qenieve njerëzore, të forcojë kapacitetin e autoriteteve kufitare të Ballkanit Perëndimor për të parandaluar dhe luftuar kontrabandën dhe trafikimin e qenieve njerëzore në përputhje me standardet e BE-së dhe të drejtat e njeriut.

Projekti WBCJ Western Balkan Criminal Justice (Drejtësia Penale e Ballkanit Perëndimor)

Eurojust për dy dekadat e fundit ka ofruar mbështetje dhe ndihmë operacionale për shtetet anëtare të BE-së, me fokus të veçantë në lehtësimin e bashkëpunimit gjyqësor. Projekti i Drejtësisë Penale të Ballkanit Perëndimor (WBCJ) u zhvillua për të shtrirë këtë mbështetje operacionale për partnerët e Ballkanit Perëndimor, edhe në rastet kur asnjë vend i BE-së nuk është i përfshirë drejtpërdrejt.

Qëllimi i Projektit WBCJ është të forcojë bashkëpunimin brenda Ballkanit Perëndimor dhe midis rajonit dhe Bashkimit Evropian në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, duke përdorur mjete dhe instrumente moderne. Pajisja e partnerëve të Ballkanit Perëndimor me mjetet dhe metodat e punës të bashkëpunimit gjyqësor të BE-së - si takimet e koordinimit, qendrat koordinuese dhe Skuadrat e Përbashkëta Hetimore (SPH) - është thelbësore për rezultatin e suksesshëm të hetimeve ndërkufitare.

Projekti jep mbështetje dhe asistencën lidhur me ekspertizat dhe praktikat më të mira nga Eurojust dhe vendet anëtare të BE-së për mënyrën e përdorimit të mjeteve dhe instrumenteve për bashkëpunim gjyqësor, financim direkt për takimet operative (takime koordinuese, qendra koordinuese) dhe aktivitete hetimore ndërmjet partnerëve të Ballkanit Perëndimor, si brenda ashtu edhe jashtë SPH, siguron pajisje moderne, si telefona celulare dhe laptop të sigurtë, si dhe shërbime përkthimi.

Projekti Hollandez MATRA “Strengthening the SPO” (forcimi i Prokurorisë së Posaçme), ka si synim kryesor dhënien e rekomandimeve për forcimin e Prokurorisë së Posaçme në aspekte të ndryshme të organizimit të saj dhe funksioneve mbështetëse më të mira, rritjen e uniformitetit të proceseve të punës duke u fokusuar kryesisht në lehtësimin e punës së prokurorëve, nëpërmjet aktivizimit më efektiv të stafit administrativ, hetuesve dhe ndihmësve ligjorë. Në kuadër të së cilit është zhvilluar edhe një vizitë studimore me qëllim shkëmbimin e eksperiencave lidhur me

funksionimin e prokurorive homologe dhe agjencive ligj zbatuese në Hollandë, duke sugjeruar gjithashtu edhe për ndryshime apo nisma të reja strukturore dhe ligjore për arritjen e këtij qëllimi.

XI. VIZITA STUDIMORE/TRAJNIME/KONFERENCA JASHTË SHTETIT

Për vitin 2024, përveç takimeve koordinuese në kuadër të skuadrave të përbashkëta nga prokurorët janë kryer 40 Trajnime /Takime / Konferenca / Forume jashtë vendit, kryesisht në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Gjithashtu prokurorë të SPAK kanë marrë pjesë në 2 takime raportuese jashtë vendit në kuadër të Moneyval.

XII. MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT, MEMORANDUME ME AGJENCITË VENDASE DHE TË HUAJA

Një tjetër aspekt i punës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, ka qenë dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të përbashkëta të bashkëpunimit me prokuroritë e shteteve të ndryshme të Bashkimit Europian dhe Rajonit. Gjatë vitit 2024 janë nënshkruar edhe 3 Marrëveshje të reja bashkëpunimi konkretisht:

- Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare kundër Krimit të Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut (NCA) dhe Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nënshkruar më datë 22.02.2024;
- Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Bashkëpunimin ndërmjet Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Republikës së Shqipërisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Mbretërisë së Spanjës, nënshkruar më datë 11.04.2024;
- Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Bashkëpunimin ndërmjet Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Republikës së Shqipërisë dhe Prokurorisë Speciale të Malit të Zi, nënshkruar më datë 17.12.2024.

XIII. PROBLEMATIKA

1. Vijnë të mbetet problematike statusi i 3 Ndërlidhësve në Sektorin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta, të cilët aktualisht trajtohen si nëpunës civil, bazuar në Ligjin Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” dhe ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar. Kjo situatë është në kundërshtim me funksionet që duhet të kryejë Ndërlidhësi sipas ligjit nr. 95/2016, pasi kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale dërguar nga/për autoritetet e huaja, si dhe hetimet e përbashkëta, bazohen në Konventa shumëpalëshe, dypalëshe, Kodin e Procedurës Penale, si dhe ligjin 10.193 datë 03.12.2009 “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale”, të ndryshuar, të cilat kanë si objekt kryerjen e **veprimeve procedurale**, dhe jo të veprimeve administrative. Për të njëjtën punë të kryer në Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, specialistët përkatës kanë statusin e Oficerit të Policisë Gjyqësore.

Në situatën aktuale ku Ndërlidhësit kanë statusin e “nëpunësit civil”, ata nuk mund të kryejnë veprimet procedurale, por vetëm veprime administrative dhe ndihmëse. Këto veprime procedurale

deri më tani janë të detyruar t'i kryejnë kryesisht nga Hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, Hetuesit Financiarë të Prokurorisë së Posaçme, si dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për të cilët është një volum i shtuar në detyrat funksionale të përditshme të tyre, duke marrë në konsideratë edhe ngarkesën e shtuar vit pas viti, e reflektuar kjo edhe nga raporti vjetor i Prokurorisë së Posaçme.

Duke marrë në konsideratë faktin se kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike, dhe skuadrat përbashkëta hetimore, janë në rritje, referuar statistikave vjetore, është e domosdoshme që të bëhen ndryshimet përkatëse ligjore dhe Ndërlidhësit e këtij sektori të kenë atributet e Oficerit të Policisë Gjyqësore.

2. Vijon të mbetet problematike gjatë punës së hasur nga Sektori i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe hetimeve të përbashkëta mungesa e kompetencës për shqyrtimin e kërkesave të autoriteteve të huaja lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale të huaja në Shqipëri në ngarkim të shtetasve shqiptarë për veprat penale për të cilat Prokuroria e Posaçme ka në kompetencë, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale; paraqitja e kërkesave për njohjen dhe ekzekutimet e vendimeve penale të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nga një shtet i huaj; gjithashtu dhe rastet e realizimit të procedurës të ekstradimit për jashtë të shtetasve shqiptarë, me arsyetimin si më poshtë:

- Prokuroria e Posaçme nuk mund të shqyrtojë kërkesat e autoriteteve të huaja për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale, apo ekstradimet për jashtë, për veprat penale që ka në kompetencë, pasi ligji nr. 10 193, datë 3.12.2009 “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale”, të ndryshuar, si dhe Kodi i Procedurës Penale këtë kompetencë ia jep Prokurorit të Rrethit Gjyqësor të vendbanimit ose vendqëndrimit të personit, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm;
- Gjithashtu, Prokuroria e Posaçme nuk mund të paraqesë një kërkesë për njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi penal të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga një shtet i huaj, në rastet kur ky vendim nuk mund të ekzekutohet brenda territorit shqiptar, ose në rastet kur një shtet i huaj refuzon ekstradimin e një shtetasi të shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Prokuroria e Posaçme, për shkak të shtetësisë së tij sipas nenin 6/2 të Konventës Evropiane për Ekstradimin e vitit 1959, pasi këtë kompetencë ligji i lartpërmendur sipas nenit 62, pika “2” ia atribuon Prokurorisë së Përgjithshme.

Për këtë arsye, sa më lart, propozojmë ndryshimet e ligjit nr. 10 193, datë 3.12.2009, “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale”, të ndryshuar, konkretisht në **nenin 53** e në vijim, **nenin 60** e në vijim të **Kreut IV “Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve penale”, Seksioni I “Ekzekutimi i vendimeve penale të huaja”,** si dhe **nenit 62** e në vijim të **Kreut IV “Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve penale”, Seksioni II “Ekzekutimi i Vendimeve Penale Shqiptare Jashtë Shtetit”,** duke i dhënë Gjykatës Posaçme dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar kompetencën për shqyrtimin e kërkesave për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale të huaja; për realizimin e procedurës të ekstradimit për jashtë të shtetasve shqiptarë; si dhe paraqitjen e kërkesave për njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi penal të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e

Organizuar, nga një shtet i huaj për rastet e veprave penale të parashikuara sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

3. Vazhdon dhe mbetet gjithashtu problematike çështja e mos ekstradimit të shtetasve shqiptar të lokalizuar apo arrestuar në Emiratet e Bashkuara Arabe për këtë qëllim.

Kërkesat për ekstradimin e këtyre shtetasve janë bërë në mënyrë të vazhdueshme nga Prokuroria e Posaçme sipas standardeve, kushteve dhe rregullave të përcaktuara në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar të vitit 2000, në të cilën si Shqipëria ashtu dhe Emiratet e Bashkuara janë palë. Nga prokuroria e Posaçme është zbatuar me korrektësi dhe procedura dhe standardet e përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Drejtësisë së Emirateve të Bashkuara. Në çdo rast kemi qenë të gatshëm për të dhënë gjithashtu gjithë informacionin shtesë, apo për të plotësuar çdo akt të kërkuar në mënyrë të përsëritur nga këto autoritete.

BËRTHAMA KOMANDUESE

Përgjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka përdorur metodën e përgjimit për 163 procedime penale.

Bërthama Komanduese Elektronike, ka ekzekutuar në interes të çështjeve penale nën hetim nga Prokuroria e Posaçme:

301 Autorizime të Prokurorit për lejim përgjimi;

2046 Vendime (lejimi, vleftësimi dhe zgjatjeje) të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga të cilat:

- 323 Vendime Lejim Përgjimi
- 274 Vendime Vleftësimi
- 1449 Vendime Zgjatjeje


Gjatë vitit 2024, për veprat penale nën hetim nga Prokuroria e Posaçme, janë interceptuar 3096 pajisje fundore (pajisja/numri telefonik i subjektit në përgjim).

Tabela përmbledhëse më poshtë.

2 0 2 4												
Procedime Penale	Nr. I Targeteve gjithsej	Autorizim Prokurori	Vendime Vleftësimi	Vendime Lejimi	Vendime Zgjatje	Vendime Gjykatë gjithsej	Transkripte	Flete	BD-R	DVD	Te Ndahuar	Transkripte ne sistem
163	3096	301	274	323	1449	2046	10415	13444	53	31	175	10704

Krahasuar me vitet e mëparshme, referuar vendimeve për zgjatje të gjykatës, kemi një rritje të ngarkesës së punës me 22.6%, sipas tabelës së mëposhtme:

Pasqyrë përmbledhëse për periudhën janar – dhjetor 2020-2021-2022-2023-2024	2020	2021	2022	2023	2024	Krahasuar me vitin 2023 në %
Procedime penale	91	129	122	186	163	↓ 12.3%
Pajisje fundore	1373	1957	2177	3335	3096	↓ 7.1%
Vendime gjykate	943	1204	1000	1669	2046	↑ 22.6%
Autorizime të prokurorit	391	411	328	358	323	↓ 9.7%



Gjatë vitit 2024, Hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit pranë kësaj zyre kane qenë të përkushtuar në përmbushjen e detyrave funksionale të tyre në procesin e realizimit të procesit të përgjimit dhe të transkriptimit.

Në periudhën që analizojmë nuk ka ndodhur asnjë rast dekonspirimi i të dhënave të përfituara nga interceptimi.

PROBLEMATIKA DHE PRIORITETE

Rritja e kapacitetit të memories së sistemit është një prioritet kritik për të përballuar ngarkesën në rritje të sistemit.

Gjatë vitit 2023 dhe viti 2024 ka patur një rritje 100% të ngarkesës në lidhje me vitet e mëparshme. Si rrjedhojë, hapësira e sistemit ku ruhen të dhënat është e nevojshme të rritet. Për këtë arsye, rritja e kapacitetit të memories së sistemit të përgjimit është një nga prioritetet e vitit të ardhshëm.

SEKTORI I EKSPERTIZËS

Gjatë vitit 2024, Sektori i Ekspertizës ka mundësuar dhe ofrimin e shërbimit të ekspertizës në fushën ekonomiko-financiare, nëpërmjet Ekspertit të kësaj fushe duke realizuar 2 Akte Ekspertimi, nga të cilat një në fushën e procedimit penal dhe një në fushën e procedimit pasuror me objekt analize ekonomiko-financiare për individët, personat e lidhur dhe subjektet tregtare pjesë e hetimit. Në përmbushje të detyrave funksionale, eksperti i fushës ka dhënë asistencën në fushën financiare në ndihmë të identifikimit të pastrimit i të ardhurave nga korrupsioni, i krimeve në fushën e tatimeve, apo vepra të tjera penale të kryera përmes përdorimit herë pas here dhe të palëve të treta (individë dhe persona juridik), që shërbejnë për të kamufluar mekanizmin dhe integrimin e mëvonshëm në instrumente financiare, në pasuri të paluajtshme brenda vendit, apo në biznese brenda dhe jashtë vendit.

Për periudhën vijuese mbetet prioritet përgatitja e udhëzuesit praktik dhe manualit mbi procedurat dhe kërkesat standarde lidhur me ekspertimin ekonomiko -financiar.

Shërbimet në fushën elektronike-dixhitale nga sektori i ekspertizës

Gjatë vitit 2024 në Sektorin e Ekspertizës kanë ardhur për ekspertim 400 vendime ekspertimi për 841 prova digjitale dhe konkretisht për 553 telefona celularë dhe tabletë, 110 kompjutera, 16 DVR dhe 162 prova të tjera digjitale (hard disqe, USB, karta memorie, CD/DVD, etj.), kjo krahasuar me vitet si me poshtë është në rritje dhe konkretisht:

Për vitin 2023 në Sektorin e Ekspertizës kanë ardhur për ekspertim 345 vendime ekspertimi për 623 prova në total dhe konkretisht 407 telefona celularë, 76 kompjutera, 19 DVR dhe 121 prova të tjera digjitale (USB, karta memorie, CD/DVD, etj.).

Për vitin 2022 kanë ardhur për ekspertim 240 vendime ekspertimi për 500 prova digjitale dhe konkretisht 328 telefona celularë, 59 kompjutera, 11 DVR dhe 102 prova të tjera digjitale (USB, karta memorie, CD/DVD, etj.).

Akte ekspertimi të realizuara:

Gjatë vitit 2024 nga ekspertët e këtij sektori janë realizuar 293 akte ekspertimi, ku janë ekzaminuar 520 prova digjitale në total dhe konkretisht 344 telefona celularë, 58 kompjutera, 2 DVR dhe 116 prova të tjera digjitale (si hard disqe, USB, karta memorie, CD/DVD, etj.).

Gjatë vitit 2023 nga ekspertët e këtij sektori janë realizuar 261 akte ekspertimi, ku janë ekzaminuar 453 prova digjitale në total dhe konkretisht 321 telefona celularë, 37 kompjutera, 20 DVR dhe 75 prova të tjera digjitale (si hard disqe, USB, regjistruar, tableta, karta memorie, CD/DVD, etj.).

Për vitin 2022 nga ekspertët e këtij sektori janë realizuar 256 akte ekspertimi, ku janë ekzaminuar gjithsej 423 prova digjitale dhe konkretisht 313 telefona celularë, 40 kompjutera, 7 DVR dhe 63 prova të tjera digjitale (si hard disqe, USB, regjistruar, tableta, karta memorie, CD/DVD, etj.).

Sa i përket vitit 2021, në këtë vit Sektori i Ekspertizës ka filluar aktivitetin e tij, ku vendimet e para të ekspertimit kanë filluar të pranohen në muajin Shtator.

Për periudhën Shtator-Dhjetor 2021 kanë ardhur për ekspertim pranë këtij sektori 118 vendime ekspertimi për 174 telefona celularë, 50 kompjutera dhe 49 prova të tjera elektronike (DVR, USB, CD/DVD, kamera/aparate fotografike digjitale, etj.).

Gjatë periudhës Shtator-Dhjetor 2021 janë realizuar 35 akte ekspertimi.

Për vitin 2024 janë realizuar 32 akte ekspertimi më shumë se viti 2023, si dhe janë ekzaminuar 67 prova digjitale më shumë.

Po kështu gjatë këtij viti ekspertët e këtij sektori janë angazhuar edhe në 26 veprime të ndryshme procedurale, si këqyrje apo kontrole për sekuestrim provash digjitale dhe të dhënash kompjuterike në ambiente të ndryshme. Kanë dhënë kontribut edhe për Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Policinë e Shtetit, ku për llogari të tyre gjatë vitit 2024 janë realizuar 15 Akte Ekspertimi.

Viti 2024

Akte Ekspertimi të realizuara	Prova materiale të ekzaminuara				
	Telefona	Kompjutera	DVR	Të tjera (HDD, USB, CD/DVD, etj.)	Prova në total
293	344	58	2	116	520

Viti 2023

Akte Ekspertimi të realizuara	Prova materiale të ekzaminuara				
	Telefona	Kompjutera	DVR	Të tjera (HDD, USB, CD/DVD, etj.)	Prova në total
261	321	37	20	75	453

Viti 2022

Akte Ekspertimi të realizuara	Prova materiale të ekzaminuara				
	Telefona	Kompjutera	DVR	Të tjera (HDD, USB, CD/DVD, etj.)	Prova në total
256	313	40	7	63	423

DREJTORIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (DTI) gjatë vitit ka kryer veprimtarinë si më poshtë:

- Zhvillimi i infrastrukturës kompjuterike
- Përdorimi i Teknologjive të reja për Sigurinë Kibernetike
- Planifikimi dhe dizenjimi i infrastrukturës IT në Godinën e re
- Sistemet për Sigurinë e Godinës
- Menaxhimi dhe përmirësimi i faqes zyrtare
- Mirëmbajtja dhe zhvillimi i Rrjetit të Klasifikuar dhe Rrjetit telefonik
- Aksesimi në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave shtetërore
- Suport për përdoruesit

- Hartimi i dokumentacionit
- Marrja pjesë në komisione dhe grupe pune të ndryshme
- Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë
- Mbështetja Financiare nga institucionet shtetërore

Zhvillimi i infrastrukturës kompjuterike

Gjate vitit 2024 është zhvilluar një ri konfigurim i infrastrukturës qendrore duke shtuar sisteme dhe pajisje të reja të cilat kanë kapacitet e duhura për të garantuar sigurinë e të dhënave, procesimin në kohë reale dhe garantimin e ruajtjes së informacionit nga çdo lloj dëmtimi i mundshëm. Këtu mund të përmendim:

- **Sistemet e sigurisë kibernetike** si Firewall, Antivirus, autentifikimi me dy faktorë 2FA, Sistem për monitorimin në kohë reale të pajisjeve, sistem për gjenerimin dhe menaxhimin e fjalëkalimeve, etj.
- **Sistemet e ruajtjes së të dhënave** si storage, servera platforma virtualizimi, sistem backup dhe siguri ndaj malwareve që enkriptojnë të dhënat (Ransomware)

Këto sisteme janë projektuar për të përmbushur kërkesat në përputhje me kapacitetet e dy datacenterave në të dyja godinat duke ju shërbyer të gjithë përdoruesve sipas organikës së institucionit dhe duke lejuar shtimin modular të kapaciteteve në rast nevojë në të ardhmen.

Përgatitja dhe projektimi i sistemeve elektronike të godinës së re.

Gjatë vitit 2024 DTI ka qenë pjesë e marrjes në dorëzim të godinës së re dhe ka dhënë mbështetjen gjatë gjithë procesit. Gjithashtu, për të avancuar në lidhje me mbarëvajtjen e proceseve të punës, DTI ka projektuar infrastrukturën bazë të IT, skemën e rrjetit kompjuterik i cili do të shërbejë për lidhjen e dy godinave dhe ka kryer parashikimet e nevojshme për pajisje, sisteme ku me kryesoret mund të përmendim:

- **Ndërtimi i datacenterit të ri:** një datacenter (dhome serverësh) me kushtet e duhura teknike është domosdoshmëri për mbarëvajtjen e punës të sistemeve qendrore të IT, për këtë qëllim në godinën e re është planifikuar një datacenter me standardet teknike, pajisjet e nevojshme dhe infrastrukturën e duhur të rrjeteve për të përmbushur qëllimin tu shërbejë punonjësve të godinës dhe në rast avarie të datacenterit të parë të përballojë ngarkesën e të dyja godinave.
- **Blerja e serverëve të rinj së bashku me platformën e virtualizimit** për të garantuar fuqi procesimi, memorie RAM të mjaftueshme për makinat virtuale që kërkohen për përballimin e stafit ekzistues, por gjithashtu dhe shtimi i kapaciteteve në të ardhmen nëse do të jetë e nevojshme.
- **Përmirësimi i kapacitetit të ruajtjes së të dhënave (Storage):** U mundësua ndërtimi i hapësirës për ruajtjen e të dhënave duke krijuar kapacitete me storage të rinj për data centerin e godinës së re në mënyrë që të mbështesë rritjen e volumit të dhënave që krijohen çdo ditë dhe për të mundësuar ruajtjen e tyre minimalisht në më shumë se një kopje duke garantuar sigurinë nga shkaqe të ndryshme si, dëmtimi fizik, sulme kibernetike, apo korrupsioni i të dhënave.

- **Integrimi i platformës virtuale:** Implementimi i teknologjisë së virtualizimit duke përdorur të njëjtën platformë si në datacenterin ekzistues, ka optimizuar përdorimin e burimeve të serverëve dhe ka mundur një menaxhim më të mirë të aseteve IT.

Menaxhimi dhe përmirësimi i faqes zyrtare

Në vitin 2024, një përmirësim i rëndësishëm ka qenë krijimi i rubrikës “**Denonco**”, e cila u mundëson qytetarëve të bëjnë denoncime online në lidhje me çështje që ndodhin brenda institucioneve publike. Kjo mundësi i jep qytetarëve një platformë të lehtë dhe të sigurt për të raportuar aktivitete të dyshimta, duke kontribuar në forcimin e transparencës dhe luftën kundër korrupsionit.

Gjatë vitit 2024, janë publikuar në faqen zyrtare **232 njoftime**, nga të cilat:



- **131 njoftime për shtyp**, që përfshijnë informacione të rëndësishme për media dhe publikime zyrtare të institucionit.
- **101 njoftime për punësim**, që informojnë qytetarët për mundësitë e punës dhe pozitat e lira në institucion.

Këto përmirësime kanë ndihmuar në optimizimin e komunikimit dhe shpërndarjes së informacionit dhe kanë kontribuar në rritjen e besimit të qytetarëve në proceset e administratës publike.

Akresi në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave shtetërore

Sipas ligjit nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit kanë akses të drejtpërdrejtë në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të administruara nga institucionet shtetërore, që përmbajnë informacionin e duhur për hetimin e veprave penale të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

Akresi i drejtpërdrejtë e ka ndihmuar SPAK në kohë reale të informacionit të kërkuar dhe ka shkurtuar kohën e aksesimit të dhënave duke ulur kostot nga komunikimi shkresor dhe gjithashtu ruan sekretin hetimor.

Për të kryer komunikimet me institucionet DTI në çdo rast dhe sa herë është e nevojshme kryen konfigurimet përkatëse në mënyrë që të sigurohet vazhdueshmëria dhe siguria e shkëmbimit të dhënave.

Gjatë vitit 2024 DTI ka mirëmbajtur lidhjet për të gjithë sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të sipër përmendura, gjithashtu ka marrë akses edhe për baza të dhënash të tjera si:

- Sistemi “Tax Fraud&Investigation” nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
- Sistemi Norterial NISA, Dhoma Kombëtare e Noterisë.

Në çdo rast është kryer komunikimi shkresor përkatës dhe më pas konfigurimet për lehtësimin e aksesit për çdo përdorues në këto 2 sisteme. Aktualisht SPAK ka akses në 19 sisteme informacioni apo baza të dhënash shtetërore.

Përfundimi i Moduleve Kryesore dhe Zhvillimi i Fazës së Pilotimit për Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Dosjeve

Në vitin 2024, është realizuar një hap i rëndësishëm në zhvillimin e sistemit elektronik të menaxhimit të dosjeve, duke përfunduar sistemin dhe realizuar fazën e pilotimit të tij. Ky proces ka përfshirë disa faza të rëndësishme dhe ka siguruar që sistemi të jetë plotësisht i gatshëm për përdorim nga ana e stafit të SPAK në vitin 2025. DTI ka pasur një rol kyç në zhvillimin dhe implementimin e këtij sistemi, duke ofruar mbështetje të plotë dhe duke siguruar infrastrukturën e nevojshme teknike.

Përmbledhje e fazave dhe aktiviteteve kryesore të realizuara gjatë vitit:

1. Përfundimi i Sistemit të Menaxhimit të Dosjeve:

- Gjatë vitit 2024 është përfunduar zhvillimi i sistemit të menaxhimit të dosjeve. Ky sistem është krijuar për të menaxhuar dhe ruajtur dosjet elektronike të SPAK, duke siguruar që ato të jenë të disponueshme, të menaxhuara me efikasitet dhe të sigurt për përdoruesit.

2. Faza e Pilotimit:

- Faza e pilotimit është një hap kyç që ka për qëllim testimin e sistemit në një shkallë të vogël për të verifikuar funksionalitetin dhe integrimin e moduleve përkatëse.
- Përdoruesit janë trajnuar për përdorimin e sistemit, dhe ky trajnim ka përfshirë të gjithë stafin që do të përdorë sistemin në përditshmërinë e tij.
- Sistemi është testuar dhe kolauduar për t’u siguruar që të gjitha funksionet dhe modulet të përmbushin kërkesat dhe nevojat e institucionit.

3. Ngritja e infrastrukturës të nevojshme për garantimin e funksionimit në mënyrë të sigurt të këtij sistemi:

- DTI ka luajtur një rol të rëndësishëm që nga faza fillestare e projektit, duke ofruar ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e sistemit dhe krijimin e infrastrukturës teknologjike për implementimin e tij.
- DTI ka siguruar që të gjitha pajisjet hardware dhe softuerët përkatës të jenë në dispozicion dhe të gatshëm për instalimin dhe vënien në funksionim të sistemit.
- DTI ka monitoruar vazhdimisht fazën e pilotimit për të siguruar që çdo problem i mundshëm të adresohet me shpejtësi dhe që sistemi të ishte i gatshëm për implementim të plotë.

4. Përfundimi i fazës testuese dhe përdorimi në ambientin real:

- Pas përfundimit të fazës testuese, sistemi ka kaluar në ambientin real të punës për të qenë gati për përdorim për të startuar në fillim të vitit të ri kalendarik.
- Të gjitha procedimet e mbartura janë importuar në sistem, duke siguruar që të dhënat e rëndësishme dhe informacioni të jenë të aksesueshme dhe të menaxhueshme në mënyrë elektronike.

Hartimi i Dokumentacionit në Fushën e IT dhe Sigurisë Kibernetike

Në vitin 2024, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (DTI) ka qenë aktive në hartimin e dokumentacioneve të rëndësishme që kanë mbështetur përmirësimin e proceseve dhe ngritjen e nivelit të njohurive për përdoruesit. Ky dokumentacion ka pasur një ndikim të dukshëm në normimin e punës dhe është përdorur për të siguruar një menaxhim efikas dhe të sigurt të sistemeve dhe proceseve të lidhura me IT dhe sigurinë kibernetike.

- **Manualet e Përdorimit dhe Teknikë për të gjitha Sistemet:**
- **Krijimi i një Faqe Web për Përdorim në Rrjetin e Brendshëm:**
- **Manuali i Përdorimit të Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Çështjeve:**
- **Strategjia e Sigurisë Kibernetike:**

Marrja pjesë në komisione dhe grupe pune të ndryshme

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit është një drejtori kyçe në mbarëvajtjen e të gjithë proceseve të punës që zhvillohen në SPAK, pasi në përgjithësi çdo proces lidhet me teknologjinë e Informacionit. Në çdo rast DTI është e përfshirë dhe bën parashikimet për të gjithë pajisjet dhe sistemet elektronike të cilat përdoren në SPAK.

Ndër detyrat me të cilat është ngarkuar DTI gjatë gjithë vitit ka qenë edhe marrja pjesë në komisionet e procedurave të prokurimit për blerjen e pajisjeve dhe sistemeve të ndryshme, konkretisht në hartimin e specifikimeve teknike, testimin e tregut dhe përlllogaritjen e fondit limit, vlerësimin e ofertave dhe mbikëqyrjen e hartimit të kontratës dhe në marrjen në dorëzim të mallit.

Bashkëpunimi me Partnerët Ndërkombëtarë

Ky bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë ka qenë një faktor kyç për përmirësimin e infrastrukturës dhe teknologjisë në fushën e IT, duke kontribuar në zhvillimin e kapaciteteve dhe rritjen e efikasitetit të organizatave. Misionet ndërkombëtare, si ICITAP, OPDAT dhe EU4LEA, kanë sjellë ekspertizë dhe burime të vlefshme për të mbështetur implementimin e sistemeve të avancuara dhe përmirësimin e infrastrukturës IT, si dhe për të fuqizuar kapacitetet e analizës dhe menaxhimit të dhënave.

Mbështetja Financiare nga institucionet shtetërore

SPAK është mbështetur nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), e cila ka dhënë fonde sipas kërkesës së SPAK për blerjen e pajisjeve dhe sistemeve të sigurisë, pajisjeve elektronike për zhvillimin e hetimeve etj.

KOMISIONI I POSAÇËM I VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE PASTËRTISË SË FIGURËS GJATË VITIT 2024

Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës për Prokurorinë dhe Gjykatat e Posaçme, i cili krijohet sipas pikës 12 të nenit 57, dhe e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të pikës 6, të nenit 6, dhe nenit 7 të ligjit. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, ka në përbërje të tij një gjyqtar nga Gjykata e Apelit e Posaçme i zgjedhur me short, dy prokurorë të Prokurorisë së Posaçme të zgjedhur me short, ku procesi i përzgjedhjes me short monitorohet nga Avokati i Popullit, një hetues I BKH-së, një Hetues Financiar nga Seksioni i Hetimit Financiar në SPAK.

Gjatë vitit 2024 Komisioni ka përfunduar verifikimet e plota të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës për 58 kandidatë për personel administrativ në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si dhe për Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Po gjatë këtij viti Komisioni ka mbaruar procesin e verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës edhe për 12 kandidatë për Gjyqtarë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe 7 kandidatë për pozicionin e Prokurorit në Prokurorinë e Posaçme.

Në këtë proces kanë përfunduar verifikimet dhe për kancelarin e Prokurorisë së Posaçme të kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Ky Komision kryen një punë shumë voluminoze, pasi përveç vendimmarrjes për kryerjen e verifikimeve nga ILDKPI dhe DSIK, vazhdon me analizën e thelluar të raporteve të përcjella nga këto dy institucione, për çdo subjekt verifikimi. Kryen verifikime të drejtpërdrejta në bashkëpunim me Prokurorinë e Posaçme, Prokurorinë e Përgjithshme, Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, Asgjësinë e Inteligjencës Financiare, SHISH, Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, Departamentin e Administratës Publike.

Pas administrimit dhe analizimit të gjitha të dhënave të grumbulluara Komisioni përpilon dhe i përcjell institucionit të emërtesës raportin e hollësishëm mbi ligjshmërinë e burimeve të pasurisë dhe pastërtinë e figurës

Në përmbledhje gjatë vitit 2024, Komisioni ka përfunduar raportet e verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës për **58** subjekte.

KOMPETENCA E INSTITUCIONIT TË ISH - KOMISIONERËVE PUBLIKË

Adresimi i ngarkesës së shtuar sipas parashikimit të pikës 8, të nenit 179/b, të Kushtetutës, ndaj Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme mbi çështjet e papërfunduara të rivlerësimit të magjistratëve pas marrjes së kompetencave të Komisionerëve Publikë.

a. Në zbatim të nenit 179/b, pika 8 të Kushtetutës, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, referuar parashikimit kushtetues në ligjin nr. 16/2022 “Për një ndryshim në ligjin nr.8417, datë

21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, do të ushtrojë kompetencat e Komisionerëve Publikë pas shpërbërjes së tyre me përfundimin e mandatit Kushtetues, datë 31.12.2024.

b. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2024, strukturat përgjegjëse të institucioneve të përfshira në këtë proces, kanë koordinuar mbarëvajtjen e transferimit të çështjeve që kanë mbetur për tu gjykuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, në total 41 ankime të Komisionerëve Publikë, të cilat do të duhet të ndiqen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Lidhur me këto ankime, mbështetur në të dhënat statistikore të numrit të seancave të zhvilluara për një çështje në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, parashikohet që Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, do të duhet të ndjekë rreth 150-200 seanca gjyqësore, në harkun kohor janar 2025-qershor 2026, numër që mund ndryshojë në varësi të kompleksitetit të çështjeve.

c. Në kuadër të këtij procesi, në ligjin nr. 115/2024, për “Buxhetin e vitit 2025” është aprovuar, *“Për vitin 2025, për një periudhë jo më shumë se gjashtë muaj, për të finalizuar procesin e mbylljes së veprimtarisë administrative të Komisionerit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik, një pjesë e numrit të punonjësve administrativë të këtyre institucioneve sipas vendimit të Kuvendit do të vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë dhe do të jenë pjesë e programit buxhetor të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor të Ministrisë së Drejtësisë”*.

d. Me vendim nr. 111/2024, me propozimin e Komisionerëve Publikë, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi organikën dhe klasifikimin e pagave të punonjësve të administratës (në total 15 punonjës) pas mbarimit të mandatit të Komisionerëve Publikë, si pjesë e *arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor të Ministrisë së Drejtësisë*, vendim i cili hyn në fuqi në datë 01.01.2025 deri në datë 30.06.2025.

e. Në datë 26.12.2024 është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit midis Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Ministrisë së Drejtësisë, e cila ka si qëllim vendosjen në dispozicion të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, të punonjësve administrativë pas mbarimit të mandatit të Komisionerëve Publikë, më qëllim mbarëvajtjen e procesit të rivlerësimit kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe mbështetjen që këta punonjës, duhet ti ofrojnë Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme për ushtrimin e kompetencave në kuadër të këtij procesi.

f. Gjatë vitit 2024, strukturat përgjegjëse të Drejtorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Institucionit të Komisionerëve Publike dhe palëve të tjera të përfshirë në proces, kanë zhvilluar takime dhe kanë përfunduar më sukses procesin e marrjes në dorëzim të dosjeve fizike si dhe asetëve të Institucionit të Komisionerëve Publikë, duke krijuar kushte për vazhdimin normal të punës në fillim të vitit 2025.

KOORDINATORI PËR MARRËDHËNIEN ME MEDIAN DHE E DREJTA E INFORMIMIT

Gjatë vitit 2024, Koordinatorin për Marrëdhënien me Mediat, sipas rolit të përcaktuar edhe në ligjin 95/2016 dhe udhëzimet e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme ka adresuar në mënyrë korrekte kërkesat për informacion. Koordinatorin, përmes komunikimit me gazetarët e të gjitha televizioneve, mediave online, korrespondentëve të mediave ndërkombëtare në vend dhe reporterëve të pavarur ka përcjellë informacionin tek publiku për çështje të ndryshme. Po ashtu,

ka komunikuar me qytetarë për të lehtësuar adresimin e shqetësimeve për çështje që janë në juridiksionin e Prokurorisë së Posaçme.

Koordinatori për Marrëdhënien me Mediat ka adresuar edhe kërkesat për informacion të mbërritura në Prokurorinë e Posaçme nga gazetarët, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile si dhe është përpjekur t'i japë përgjigje në bashkëpunim me prokurorët e posaçëm dhe Drejtuesin e institucionit. Kërkesat për informacion dhe përgjigjet janë përfshirë në *“Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve”*, i cili sipas ligjit në fuqi (Ligji nr. 119/2014- Për të drejtën e informimit, i ndryshuar) duhet të përditësohet dhe më pas publikohet në faqen zyrtare të Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (www.spak.gov.al) çdo një muaj. Kjo procedurë monitorohet në mënyrë sistematike nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale. *“Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve”* i përditësuar publikohet në faqen zyrtare www.spak.gov.al, në kategorinë *“Programi i Transparencës”* / *“Programi i Transparencës SPAK”*.

Koordinatori për Marrëdhënien me Mediat ka respektuar **afatet ligjore** në kthimin e përgjigjeve për qytetarët, gazetarët, mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe subjekte të ndryshme është dhënë një përgjigje e plotë.

Fokusi i kërkesave për informacion gjatë vitit 2024 ka qenë tek hetimet për korrupsion të zyrtarëve të lartë, procedimet penale që lidhen me grupet apo organizatat kriminale, pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara, krimet zgjedhore si edhe bashkëpunimin e vazhdueshëm të Prokurorisë së Posaçme me prokuroritë e vendeve të rajonit, të BE-së, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mbretërisë së Bashkuar etj.

Pyetjet edhe komentet e shumta që i janë adresuar Koordinatorit për Marrëdhënien me Mediat përmes mesazheve në celular, nga gazetarë vendas dhe të huaj, për çështje me ndjeshmëri të lartë publike, pavarësisht kohës dhe angazhimit për t'iu përgjigjur nuk janë përfshirë në Regjistrin e Koordinatorit.

Kërkesat kanë mbërritur përmes shërbimit postar, e-mail-it të Prokurorisë së Posaçme (info@spak.gov.al) apo përmes e-mail-it të Koordinatorit për Marrëdhënien me Mediat. Gjithashtu, janë adresuar edhe kërkesat për intervista, takime me qytetarët, numri i të cilave ka qenë shumë i lartë përgjatë gjithë vitit 2024.

Në fund të vitit 2024, me mbështetjen e ekspertëve të *Government Service of Communication International (GCSI)*, nga Mbretëria e Bashkuar u draftua *“Strategjia e Komunikimit 2025-2028”*, e cila do të ndihmojë në:

- Angazhimin e Prokurorisë së Posaçme si një **institucion i hapur dhe transparent**.
- Paraqitjen e **përditësimeve zyrtare për median dhe publikun**.
- Bashkëpunimin e **qëndrueshëm** me gazetarët, median, institucionet e drejtësisë dhe shoqërinë civile.
- Rritjen e **transparencës** dhe përmirësimin e **besimit të qytetarëve** për institucionin në veçanti dhe sistemin e drejtësisë në përgjithësi.

“Strategjia e Komunikimit 2025-2028” mbështetet nga dy dokumente të tjerë të rëndësishëm, që do të ndihmojnë komunikimin efikas të Prokurorisë së Posaçme;

1. Strategjia për Median Sociale, ku përfshihen qasja për komunikimin në; Facebook [Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar] dhe X [@SPAK_Albanian].
2. Protokolli i Komunikimit gjatë Krizave, një dokument që do të përdoret nga Prokuroria e Posaçme për të menaxhuar krizat si dhe për të shmangur dëmet afat-gjata, që do të cenonin funksionimin dhe reputacionin e institucionit.

Gjatë vitit 2024 Prokuroria e Posaçme u është përgjigjur:

➤ **128 (njëqind e njëzetë e tetë) kërkesa zyrtare për informacion**

Të shpërndara në muaj si vijon (shih tabelën 1)

Muajt	Numri i kërkesave
Shkurt	13
Mars	8
Prill	16
Maj	17
Qershor	11
Korrik	17
Gusht	6
Shtator	10
Tetor	9
Nëntor	13
Dhjetor	8

Nga data 1 Janar - 31 Dhjetor 2024, faqja online e SPAK www.spak.gov.al, ka pasur 437948 vizita dhe 82766 vizitorë.

Shikueshmëria më e lartë me 11412 vizita dhe 1804 vizitorë u regjistrua në Tetor të vitit 2024 dhe ka lidhje me procedimin penal nr. 55 të vitit 2019. Subjekti i këtij hetime janë veprimet korruptive të zyrtarëve të shtetit që lidhen me zbatimin e kontratës së shërbimit CEZ-DIA.

Kanali i X [@SPAK_Albania], e cila është hapur në Nëntor 2021, numëron 1000 ndjekës.

Ndërsa në faqen e Facebook, e cila është hapur me 17 Dhjetor 2024, deri në fund të këtij viti ka pasur 454 klikime.

Gjatë vitit 2024, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka zhvilluar disa takime off-the-record me gazetarët ku është diskutuar për çështjet më të rëndësishme, bashkëpunimin me autoritetet e huaja dhe institucionet ligj zbatuese ndërkombëtare, të cilat kanë luajtur një rol parësor në hetimet komplekse.

Gjithashtu, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka zhvilluar intervistën e parë në Televizionin Publik Shqiptar RTSH

DOKUMENTACIONI I KLASIFIKUAR DHE I PAKLASIFIKUAR

Janë regjistruar në regjistrin hyrës 1493 materiale kallëzuese për të cilat janë dhënë zgjidhje për 331, janë dërguar për kompetencë 429, janë dërguar për vlerësim 104, janë dërguar për verifikim 98 dhe janë arkivuar 441, dhe një pjesë prej tyre është në proces ose bashkuar me procedimet penale.

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në përmbushje të kompetencave të tij ligjore të parashikuara në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” dhe ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ka nxjerrë 21 urdhra nga të cilët:

- 3 Urdhra të Përbashkëta me Drejtorin e BKH-së;
- 3 Strategji
- 1 Udhëzim i Përgjithshëm,
- 1 Udhëzim i përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme
- 5 Rregullore të miratuara;
- 3 marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara me institucionet publike dhe private në vend.

Kancelari në funksion të ushtrimit të kompetencave që ka sipas ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ka nxjerrë 906 urdhra administrativ, financiar dhe si autoritet kontraktor i deleguar,

Janë regjistruar në Regjistrin e korrespondencës 23336 shkresa së bashku me praktikat hyrëse dhe dalëse.

- Regjistri i Urdhrave të Ekzekutimit U 302 nr. prot.
- Regjistri i Letër porosive L 620 nr. prot.
- Regjistri i Dosjeve D 195 nr. Prot.
- Regjistri i vendimeve V 1280 nr. Prot.
- Regjistri i kërkesave të brendshme B 964 Prot.

Informacion për shkresat e ardhura nga institucione dhe individë të ndryshëm gjatë vitit 2023.

Janë regjistruar në regjistrin hyrës të protokollit 4422 kërkesa administrative, nga të cilat:

982 kërkesa nga Institucionet shtetërore, ku janë kthyer 894 përgjigje;

2475 kërkesa, nga shtetasit, shoqata civile, gazetarë, etj., ku janë kthyer 2087 përgjigje dhe 47 prej tyre janë arkivuar

965 kërkesa nga avokatë që ndjekin çështjet në Gjykata, ku janë kthyer 372 përgjigje dhe 6 prej tyre janë arkivuar.

Numri i informacioneve të klasifikuara sekret është 1132

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, DOKUMENTACIONIT DHE SHËRBIMEVE

Zhvillimi i burimeve njerëzore, në përputhje me objektivat dhe zbatimin e politikave përkatëse të Prokurorisë së Posaçme, synon të krijojë një mjedis pune të përshtatshëm dhe motivues, që i shërben jo vetëm rritjes profesionale të punonjësve, por dhe përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve administrative të institucionit.

Plani i punësimeve, sipas organigramës, strukturës së Prokurorisë së Posaçme

Me ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, Prokurorisë së Posaçme i është vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, fondi i pagave, i cili do të mundësonte plotësimin e nevojave të organigramës, strukturës së Prokurorisë së Posaçme, me 133 punonjës në përputhje me Urdhrin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme nr. 06, datë 06.01.2023 “Për miratimin e strukturës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, të ndryshuar. Struktura dhe organika e Prokurorisë së Posaçme me një total prej 133 punonjësish.

Procesi i punësimeve, për pozicionet e parashikuara në organigramën, strukturën e Prokurorisë së Posaçme

Në mbështetje të ligjit nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, të ndryshuar; ligjit nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, të ndryshuar, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të ndryshuar, etj., të udhëzimeve të Departamentit të Administratës Publike, si dhe të Urdhrit nr. 06, datë 05.01.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme “Për miratimin e strukturës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, të ndryshuar, bazuar në planin e punësimit, vakancave shtesë të krijuara gjatë vitit 2024, është vijuar me shpalljen e procedurave për plotësimin e vendeve vakante, në faqen zyrtare të Prokurorisë së Posaçme, si dhe në Shërbimin Kombëtar të Punësimit për të cilat janë zhvilluar procedurat përkatëse, të punësimit, për plotësimin me personel administrativ.

Në Prokurorinë e Posaçme gjatë vitit 2024 kanë ushtruar detyrën gjithsej 113 punonjës, nga të cilët 20 Prokuror të emëruar, 12 Hetues Financiar, 79 punonjës administrativë dhe 2 punonjës me kontratë 1-vjeçare.

Në Prokurorinë e Posaçme gjatë vitit 2024, janë shpallur dhe zhvilluar procedura të punësimit për 13 pozicione të ndryshme, ku janë punësuar 11 punonjës, nga të cilët:

- ✓ të emëruar me kontratë pune janë 3 punonjës, nga të cilët 1 Koordinator për Marrëdhënien me Median, në Kabinetin e Drejtuesit, 1 Ekspert, në Sektorin e Ekspertizës dhe 1 Oficer Informacioni, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse;
- ✓ të emëruar me procedura sipas ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”, janë 7 punonjës, nga të cilët 3 punonjës të emëruar me procedurën “Pranim në shërbimin civil”, 2 punonjës të

emëruar me procedurën “Lëvizje paralele” dhe 2 punonjës të emëruar me procedurën “Ngritje në detyrë”;

- ✓ në mbështetje të Vendimit nr. 39, datë 24.01.2024 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024, në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, pranë Prokurorisë së Posaçme për vitin 2024 kanë ushtruar funksionin 2 punonjës me kontratë pune, me kohëzgjatje 6 orë në ditë, me afat 1-vjeçar.
- ✓ në proces të zhvillimit të procedurës, por të pa përfunduara 1 pozicion me status nëpunësi civil, kategoria e ulët drejtuese;
- ✓ një procedurë për kategorinë e ulët drejtuese është zhvilluar, por nuk ka rezultuar me asnjë fitues.

Gjatë vitit 2024, në Prokurorinë e Posaçme kanë dhënë dorëheqjen, janë ngritur në detyrë ose janë larguar nga shërbimi civil 8 (tetë) punonjës, si më poshtë vijon:

- ✓ 3 punonjës të kategorisë ekzekutive ku, 2 për arsye të ngritjes në detyrë dhe 1 për arsye të përfundimit të procesit të verifikimit;
- ✓ 3 punonjës të kategorisë së mesme dhe të ulët drejtuese, ku 1 i kategorisë së mesme drejtuese, për arsye të dorëheqjes dhe 2 të kategorisë së ulët drejtuese për arsye të ngritjes në detyrë;
- ✓ 2 punonjës me kontratë, ku 1 ka përfunduar marrëdhënien e punës, për shkak të plotësimit të moshës për pension pleqërie dhe 1 për shkak të zgjidhjes së kontratës.

Në mënyrë të përmblodhur numri i pozicioneve të punësuar në Prokurorinë e Posaçme për vitin 2024, paraqitet si më poshtë:

Statusi	Kategoria	Numri i të emëruarve për vitin 2024
Nëpunës civil	E mesme drejtuese	1
Nëpunës civil	E ulët drejtuese	1
Nëpunës civil	Ekzekutive	5
Me Kod Pune	Kabineti i Drejtuesit	1
Me Kod Pune	Ekspert	1
Me Kod Pune	Punonjës Administrate	2
Total		11

Në përfundim të vitit 2024, për arsye të shtimit të strukturës së Prokurorisë së Posaçme me 11 punonjës, të lëvizjes së punonjësve ekzistues, si dhe për arsye objektive janë zhvilluar procedura që kanë qenë të domosdoshme, procedurat e mbetura të rekrutimit, pjesë e planeve të rekrutimit të vitit 2024, do të duhet të zhvillohen gjatë vitit 2025.

Shkalla reale e plotësimit të Drejtorive/Sektorëve të Prokurorisë së Posaçme, në fund të vitit 2024, krahasuar me numrin e punonjësve sipas strukturës dhe organikës, të aprovuar me Urdhrin nr. 06, datë 05.01.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme “Për miratimin e strukturës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, të ndryshuar, paraqitet si më poshtë:

Drejtorja/Spektori	Organika/Struktura	Aktualisht	Vakancë
Drejtuksi i Prokurorisë/prokuror	1	1	0

Kabineti i drejtuesit	4	3	1
Prokuror	19	19	0
Sektori i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Ndërlidhjes për Hetime të Përbashkëta	3	3	0
Bërthama Komanduese Elektronike	2	2	0
Sektori i Hetimit Financiar	16	12	4
Sektori i Ekspertizës	8	4	4
Sektori i Asistencës për Individët me Status të Posaçëm	2	1	1
Sekretaria Administrative	14	13	1
Sektori i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale	3	2	1
Sektori i Raportimeve pranë Bashkimit European	3	2	1
Kancelari	1	1	0
Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar	9	7	2
Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit	7	4	3
Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Dokumentacionit dhe Shërbimeve	41	34	7
Total	133	108	25

Struktura e miratuar e Prokurorisë së Posaçme që nga krijimi i saj në vitin 2019 deri në vitin 2024, së bashku me plotësimin e emërimeve të Drejtorive/Sektorëve të Prokurorisë së Posaçme, në mënyrë krahasimore paraqitet si më poshtë:

Prokuroria e Posaçme	Prokuror		Hetues Financiar		OPGJ/Ekspert		Status nëpunësi civil		Kod Pune	
Lloji i punonjësve	Sipas strukt urës	Emër uar	Sipas strukt urës	Emër uar	Sipas strukt urës	Emër uar	Sipas strukt urës	Emër uar	Sipas strukt urës	Emër uar
2019		6		0		0		12		10
2020	14	13	8	0	22	16	33	20	22	12
2021	20	17	4	0	8	8	32	26	20	19
2022	20	17	8	0	7	5	52	38	25	25
2023	20	18	16	12	10	5	59	44	28	27
2024	20	20	16	12	10	6	59	45	28	27

Trajnimit e punonjësve

Që një institucion të realizojë qëllimet dhe objektivat e përcaktuara në ligj, duhet jo vetëm të disponoj burimet e nevojshme, por edhe t'i përdorë ato me efektivitet. Duke marrë në konsideratë

natyrën dhe kompleksitetin e çështjeve të Prokurorisë së Posaçme, e cila vjen gjithmonë e në rritje, roli i një personeli administrativ të trajnuar në funksionet mbështetëse është shumë i rëndësishëm për performancën dhe efikasitetin e Prokurorisë së Posaçme. Për këtë arsye, Prokuroria e Posaçme me Urdhrin nr. 679, datë 09.10.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, ka miratuar “Planin e trajnimit të personelit administrativ sipas kategorive për vitin 2023-2026”.

Prokurorët dhe Hetuesit Financiar zhvillojnë trajnime, të cilat kryesisht kanë pasur në vëmendje ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe profesionale në aspektin e hetimit dhe ndjekjes penale, të cilat zhvillohen nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe Projektet e ndryshme ndërkombëtare.

Për ngritjen e kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore, lidhur me trajnimet, gjatë vitit 2024, nga Prokuroria e Posaçme kanë ndjekur trajnimet e ofruara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASP) gjithsej rreth 50 punonjës, nga Komisioni European dhe Organizata të tjera Ndërkombëtare rreth 48 punonjës, nga institucione trajnuese private rreth 6 punonjës. Në total punonjësit e Prokurorisë së Posaçme kanë ndjekur rreth 41 tema të ndryshme trajnimi, nga një numër i përgjithshëm me rreth 120 punonjës.

Gjithsesi gjatë vitit 2024 në bashkëpunim me ASPA, OPDAT, FBI dhe institucione të tjera, janë kryer on-line një pjesë e mirë e trajnimeve të planifikuara.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024, kryen dhe përfunduan trajnimin e detyrueshëm 2 javor, pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, *"Prezantimi me Administratën Publike"*, duke kaluar me sukses edhe testin përkatës, 2 punonjës, të emëruar nëpunës civil në periudhë prove.

Të gjithë këta punonjës kanë kryer testin përkatës pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike në përfundim të periudhës së provës.

Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2024 ka konfirmuar në detyrë 5 nëpunës civil, për të cilët kanë ardhur rezultatet e testit të kryer dhe janë realizuar të gjithë procedurat përkatëse, bazuar në vlerësimin në punë për periudhën 1 vjeçare të provës.

Pajisja me Certifikatën e Sigurisë së Personelit, për punonjësit e Prokurorisë së Posaçme

Në mbështetje të ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, të Vendimit nr. 731, datë 27.11.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë e personelit”, si dhe të Urdhrit nr. 256, datë 25.04.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme “Për funksionet që duhet të pajisen me “Certifikatën e Sigurimit të Personelit” për njohje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të Shteteve dhe Organizatave të tjera Ndërkombëtare në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, janë përcaktuar të gjitha funksionet, që duhet të pajisen me Certifikatën e Sigurimit të Personelit, si dhe nivelin përkatës.

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, referuar akteve ligjore në fuqi, si dhe kërkesave të drejtuara nga Prokuroria e Posaçme, ka proceduar duke pajisur me Certifikatë Sigurie stafin e Prokurorisë së Posaçme.

Gjatë vitit 2024, nga Prokuroria e Posaçme janë kërkuar pajisja me Certifikatë të Sigurisë së Personelit (CSP), të tipologjive të ndryshme, që paraqitet si më poshtë:

Certifikatë	Niveli i Certifikatës së Sigurisë së Personelit (CSP)		
	Tepër sekret	Sekret	Konfidencial
Certifikatë Sigurie Personeli (CSP) të rinovuar	5	6	0
Certifikatë Sigurie Personeli (CSP) për konfirmim vlefshmërie dhe modelim	2	1	0
Certifikate Sigurie personeli (CSP) pajisur për herë të parë	0	3	1
Certifikate Sigurie personeli (CSP) në proces rinovimi	4	4	0

Të gjithë punonjësit të cilët kanë ndërprerë marrëdhënien e punës, në Prokurorinë e Posaçme për arsye të ndryshme, dorëzojnë Certifikatën e Sigurisë së Personelit (CSP) tek Struktura përgjegjëse e institucionit (Specialisti i Burimeve Njerëzore) dhe u nënshtrohen procedurave të debrifimit, duke nënshkruar në dokumentin përkatës. Ata janë përgjegjës për ruajtjen e informacionit të klasifikuar edhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës për një periudhë 2-vjeçare.

Gjatë vitit 2024, nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar nuk është vendosur për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të Certifikatës së Sigurisë së Personelit (CSP), për asnjë punonjës të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin, Kontrollin dhe Zgjidhjen e Gjendjeve të Konfliktit të Interesit në Prokurorinë e Posaçme

Janë kryer të gjithë detyrat dhe përgjegjësitë në pozicionin e anëtarit të Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin, Kontrollin dhe Zgjidhjen e Gjendjeve të Konfliktit të Interesit në Prokurorinë e Posaçme, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Institucioneve për të luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, të ndryshuar; ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, si dhe udhëzimeve përkatëse të Inspektoratit të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Gjatë vitit 2024, për Prokurorinë e Posaçme numri i subjekteve sipas funksioneve që mbartin detyrim për deklarim të interesave private dhe kanë plotësuar llojin e deklaratës, paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i deklarimit	Numëri i zyrtarëve aktual që mbartin detyrim për deklarim
1	Subjekt Deklarues për deklaratën si kandidatë	7
2	Subjekt Deklarues për deklaratën Para Fillimit të Detyrës	47
3	Subjekt Deklarues për deklaratën Periodike Vjetore	32
4	Subjekt Deklarues për deklaratën Pas largimit nga funksioni	1

Në vitin 2024 për të gjitha lëvizjet e personelit subjekt deklarimi, janë njoftuar për deklaratat e tyre “*Para fillimit të detyrës*” dhe “*Pas largimit nga funksioni*”, etj., për të cilët është bërë dhe njoftimi i institucionit të ILDKPKI-së për ndryshimet në regjistër, si dhe është njoftuar edhe Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, për të gjithë punonjësit e larguar nga detyra.

Bashkëpunimi me Drejtoritë/Sektorët e tjerë

Spektori i Burimeve Njerëzore gjatë vitit 2024, ka bashkëpunuar me Drejtoritë/Sektorët e tjerë për problematika të ndryshme, ku mund të përmenden, bashkëpunimi me Sektorin e Buxhetit dhe Prokurimeve në pjesëmarrjen në procese të veçanta të prokurimit të mallrave, punëve apo shërbimeve. Bashkëpunimi me Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe në hartimin e dokumentacionit përkatës në lidhje me përditësimin e strukturës së Prokurorisë së Posaçme sipas pagave të reja të miratuara me Vendimin nr. 325, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar si dhe Vendimit nr. 326, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar. Gjatë vitit 2024, Spektori i Burimeve Njerëzore ka dhënë kontribut në hartimin dhe draftimin e disa akteve nënligjore si,

- ✓ Hartimi i rregullores së brendshme të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
- ✓ Hartimi i Strategjisë së Burimeve Njerëzore për vitin 2024-2026, në Prokurorinë e Posaçme;
- ✓ Hartimi i Rregullores për Hetimin Administrativ të Sinjalizimit dhe Mbrojtjes së konfidencialitetit;
- ✓ Hartimi i Rregullores për Hetimin Administrativ të Kërkesës së Sinjalizuesit për Mbrojtjen nga Hakmarrja;
- ✓ Hartimi i Planit Strategjik 2024-2027, për Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
- ✓ Hartimi i draft Udhërrëfyesit dhe Planit të veprimit për reduktimin e çështjeve të prapambetura në Prokurorinë e Posaçme për vitin 2024-2027;
- ✓ Hartimi i draft Udhëzimit të Përgjithshëm për qarkullimin e brendshëm të dosjeve;
- ✓ Përmirësimi i procedurave të rekrutimit, duke zbatuar ligjin nr. 95/2016, ligjin nr. 97/2016 si dhe legjislacionin e nëpunësit civil.

Veprimtaria e Sektorit në proceset gjyqësore administrative/civile, ku Prokuroria e Posaçme ka qënë palë në proces

Spektori i Burimeve Njerëzore gjatë vitit 2024, ka ndjekur proceset gjyqësore civile dhe administrative, në të cilat Prokuroria e Posaçme ka qënë palë, në këto procese.

Nr.	Shkallët e gjykimit	Numri i çështjeve
1.	Çështje Administrative në Shkallën e parë të Gjykimit	16

2.	Çështje civile në Shkallën e parë të Gjykimit	2
3.	Çështje Administrative në Shkallën e dytë të Gjykimit	4

Prokuroria e Posaçme gjatë këtij viti ka ndjekur 22 çështje gjyqësore administrative/civile, kërkesë padi të reja apo edhe të mbartura në Gjykatën Administrative dhe Civile të Shkallës së Parë, si dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, nga të cilat për vitin 2024 janë 7 çështje të reja.

BYROJA KOMBËTARE E HETIMIT

Referime në Prokurorinë e Posaçme, mbi bazën e indiceve, - **13 (trembëdhjetë)**.

1. Urdhra të Përbashkëta ;

- a. Urdhra të Përbashkët midis Drejtorit të BKH-së dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme – **4 (katër)** .
- b. Urdhër i Përbashkët midis Drejtorit të BKH-së dhe Drejtorit të Përgjithshme të Policisë së Shtetit (për kalimin kapital pa pagesë të municioneve për armët e zjarrit për hetuesit).

2. Marrëveshje të nënshkruara;

- a. Marrëveshja Bashkëpunimi midis Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe SELEC (Qendrës së Zbatimit të Ligjit të Europës Juglindore) “Për vendosjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit”.
- b. Memorandum midis Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë “Për dhënien e aksesit Byrosë Kombëtare të Hetimit në sistemin Elektronik “NISA”.
- c. Marrëveshja Bashkëpunimi midis Drejtorit të BKH-së dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për dhënien konsultimit në sistemin “INTERPOL”
- d. Program për trajnimin e hetuesve për armët e zjarrit, miratuar nga Drejtori i BKH-së dhe Rektori i Akademisë së Sigurisë.

3. Trajnime;

Hetues;

- a. Trajnime brenda vendit - 38 trajnime
- b. Trajnime jashtë vendit - 20 trajnime

Punonjës të administratës;

- a. Trajnime brenda vendit - 15 trajnime

4. Burimet Njerëzore ;

Gjatë vitit 2024 BKH në zbatim të nenit 7, të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, janë shpallur procedurat për **13 (trembëdhjetë)** funksione administrative, nga të cilat :

- a. **4 (katër)** - funksione, janë plotësuar dhe punonjësit administrativ kanë kaluar edhe kushtin e

sigurisë;

- b. **5 (pesë)** – funksione, janë kryer procedurat e shërbimit civil, por kandidatët janë ende në proces verifikimi të kushtit të sigurisë, nga Komisioni i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës.
- c. **4 (katër)** - funksione, janë kryer procedurat e shërbimit civil, por kandidatët që kanë aplikuar nuk plotësonin kriteret e kërkuara, procedurat janë anuluar.

5. Aktiviteti administrativ ;

Korrespondenca për shkresat hyrëse – dalës, në Byronë Kombëtare të Hetimit, deri në **31.12. 2024** :
Sekretari – Protokoll, gjatë kësaj periudhe janë trajtuar **4.760** shkresa, të ndara si vijon:

- a. Shkresa hyrëse – **3. 818**
- b. Shkresa dalëse - **942**

Sekretaria e Informacionit të Klasifikuar - gjatë kësaj periudhe janë trajtuar **442** shkresa, të ndara si vijon:

- a. Agjencitë ligj zbatuese dhe institucionet shtetërore ;
 - Shkresa hyrëse – **219**
 - Shkresa dalëse - **121**
- b. Partnerët Ndërkombëtar;
 - Shkresa hyrëse – **55**
 - Shkresa dalëse - **48**

6. Pasqyra e realizimit të shpenzimeve buxhetor, në / lekë;

Emërtimi	Plani vjetor	Plani me ndryshime	Realizimi	Diferenca	Realizimi në %
Totali Buxhetit për vitin 2024	585.037.000	442.422.000	411.898.170	30.523.830	93
Shpenzime për pagat	519.000.000	409.000.000	380.375.414	28.624.586	93
Kontribut për sigurimet shoqërore dhe shëndetësorë	40.862.000	29.862.000	28.693.286	1.168.714	96
Mallra dhe shërbime	25.000.000	3.500.000	2.769.470	730.530	79
Fondi veçantë	175.000	60.000	60.000	0	100
Shpenzime kapitale (investime)	0	0	0	0	0

7. Niveli i Zbatimit të Rekomandimeve të Komisionit Evropian për Byronë Kombëtare të Hetimit.

Byroja Kombëtare e Hetimit është institucion kontribues në Kapitullin 23 dhe Kapitullin 24. Në VKM nr. 736, datë 13.12.2023 “Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës” janë parashikuar masa konkrete për përmbushjen e detyrimeve nga Byroja Kombëtare e Hetimit, në vazhdimësi.

Nga ana jonë, për vitin 2024, janë përmbushur detyrimet e përcaktuara për raportimet, pjesëmarrjen në takime, parashikimin e masave konkrete në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të progres raporteve.

Jemi në proces për të përmbushur masat e vendosura nga shteti shqiptar në udhërrëfyes për vitin 2025.

TREGUESIT E BUXHETIT PËR VITIN 2024 DHE PLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN E ARDHSHËM DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Në zbatim të ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” i ndryshuar, Buxheti i akorduar për programin “Veprimtaria e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar” për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 1,901 milion lekë dhe me buxhetin vjetor të rishikuar në vlerën 1,310 milion lekë.

Tabela nr. 1: Plani buxhetor për vitin 2024

(000/lekë)

Titulli	Emërtimi	Plani Fillestar Vjetor	Plani Vjetor i Rishikuar	Shpenzime Faktike	Diferenca	% e realizimit fakt/plan
1	2	3	4	5	6=(5-4)	7=(5/4)
03390	Veprimtaria e SPAK	1,901,063	1,310,547	1,224,100	86,447	93%
Totali i Shpenzimeve të Institucionit		1,901,063	1,310,547	1,224,100	86,447	93%

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2024);

Duke u mbështetur në veprimtarinë bazë të institucionit, pjesë përbërës e të cilit janë:

1. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me kod institucioni në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë 1041001,
2. Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) me kod institucioni në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë 1041002,

Në analizën vjetore të vitit 2024, informacioni paraqitet në mënyrë tabelare dhe grafikisht, si mëposhtë:

- a) Sipas planit fillestar të miratuar shuma prej 1,351 mln lekë përfaqëson shpenzimet korrente dhe shuma 550 mln lekë shpenzimet kapitale.
- b) Sipas planit të rishikuar shuma prej 1,042 mln lekë përfaqëson shpenzimet korrente, dhe shuma 268 mln lekë shpenzimet kapitale.
- a) Sipas realizimit faktik, totali i shpenzimeve të realizuara është në shumën 1,224 mln lekë ose 93% (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ) nga plani i rishikuar, të cilat shpenzimet korrente janë realizuar 80% në vlerë 975 milion lekë, ndërsa shpenzimet kapitale 20% në vlerë 249 mln lekë.

Niveli i realizimit të fondeve buxhetore të SPAK-ut në krahasim me planin e miratuar paraqitet në masën 93 %.

Tabela nr.2: Raporti i shpenzimeve të programit sipas llogarive ekonomike


(000/lekë)

Art.	Emërtimi	Fakti i vitit paraardhës 2023	1	2	3	4=(2-3)	Përqindja e realizimit Fakt/Plan (%)
			Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	Diferenca Plan - Fakt	
			Plan Fillestar Viti 2024	Plan i Rishikuar Viti 2024	periudhës 12 - muajore		
600	Paga	824,798.0	979,000.0	789,000.0	749,365.0	39,635.0	95%
601	Sigurime Shoqërore	60,005.0	123,946.0	66,946.0	63,448.0	3,498.0	95%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	149,084.0	248,117.0	185,617.0	160,908.0	24,709.0	87%
603	Subvencione					0.0	
604	Transferta Korente të Brendshme					0.0	
605	Transferta Korente të Huaja					0.0	
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	419.0		984.0	984.0	0.0	100%
Nën-Totali	Shpenzime Korrente	1,034,306.0	1,351,063.0	1,042,547.0	974,705.0	67,842.0	93%
231	Kapitale të Trupëzuara	8,436.0	550,000.0	268,000.0	249,395.0	18,605.0	93%
Nën-Totali	Shpenzime Kapitale	8,436.0	550,000.0	268,000.0	249,395.0	18,605.0	93%
Totali (korrente + kapitale)		1,042,742.0	1,901,063.0	1,310,547.0	1,224,100.0	86,447.0	93%

Në analizë të informacionit të paraqitur në mënyrë grafike, rezultojnë se:

- Sipas planit fillestar të miratuar, shpenzimet korrente zënë një peshë specifike 71% në vlerë rreth 1,351 milion lekë, ndërsa shpenzimet për investime zënë një peshë specifike 29% , në vlerë rreth 550 milion lekë.
- Sipas planit të rishikuar, shpenzimet korrente zënë një peshë specifike 80% në vlerë rreth 1,042 milion lekë, ndërsa shpenzimet për investime zënë një peshë specifike 20%, në vlerë rreth 268 milion lekë.
- Sipas realizimit faktik, në totalin e shpenzimeve të realizuara shpenzimet korrente zënë 80% në vlerë 975 milion lekë, ndërsa shpenzimet kapitale 20% në vlerë 249 milion lekë.

Grafiku nr.2: Struktura e realizimit Fakt - Plan për vitin 2024




Për sa i përket realizimit faktik krahasuar me buxhetin vjetor përfundimtar rezultojnë se përqindja e realizimit sipas zërave buxhetorë paraqitet në masën rreth 95%, për shpenzime paga/sigurime, shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera rreth 87% dhe transfertat buxhetore rreth 100% si dhe shpenzimet për investime 93%.

- Pesha specifike sipas strukturës së shpenzimeve

Sipas analizës për periudhën 12 muajore, pesha specifike sipas strukturave të shpenzimeve (plani fillestar/plan i rishikuar/fakti) për vitin 2024, siç mund të konstatohet në grafikun më poshtë:

Grafiku nr.1: Struktura e Shpenzimeve sipas peshës specifike të programit viti 2024



1.2 Performanca e treguesve kyç të performancës me bazë gjinore, në nivel produkti

SPAK, bazuar në orientimet e MFE me shkresën Nr. 1087 prot., datë 18.01.2024, në kuadër të PBA 2024-2026 faza përfundimtare, ka parashikuar tregues performace me bazë gjinore në nivel produkti. Treguesi i parashikuar është: *% e grave në poste drejtuese të institucionit ndaj totalit të posteve drejtuese.*

Tabela nr. 3: Raporti i posteve gra në nivel drejtuesi

SPAK	Nr. i posteve në nivel drejtues	Nr. i posteve në nivel drejtues Gra	% e posteve drejtues Gra/Totalin
Prokuroria e Posaçme	18	7	39%
Byroja Kombëtare e Hetimit	10	3	30%
Totali	28	10	36%

Nga tabela më sipër vërehet se nr. i posteve drejtuese gra është në masën 36% mbi totalin e posteve drejtuese.

Grafiku nr. 3: Numri i posteve drejtuese gra ndaj totali të posteve drejtuese



1.3 Performanca e buxhetit në nivel programi

Në zbatim të ligjit vjetor “Për zbatimin e buxhetit viti 2024”, drejtoria e buxhetit ka analizuar dhe detajuar fondet në përputhje me shpërndarjen e fondeve buxhetore të miratuara, përgjatë vitit 2024, ka marrë masat korrigjuese nëpërmjet rialokimeve të fondeve (shtesa /pakësime). Çdo kërkesë për fonde shtesë ose rishpërndarje fondesh, apo pakësimet e mundshme janë shoqëruar me analizë ku identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, kontributi në arritjen e qëllimit dhe objektivave dhe risqet e lidhura. Bazuar në Aktet normative për ndryshimin e ligjit buxhetor, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, janë kryer detajimet përkatëse sipas rishikimit të buxhetit.

1.3.1 Shpenzimet e personelit

Sa kemi trajtuar dhe më lartë plani i fondeve të akorduara përmes ligjit vjetor të buxhetit të rishikuar, në zërin e shpenzimeve për paga është në vlerën e rreth 855.9 milion lekë ose rreth 65% e totalit të buxhetit të SPAK, nga të cilat Prokuroria e Posaçme në shumën 417.1 milion lekë dhe BKH në shumën 438.8 milion lekë.

Sipas strukturave, Prokuroria e Posaçme dhe BKH kanë realizuar shpenzime për paga dhe sigurime në shumën 812.8 milion lekë nga të cilat:

- Prokuroria e Posaçme ka realizuar 368.9 mln lekë paga dhe 34.7 mln lekë sigurime ose rreth 96% e shpenzimeve të planifikuara për vitin 2024
- Byroja Kombëtare e Hetimit ka realizuar 380.3 mln lekë paga dhe 28.6 mln lekë sigurime ose 93% e shpenzimeve të planifikuara për vitin 2024

Bazuar në ndryshimet ligjore në vitin 2024, i referohemi Aktit Normativ nr. 3 datë 28.08.2024 si dhe Aktin normativ nr. 5 datë 19.12.2024 “Mbi ndryshimin e Ligjit 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” bazuar në deklaratimet e tepricave të fondeve buxhetore, është miratuar pakësim i fondeve në shumën totale 247 milion lekë për zërin paga dhe sigurime. Deklarimi i tepricave buxhetore ka qenë rrjedhojë e vakancave në dy institucionet e SPAK.

Për sa i përket numrit të punonjësve me ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, për SPAK struktura e miratuar ishte 271 punonjës, nga të cilët 133 punonjës Prokuroria e Posaçme dhe 138 punonjës Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH).

Bazuar në ndryshimet ligjore në vitin 2024, i referohemi Aktit Normativ nr. 3 datë 28.08.2024 “Mbi ndryshimin e Ligjit 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” është marrë në konsideratë kërkesa e paraqitur nga SPAK për shtimin me 40 hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Kërkesa për shtimin e strukturës së Byrosë Kombëtare të Hetimit vjen si domosdoshmëri e rritjes së procedimeve penale, dhe volumnit të punës.

1.3.2 Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera

Aktiviteti operacional dhe hetimor i SPAK gjatë vitit buxhetor 2024 është mbështetur nga buxheti i shtetit në llogarinë e mallrave dhe shërbimeve (Llogaria ekonomike 602) në buxhetin e rishikuar në shumën 185.6 milion lekë e detajuar për Prokurorinë e Posaçme në shumën 182.1 milion lekë dhe për Byronë Kombëtare të Hetimit në shumën 3.5 milion lekë.

Me ligjin 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, fondi i miratuar fillimisht për zërin e shpenzimeve operative ka qenë në shumën 248 milion lekë e detajuar për Prokurorinë e Posaçme në shumën 223 milion lekë dhe për Byronë Kombëtare të Hetimit në shumën 25 milion lekë.

Gjatë 12 mujorit të vitit 2024, shpenzimi për zërin mallra dhe shërbime paraqitet në shumën 160.9 milion lekë, ose ndryshe 87 % të planit vjetor përfundimtar nga të cilat Prokuroria ka shpenzuar 158.2 milion lekë dhe BKH 2.7 mln lekë. Gjithashtu gjatë 12 mujorit janë reflektuar ndryshimet në Regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit, (njoftuar Degën e Thesarit rast pas rasti).

Shpenzimet e kryera për të cilat janë përdorur fondet e planifikuara i referohen kryesisht mallra e shërbime sipas planifikimit në regjistrin e prokurimeve si shpenzimeve utilitare dhe procedurale.

Rritja e shpenzimeve për mallra dhe shërbime për vitin 2024, krahasuar me vitin 2023 ka ardhur për shkak se institucioni ka operuar në kushtet e rritjes së volumit të procedurave hetimore të zhvilluara si dhe shtesës së stafit për të dy institucionet.

Bazuar në ndryshimet ligjore në vitin 2024, i referohemi Aktit Normativ nr. 3 datë 28.08.2024 si dhe Aktin Normativ nr. 5 datë 19.12.2024 “Mbi ndryshimin e ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” bazuar në deklaratimet e tepricave të fondeve buxhetore, është miratuar pakësim i fondeve në shumën totale 62.5 milion lekë.

Fondet nga Granti (Eurojust)

Gjatë viti 2024, Për Prokurorinë e Posaçme është akorduar një fond në shumën totale 1,247,711 lekë bazuar sipas Programit të financimit të Ekipeve të Përbashkëta Hetimore (EPH-ve) i Eurojust-it. Shpenzimet e kryera rimbursohen në bazë të marrëveshjes, sipas llojit mbështetës: udhëtim, akomodim, përkthim, interpretim, etj.

Tabela nr. 5: Shpenzime të kryera nga fondi i Grantit - kap. 6 (Eurojust)

Kap.6	Nënlllogaria ekonomike	Emërtimi	Granti i akorduar	Shuma e shpenzuar
6	602	Shpenzime per Prokurorinë e Posacme	1,166,492	1,166,492
6	602	Shpenzime për Byronë Kombëtare të Hetimit	81,219	81,219
Total			1,247,711	1,247,711

Për zërin shpenzime mallra dhe shërbime nga fondi i akorduar është realizuar vlera totale, duke pasur një realizim 100%.

1.3.3 Transferta për buxhete familjare

Për vitin buxhetor 2024, është planifikuar si Fond i Veçantë (Llogaria 606) për mbulimin e rasteve të fatkeqësive në përputhje me VKM nr.929, datë 17.11.2010 “Për Krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” i ndryshuar, fondi fillestar i miratuar ka qenë në shumën 350 mijë lekë.

Fondi i rishikuar për këtë zë është në shumën 984 mijë lekë dhe është shpenzuar shumën 984 mijë lekë, ose ndryshe 100 % të planit vjetor përfundimtar nga të cilat Prokuroria ka shpenzuar 924 mijë lekë dhe BKH 60 mijë lekë.

Gjatë vitit 2024 janë ndërmarrë veprime për alokimin e burimeve si dhe kërkesë për fond shtesë në shumën totale 809 mijë lekë bazuar dhe në VKM nr. 846 datë 26.12.2024 “Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2024 për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës” në fondin e veçantë.

1.3.4 Shpenzime për Investime Kapitale

Në mbështetje të ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, fondi i miratuar fillimisht për zërin investimet kapitale ka qenë në shumën 550 milion lekë. Rrjedhojë e shtesave dhe pakësimeve, të reflektuara në buxhetin e miratuar, plani i rishikuar për zërin investimet kapitale është në shumën 268 milion lekë.

Gjatë 12 mujorit të vitit 2024, shpenzimi për këtë zë paraqitet në shumën 249.3 milion lekë, ose ndryshe 93 % të planit vjetor përfundimtar.

Prokuroria e Posaçme është angazhuar në realizimin e disa projekteve të rëndësishme:

Tabela nr. 6: Projektet e shpenzimeve kapitale

Kodet	Projekti/Produkti	Plani vjetor	Plani i rishikuar	Fakti 2024	Diferenca Plan/Fakt	% e realizimit
Projekti Pajisje Administrative		379,724,701	244,679,870	233,847,561	10,832,309	96%
19AA603	Blerje Paisje Zyre	101,168,831	1,000,000	839,880	160,120	84%
19AA604	Blerje Automjete		52,000		52,000	0%
19AA605	Blerje Paisje Elektronike	173,248,670	155,748,670	153,162,657	2,586,013	98%
19AA606	Blerje pajisje operacionale dhe të teknikës operative	9,000,000	72,000		72,000	0%
19AA607	Blerje Skanera dhe ura për dedektimin e mjeteve dhe objekteve	96,307,200	84,807,200	77,977,824	6,829,376	92%
19AA608	Blerje Stacion karikimi për automjetet elektrike		3,000,000	1,867,200	1,132,800	62%
Projekti Ndërtim Muri Rrethues		8,710,400	8,710,400	6,532,906	2,177,494	75%
23AB901	Ndërtim muri rrethues	8,380,400	8,380,400	6,452,906	1,927,494	77%
23AB902	Studim projektim lidhur me projektin e murit	100,000	100,000	80,000	20,000	80%
23AB903	Supervizim lidhur me projektin e murit	180,000	180,000		180,000	0%
23AB904	Kolaudim lidhur me projektin e murit	50,000	50,000		50,000	0%
Projekti Punime Rikonstruksioni Godina e re dhe Ndërtimi Urë Komunikuese midis dy godinave:		161,564,899	14,609,730	9,014,902	5,594,828	62%
23AC301	Punime ndërtimi urë komunikimi midis dy godinave	48,205,342	-		-	0%
23AC302	Punime rikonstruksioni Godina e Re	105,235,557	5,578,730	234,000	5,344,730	4%
23AC303	Studim projektim	6,000,000	9,031,000	8,780,902	250,098	97%
23AC304	Supervizim	1,920,000	-		-	0%
23AC305	Kolaudim	204,000	-		-	0%
Total		550,000,000	268,000,000	249,395,369	18,604,631	93%

Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar u krijua më 19 dhjetor 2019 si një institucion kyç në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në fazat e saj fillestare, një pjesë e konsiderueshme e buxhetit është e dedikuar për investime kapitale, të cilat janë thelbësore për ndërtimin e kapaciteteve operacionale dhe teknologjike.

Si një strukturë ligj zbatuese me mandat të veçantë, SPAK ka nevojë specifike në infrastrukturën e tij, duke përfshirë ndërtimin e ambienteve të sigurta dhe funksionale, pajisjen me teknologji të avancuar për hetimet dhe analizat forensike, si dhe krijimin e sistemeve të integruara të menaxhimit të informacionit dhe bazave të dhënave. Përdorimi i mjeteve të sofistikuara të përgjimit dhe analizës së të dhënave është jetik për përmbushjen e misionit të tij, ndërsa investimet në sigurinë kibernetike mbeten një prioritet për të garantuar mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm.

Përveç aspekteve teknike, investimet në burimet njerëzore, përmes trajnimeve të specializuara dhe ngritjes së kapaciteteve profesionale, janë po aq të rëndësishme për sigurimin e një institucioni të fortë dhe efektiv në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Gjatë vitit 2024, për realizimin e shpenzimeve buxhetore lidhur me investimet jo gjithçka shkoi sipas parashikimeve. Konkretisht prokurimi i fondit të miratuar me objekt “Ndërtim dhe rikonstruktion për godinën e re të SPAK” sipas urdhër prokurimit të datës 13.08.2024, procedurë e cila është anuluar për shkak të mosplotësimit të kriterëve nga operatorët ekonomik pjesëmarrës sipas përcaktimeve të Autoritetit Kontraktor. Kjo procedurë prokurimi është ri hedhur nga ana e Prokurorisë së Posaçme me urdhër prokurimin e datës 26.09.2024, procedurë e cila është anuluar për të njëjtat arsye, si më sipër. Ndodhur në këto kushte, për shkak të afateve kohore të pamjaftueshme për përdorimin e fondeve të rialokuara lidhur me këtë investim për këtë vit buxhetor, u kërkua pakësim të fondeve buxhetore vitin 2024, e cila u reflektua në Aktin Normativ nr. 5 datë 19.12.2024.

Me aktin normativ nr. 5 dt. 19.12.2024 Mbi ndryshimin e ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024 bazuar në deklaratimet e tepricave të fondeve buxhetore për SPAK, është miratuar pakësim i fondeve në shumën 282 milion lekë për këtë zë. Deklarimi i tepricave buxhetore ka qenë rrjedhojë e disa procedurave të cilat nuk u zhvilluan gjatë vitit 2024 dhe kryesisht e investimeve të parashikuara në përshtatjen e godinës së re.

Grante Kapitale

Nëpërmjet Kontratës së protokolluar me nr.1189, datë 30.03.2023, për Prokurorinë e Posaçme është miratuar një Grant në shumën 169,208,320 lekë, me burim nga AAPSK me objekt: “Blerje të pajisjeve dhe sistemeve elektronike për rritjen e sigurisë kibernetike dhe sistemit teknologjik për sportin e hetuesve në terren”.

Nga ky fond për vitin 2024 janë realizuar procedurat në shumën totale 47.9 mln lekë ose rreth 28% nga plani total, e cila është prokuruar në disa Lote:

- “Blerje Sistem mbrojtje antiransomware, storage, server” realizuar në shumën 17.5 mln lekë
- “Blerje Sisteme sigurie, monitorimi dhe akses kontrolli” realizuar në shumën 3.7 mln lekë
- “Blerje server” realizuar në shumën 22.6 mln lekë.
- “Blerje Sistem sigurie Antivirus” realizuar në shumën 4 mln lekë
- “Blerje Sistem dhe pajisje të teknikës operative” në shumën totale 121.2 mln lekë, është anuluar si pasojë e skualifikimit të gjithë OE. Procedurë e cila do zhvillohet në vitin 2025.

Diferenca e mbetur nga viti 2024 në vlerën 121.2 mln është trashëguar për vitin 2025.

1.3.5 Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit

Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, gjatë 12 mujorit të vitit buxhetor 2024 ka krijuar të ardhura jashtë limiti në vlerën totale 1,248 mln lekë.

1.4 Performanca e monitorimit

Gjatë vitit buxhetor 2024 nga Drejtoria e buxhetit dhe menaxhimit financiar janë kryer monitorimet e performancës financiare të shpenzimeve, analizës së zbatimit të buxhetit çdo 4-mujor/ 8-mujor/ 12-mujor. Për monitorimin e proceseve dhe aktiviteteve raportohet mbi realizimin e buxhetit, produkteve, treguesve apo indikatorëve të miratuar për monitorimin strategjive dhe objektivave, si dhe standardeve të përcaktuara në PBA. Raportet e monitorimit të buxhetit janë publikuar në faqen zyrtare të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

Në zbatim të ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe udhëzimin në zbatim të tij, qëndrueshmëria financiare e institucionit dhe ndjekja me rigorozitet e procedurave të menaxhimit financiar publik, kanë udhëhequr veprimtarinë administrative të institucionit në përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësisë, nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të vetëvlerësimit dhe plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Gjatë vitit 2024, në përmbushje të misionit dhe funksionimit, ka rritur performancën e punës së saj, me qëllimin realizimin me sukses të objektivave të përcaktuara.

Nga analizat e pyetësorëve, kontrolli i ushtruar nga Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit, Ministria e Financave, konkludoi në vlerësimin se sistemi i kontrollit të brendshëm financiar në Prokurorinë e Posaçme është efektiv.

Gjithashtu, zhvillimi i këtij procesi përcjell impaktin e tij në planifikimin dhe dokumentimin e risqeve për të realizuar në tërësi një proces të strukturuar të menaxhimit të riskut. Ndërkohë, gjatë vitit 2024 për rekomandimet e lëna nga kontrolli janë marrë masat korrigjuese për trajtimin e mangësive të vërejtura në sistem për të garantuar përmirësimin e tij në vazhdimësi.

2.1 Analiza statistikore mbi Procedurat e Prokurimit për vitin 2024

Për vitin 2024, janë zbatuar procedurat e prokurimeve, me fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit dhe nga grantet (Grant nga AAPSK).

Statistika në lidhje me numrin e procedurave të prokurimit të shpallura gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024, paraqitet si më poshtë sipas llogarive ekonomike.

Konkretisht, detajimi i elementëve paraqiten në Regjistrin e Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit, nga të cilat janë parashikuar 25 procedura prokurimi dhe për zërin Shpenzime Mallra Shërbime dhe 11 procedura prokurimi për zërin Investime Kapitale.

Regjistri i parashikimit përgjatë vitit ka pësuar ndryshime të cilat janë reflektuar dhe raportuar pranë Degës së Thesarit dhe APP.

Bazuar në buxhetin e akorduar parashikimi për procedurat e prokurimit është në vlerën 166 mln ose 75% e buxhetit total për Shpenzimet Operative, ndërsa shpenzimet kapitale janë parashikuar në vlerën 268 mln.

Nga Marrëveshjet Kuadër të mbartura nga vitit 2023 janë realizuar 6 procedura prokurimi, nga e cila janë lidhur 28 kontrata me vlerë 14.3 mln lekë.

Nga Marrëveshje Kuadër të vitit 2024 janë realizuar 7 procedura prokurimi, nga e cila janë lidhur 14 kontrata sipas Lotëve përkatëse me vlerë 10.2 mln lekë.

Nga procedurat me kontratë të vitit 2024 janë realizuar 18 procedura prokurimi me vlerë 129.4 mln lekë.

Nga procedurat për investimet të vitit 2024 janë realizuar 10 procedura prokurimi me vlerë 251 mln lekë


3.1 Analiza e shpenzimeve

Përgjatë vitit 2024 janë përpiluar, regjistruar në sistemin informatik SIFQ (AFMIS):

- 766 Urdhër Shpenzime
- 19 Urdhër Blerje (vetëm kontrata të lidhura që plotësojnë kriterin e vlerës mbi 1.2 mln),
- 25 Urdhër Kërkesë Blerje (urdhëra prokurimi për procedura të tenderuara përgjatë 2024).

Për të gjitha këto transaksione nuk ka rezultuar të ketë asnjë vonesë përtej afateve të përcaktuara në udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Degës së Thesarit, pavarësisht kontrollit, hartimit dhe ekzekutimit të tyre në kohë.

Tabela: Tendanca e shpenzimeve operative dhe investimeve të vitit kalendarik:



Nga shqyrtimi i ecurisë së kryerjes së shpenzimeve publike mujore për periudhën janar-dhjetor 2024, në nivelin më të ulët shpenzimet rezultojnë në muajin janar me 4.4% dhe në nivelin më të lartë në muajin dhjetor me 32 % të totalit.


Në zbatim të ligjit vjetor të buxhetit të rishikuar, burimet financiare për vitin 2024 paraqiten të ndara sipas kapitujve buxhetore:

- Kapitulli 01 – Fondi nga Buxheti i shtetit
- Kapitulli 06 – Fondi nga Grantet



Në tërësinë e likuidimeve të ekzekutuara rezultojnë që peshën më të madhe e zënë shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemeve (përgjimi dhe ekspertiza), të pasuara nga shpenzime për shërbime utilitare (energji elektrike, ujë, telefoni, internet etj.) dhe shpenzime për likuidimin e faturave të shërbimeve të ofruara nga ASHK. Në shpenzimet operative janë kryer gjithashtu dhe shpenzime për pagesë avokatësh, ekspertësh dhe përkthyesish, taksa, shpenzime për blerje materiale të ndryshme kancelarie, materiale pastrimi, karburant, shpenzimet për mirëmbajtje transporti, shpenzime për mirëmbajtje godine etj.

Grafik: Pesha që zënë shpenzimet operative sipas llojit të tyre.




Në zbatim të Program Udhëtimeve, Vizitë Pune në përmbushje të detyrave funksionale të Institucionit, për vitin 2024 janë trajtuar financiarisht 66 Program Udhëtime në monedhën Euro në vlerën 14.500 Euro.

Shpenzimet operative të kryera nga Financimet e EUROJUST janë shpenzime procedurale të cilat lidhen me çështje të skuadrave të përbashkëta hetimore. EUROJUST rimbursion deri në 95% të shpenzimeve lidhur me këto procedime penale, kryesisht për përkthim të akteve, akomodim, udhëtim.

Për shpenzimet kapitale gjatë vitit 2024 nëpërmjet procedurave të prokurimit janë kryer likuidime në të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e aseteve të institucionit, duke shtuar vlerën e aktiveve afatgjata si dhe duke përmirësuar kapacitetin operacional nëpërmjet investimeve kryesisht në teknologji dhe infrastrukturë.

Të paraqitura grafikisht në formë të përmbledhur sipas peshës që zënë në totalin e zërit për investime.



Nga grafiku vërehet se shpenzimet në sisteme informatike zënë peshën më të madhe rreth 67%.

3.2 Analiza e të ardhurave

Burimet e të ardhurave ndahen kryesisht në:

- Të ardhurat të realizuara nga institucioni, ku kryesisht përfshihen tarifatat për shpenzimet procedurale (fotokopje, skanime, CD, gjoba gjyqësore), bazuar në udhëzimin e Prokurorisë së Posaçme Nr.613 datë 15.09.2023 “Për shpenzimet procedurale të Prokurorisë”, të cilat janë derdhur në buxhetin e shtetit në fund të vitit.
- Të ardhurat nga Grante të cilat përbëhen nga fondet me burim nga AAPSK me qëllim përdorimin e tyre për investime në funksion të Institucionit si dhe fonde nga EUROJUST me qëllim kompensimi të shpenzimeve operative të cilat lidhen me çështje të skuadrave të përbashkëta hetimore.

Për vitin 2024 të ardhurat e realizuara paraqiten si më poshtë:

Kodi institucionit	Llogaria ekonomike	Përshkrimi i të Ardhurave	Shuma e arkëtuar	Derdhur në buxhet
1041001	7111008	Të ardhura nga fotokopje	1,182,268	1,182,268
	7113099	Të tjera nga shitja e mallrave e shërbimeve (skrap)	9,737	9,737
	7115401	Gjoha gjyqësore	51,025	51,025
	7115600	Sekuestre dhe zhdëmtime	112,188	112,188
	7190990	Të tjera jo tatimore	336,672	336,672
	7207011	Sponsor nga subjekte shtetërore ose publike		
	7211100	Grande nga organizata ndërkombëtare	1,337,102	
Total			3,028,992	1,691,890

3.3 Analiza e Pasqyrave Financiare

Kalimi në përgjegjësi administrimi të pasurive të paluajtshme për vitin 2024

Nga sektori i finances, në zbatim VKM-së nr. 378, datë 21.06.2023 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë për Prokurorinë e Posaçme dhe revokimin e së drejtës së

pronësisë Bashkisë Tiranë, shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” sha, të pasurisë Nr.8/123, në zonën kadastrale 8330 është kryer regjistrimi kontabël i vlerës së pasurisë Nr. 8/123 në pronësi të Strukturës së Posaçme undër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në shumën 744,178,250.54 lekë, specifikuar si më poshtë:

Zërat Kontabël	Vlera Bruto	Amortizimi	Vlera Neto
210 (Truall)	213,986,207.00	0	213,986,207.00
212 (Ndërtesa)	530,192,043.5	0	530,192,043.54
Total	744,178,250.54	-	744,178,250.54

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 754, datë 13.12.2024 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 518, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të godinës ku ushtron veprimtarinë Kontrolli i Lartë i Shtetit, për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit dhe Komisionerëve Publikë, institucionet e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve ne Republikën e Shqipërisë, i parashikuar nga ligji nr. 84/2016”, të ndryshuar”, si dhe në zbatim të urdhrit të përbashkët ndërmjet Prokurorisë së Posaçme dhe IKP, “Për transferimin pa pagesë të aktiveve nga Institucioni i Komisionerëve Publikë në Prokurorinë e Posaçme , janë finalizuar të gjitha procedurat e transferimit të aktiveve.

Zërat Kontabël	Vlera Bruto	Amortizimi	Vlera Neto
215 (Automjet)	2,394,000	1,777,058	616,942
218 (Orendi zyre)	18,564,232	15,069,135	3,495,097
32 (Inventar i imët)	494,573	-	494,573
Totali	21,452,805	16,846,194	4,606,611

Aktive nga donatorë të huaj

Gjatë vitit 2024, në kuadër të bashkëpunimit me ndërkombëtarët është mundësuar që institucionit tonë ti vijë në ndihmë edhe asete të dhuruara prej tyre të cilat kanë kontribuar në përmirësimin e sistemeve dhe pajisjeve të IT. Konkretisht këtë vit kemi patur akt-dhurime nga Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Fondacioni Spanjoll “Internacional Y Para Iberoamerika de Administraciony Politicas Publicas”.

Nr.	Donatori	Lloji i donacionit	Vlera e dhuruar
1	Departamenti i USA	Forensic Workstation - Talino KA-301)	3,598,221
2	Departamenti i USA	Laptop	898,625
3	FIIPP	Pajisje dhe orendi Zyre	677,226
Totali i donacioneve			5,174,072

4 ANALIZA KRAHASIMORE PËR VITET 2020-2024

4.1 Analiza e planit buxhetor dhe faktik i shpenzimeve 2020-2024

Si pjesë e vijueshmërisë së aktivitetit të institucionit, paraqesim analizën krahasuese të planit vjetor dhe realizimin e treguesve buxhetorë me vitet paraardhëse.

Më poshtë po japim një pasqyrë krahasuese për pesë vitet e fundit:

Tabela nr.6: Pasqyrë krahasimore për vitet 2020-2024 ne 000 lekë

Llogaria	Zërat e shpenzimeve	Veprimtaria e SPAK														
		Viti paraardhës 2020			Viti paraardhës 2021			Viti paraardhës 2022			Viti paraardhës 2023			Viti Ushtimor 2024		
		Plani vjetor	Shpenzime faktike	% e realizimit	Plani vjetor	Shpenzim e faktike	% e realizimit	Plani vjetor	Shpenzim e faktike	% e realizimit	Plani vjetor	Shpenzim e faktike	% e realizimit	Plani vjetor	Shpenzim e faktike	% e realizimit
1	2	3	4	5=4/3	6	7	8=7/6	9	10	11=10/9	12	13	14=13/12	15	16	17=16/15
600	Paga	218,329	112,956	52%	279,783	237,038	85%	474,081	429,826	91%	831,163	824,798	99%	789,000	749,365	95%
601	Sigurime Shoqërore	23,126	10,597	46%	27,646	22,215	80%	44,985	38,006	84%	60,174	60,005	100%	66,946	63,448	95%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	65,600	24,973	38%	61,689	40,056	65%	121,305	99,042	82%	163,617	149,084	91%	185,617	160,908	87%
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	120	50	42%	330	220	67%	1,929	1,839	95%	484	419	87%	984	984	100%
Nën-Totali	Shpenzime Korrente	307,175	148,576	48%	369,448	299,529	81%	642,300	568,713	89%	1,055,438	1,034,306	98%	1,042,547	974,705	93%
231	Kapitale të Trupëzuara	20,000	18,475	92%	30,000	26,231	87%	21,000	19,350	92%	22,000	8,436	38%	268,000	249,395	93%
Nën -Totali	Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	20,000	18,475	92%	30,000	26,231	87%	21,000	19,350	92%	22,000	8,436	38%	268,000	249,395	93%
Totali		327,175	167,051	51%	399,448	325,760	82%	663,300	588,063	89%	1,077,438	1,042,742	97%	1,310,547	1,224,100	93%


Nga tabela e mësipërme vihet re rritja e planit vjetor ndër vite e cila është rrjedhojë ;

- **Shtimi i kapaciteteve njerëzore**, përfshirë rekrutimin e prokurorëve dhe stafit mbështetës
- **Investimet në teknologji dhe infrastrukturë**, për të forcuar kapacitetet hetimore dhe sigurinë institucionale;
- **Rritja e volumit të punës** për shkak të numrit gjithnjë e më të madh të çështjeve të ndjekura

Nga kjo tabelë vihet re se:

- **Buxheti ka ardhur në rritje çdo vit**, duke reflektuar forcimin e kapaciteteve institucionale si nga pikëpamja procedurale dhe administrative;
- **Niveli i realizimit të fondeve është përmirësuar ndjeshëm**, nga 51% në vitin 2020 në 93% në vitin 2024, duke treguar një administrim më efikas të burimeve.

Grafiku nr.4: Struktura krahasimore plan/faktt 2020-2024




Sipas informacionit të paraqitur në mënyrë tabelare dhe grafike rezulton se pesha specifike e llogarive mbi totalin e realizimit për vitet 2020-2024 nuk ka ndryshime të konsiderueshme.

4.1.2 Struktura e Shpenzimeve

Për një kuptim më të mirë të alokimit të fondeve, analizojmë ndarjen e shpenzimeve sipas kategorive kryesore:

Grafiku nr.4: Pesha specifike e realizimit faktik për vitet 2020-2024



Nga analiza e strukturës së shpenzimeve vërejmë se:

- **Shpenzimet korente përbëjnë mesatarisht 78-81% të totalit**, duke reflektuar peshën e pagave, trajtimeve financiare dhe kostove operative të institucionit;
- **Shpenzimet kapitale ruajnë një nivel të qëndrueshëm prej rreth 20% të totalit**, duke treguar një orientim drejt përmirësimit gradual të infrastrukturës dhe teknologjisë së institucionit.

Ajo që vlen të theksohet është që shpenzimet e personelit janë ato që zënë ende pjesën kryesore të fondeve buxhetore të akorduara për institucionin tonë. Devijim nga ky trend përbën vetëm viti 2023 që lidhet me pagesat e kryera për efekte të vendimit kushtetueses mbi pagat e magjistratëve.


Lidhur me shpenzimet operative (utilitete dhe shërbime) edhe tek ato vihet re një kurb me tendencë rritëse e cila ruan një normë në nivele thujse të njëjta nga viti në vit përgjatë 5 viteve të fundit e cila vjen si rezultat i shpenzime të rritura për nevoja të institucionit dhe stafit si dhe ndikimi që ka inflacioni në vendin tonë.

Dukshëm vihet re një tendencë rritëse në shpenzimet për investime por që në ndryshim me dy zërat e mëparshëm kjo rritje është shumë e konsiderueshme, konkretisht mbi 70% si rrjedhojë e investimeve të reja në kuadër të zhvillimeve teknologjike.

Peshën specifike më të lartë e zënë shpenzimet për paga dhe peshën specifike më të ulët e zënë Transferta të tjera.

Rritja e shpenzimeve, vjen për shkak të ndryshimeve ligjore ndër vite lidhur me ndryshimet e pagave, shtimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore, shtimit të mallra shërbime dhe shpenzime kapitale.

Grafiku nr.5: Shpenzimet faktik për vitet 2020-2024



Konstatohet se progresivisht ka një rritje të konsiderueshme të shpenzimeve konkretisht në vitin 2024 rritja është 181.3 milion lekë më shumë krahasuar me vitin 2023 dhe 1,057 milion lekë krahasuar me vitin 2020, nga të cilat:

- Shpenzimet për paga për vitin 2024, rritja është 636 milion lekë më shumë krahasuar me vitin 2020.
- Shpenzimet për sigurime për vitin 2024, rritja është 52 milion lekë më shumë krahasuar me vitin 2020.
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime, për vitin 2024, rritja është 135.9 milion lekë më shumë krahasuar me vitin 2020.
- Ndërsa shpenzimet për investime për vitin 2024 rritja është 230.9 milion lekë më shumë krahasuar me vitin 2020.

Vendosja në funksion të plotë të veprimtarisë së institucioneve si Prokuroria e Posaçme ashtu edhe Byroja Kombëtare të Hetimit, si dhe ndryshimeve ligjore gjatë vitit ka krijuar efektet financiare shtesë sipas llogarive ekonomike.

Nga analiza e të dhënave mbi shpenzimet buxhetore për periudhën 2020-2024, mund të nxjerrim disa përfundime kryesore:

- Rritja progresive e buxhetit tregon zhvillimin dhe konsolidimin e SPAK si institucion kyç në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;
- Administrimi më efikas i fondeve ka sjellë një përmirësim të ndjeshëm në realizimin e buxhetit;
- Pesha e lartë e shpenzimeve korente tregon rëndësinë e burimeve njerëzore në funksionimin e SPAK;

- Investimet në teknologji dhe infrastrukturë janë jetike për rritjen e kapaciteteve hetimore dhe efikasitetit operativ.

4.2 Analiza e të ardhurave 2020-2024

Më poshtë po japim një pasqyrë krahasuese të të ardhurave për pesë vitet e fundit:

Pasqyrë krahasimore për vitet 2020-2024

<u>Llogaria ekonomike</u>	<u>Përshkrimi i te Ardhurave</u>	<u>Shuma e arkëtuar progresive</u>				
		2020	2021	2022	2023	2024
7111008	Të ardhura nga fotokopje		912,196	1,399,881	1,155,500	1,182,268
7113099	Te tjera nga shitja e mallrave e shërbimeve (skrap)					9,737
7115401	Gjopa gjyqësore		13,310	332,720	1,700,391	51,025
7115499	Te tjera gjopa				3,000	-
7115600	Sekuestime dhe zhdemtime				66,667	112,188
7190990	Te tjera jo tatimore		174,000	327,038	376,151	336,672
7207011	Sponsor nga subjekte shtetërore ose publike		30,241,187		169,208,320	-
7211100	Grande nga organizata ndërkombetare				4,147,724	1,337,102
Total Klasa 7		-	31,340,693	2,059,639	176,657,753	3,028,992

Nga të dhënat tabelore rezulton që të ardhurat nga shpenzimet procedurale në vitin 2024 kanë një tendencë rritëse si rezultat i shtimit të volumit dhe kompleksitetit të çështjeve nën hetim. Kjo ka bërë që dhe kërkesa për kopje dokumentacioni të jetë më e madhe nga palët e treta të interesuara.

Edhe të ardhurat nga grantet, ku peshën kryesore e zënë ato nga AAPSK, kanë pësuar rritje përgjatë harkut kohor të pesë viteve. Konkretisht janë akorduar në fillim një total prej 30,241,187 lekë dhe më pas në 2023 një shumë prej 169,208,320 lekë.

4.3 Analiza e procedurave të prokurimit 2020-2024

Kjo analizë për procedurat e prokurimit pasqyron punën e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për periudhën nga 1 Janar 2020 - 31 Dhjetor 2024 në fushën e prokurimit publik në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e prokurimeve publike.

Statistika në lidhje me numrin total të procedurave të prokurimit publik sipas llojit, të zhvilluara për periudhën kohore 2020-2024.

Procedura në total Investime				
Nr	Viti Buxhetor	Vlera Totale e kontratave me TVSH	Vlera Totale e kontratave pa TVSH	Fondi limit
1	Viti 2024	249,776,987.00	208,147,489.17	252,793,029.33
2	Viti 2023	8,435,998.80	7,029,999.00	8,944,669.00
3	Viti 2022	25,235,665.00	21,029,720.83	25,124,996.89
4	Viti 2021	52,421,270.40	43,684,392.00	44,788,199.00
5	Viti 2020	17,760,000.00	14,800,000.00	15,055,552.50
Total		353,629,921.20	294,691,601.00	346,706,446.72

Për sa më lart, vërehet një rritje e konsiderueshme e vlerës së kontratave të nënshkruara duke shënuar një rritje 3-fish në vitin 2021 krahasuar me ato të një viti më parë. Nga viti 2021 në vitin 2022 vërehet një zbritje me ½ të vlerës së kontratave të nënshkruara. Në vitin 2023 shënohet një rënie e konsiderueshme e vlerës së kontratave për shkak të anulimit të procedurave të prokurimit dhe ri inicimit të tyre në vitin e ardhshëm buxhetor. Viti 2024 shënon pikën kulminante të realizimit të procedurave të prokurimit publik për zërin 231 “Investimet Kapitale”, shoqëruar me një vlerë prej 249,776,987 lekë me TVSH.

Fondi limit i kursyer (si rezultat i diferencës ndërmjet fondit limit që rezulton nga studimi i tregut dhe vlerës së kontratës së nënshkruar) paraqitet si më poshtë vijon për 5 vitet buxhetore 2020-2024:

- Për vitin 2020 është **306,663 lekë me TVSH.**
- Për vitin 2021 është **1,324,568 lekë me TVSH.**
- Për vitin 2022 është **4,914,331 lekë me TVSH.**
- Për vitin 2023 është **2,297,604 lekë me TVSH.**
- Për vitin 2024 është **53,574,648 lekë me TVSH.**

Fondi limit në total i kursyer për procedurat e investimeve për periudhën 2020-2024 është **62,417,814 lekë me TVSH.**

Statistika në lidhje me procedurat e marrëveshjeve kuadër në total

Procedura në total Marrëveshje Kuadër		
Nr	Viti Buxhetor	Nr.total i procedurave
1	Viti 2024	7
2	Viti 2023	6
3	Viti 2022	6
4	Viti 2021	2
5	Viti 2020	3
Total		24

Për procedurat e prokurimit me marrëveshje kuadër vërehet një rënie e lehtë nga viti 2020 në vitin 2021. Po ashtu nga viti 2021 në vitin 2022 shënohet një rritje e theksuar e numrit të procedurave me marrëveshje kuadër duke u ruajtur kjo qëndrueshmëri dhe për vitin 2023. Viti 2024 shënon pikën më kulminante të numrit të procedurave duke arritur në 7 të tilla.

Procedura në total Marrëveshje Kuadër		
Nr	Viti Buxhetor	Vlera Totale e kontratave me TVSH
1	Viti 2024	24,546,673
2	Viti 2023	28,236,929
3	Viti 2022	25,664,237
4	Viti 2021	5,488,188
5	Viti 2020	8,889,449
Total		92,825,476

Vlera totale me TVSH e përlogaritur për çdo vit buxhetor përfshin të gjitha kontratat e lidhura në zbatim të marrëveshjeve kuadër të lidhura në vitin aktual buxhetor së bashku me kontratat e lidhura në zbatim të marrëveshjeve kuadër të lidhura vitin e mëparshëm buxhetor me afat 1 vjeçar.

Sa i përket vlerës së kontratave të nënshkruara lidhur me marrëveshjet kuadër kurba shënon ulje dhe rritje graduale nga viti në vit.

Statistika në lidhje me prokurimet me vlerë të vogël

Procedura në total Blerje e Vogël		
Nr	Viti Buxhetor	Nr.total i procedurave
1	Viti 2024	25
2	Viti 2023	22
3	Viti 2022	16
4	Viti 2021	22
5	Viti 2020	18
Total		103

Procedura në total Blerje e Vogël		
Nr	Viti Buxhetor	Vlera Totale e kontratave me TVSH
1	Viti 2024	5,007,618
2	Viti 2023	3,467,688
3	Viti 2022	3,028,651
4	Viti 2021	4,871,564
5	Viti 2020	2,213,092
Total		18,588,613

Nga tabela vërehet se ka një rritje të vlerës së realizuar nga viti 2020 në vitin 2021, duke shënuar një ulje të lehtë në vitin 2022 e cila ka vazhduar me një qëndrueshmëri dhe në vitin 2023, duke u pasuar me një rritje në vitin 2024.

5.PLANI VJETOR VITI 2025-2027

Në kuadër të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, i cili pasqyron shpërndarjet e buxhetit në tre vite buxhetore, në përputhje me rregullat dhe afatet e parashikuara në udhëzimin përkatës të Ministrisë të Financave, buxhetit gjatë vitit 2024, është angazhuar në administrimin dhe hartimin e kërkesave buxhetore duke i'u përmbajtur datave për prezantimin e kërkesave buxhetore në Ministrinë e Financave, në përputhje me Kalendarin e Menaxhimit të Shpenzimeve Publike të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Buxhetit ka paraqitur Raportet e përgatitjes së buxhetit afatmesëm për fazën strategjike, teknike, dhe përfundimtare sipas taveve të miratuara.

Krahas raportimit në mënyrë shkresore, të dhënat faktike për treguesit e performancës në nivel qëllimi e objektivi të politikës si dhe sasive faktike të produkteve për secilin program buxhetor janë reflektuar në sistemin Informatik të Menaxhimit Financiar (AFMIS) nga ekipi i menaxhimit të programit (EMP).

5.1 Analiza e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027

Në funksion të përmbushjes së Misionit dhe të Objektivave të institucionit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, akteve nënligjore për përgatitjen e PBA 2025-2027, janë hartuar kërkesat buxhetore për politikat ekzistuese dhe politikat e reja të planifikuara në përputhje me objektivat e institucionit.

Me ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025” buxheti i miratuar për SPAK është në vlerën 2,369 milion lekë i ndarë sipas zërave buxhetorë në:


Tabela nr.9: Struktura e programit “Veprimtaria SPAK” për vitin 2025-2027

000/lekë

Art.	Emërtimi	Plani i miratuar Vjetor 2025	Struktura e shpenzimeve	Plani i miratuar Vjetor 2026	Struktura e shpenzimeve	Plani i miratuar Vjetor 2027	Struktura e shpenzimeve
1	2	3		4		5	
600	Paga	1,285,496	54%	1,285,496	72%	1,285,496	72%
601	Sigurime Shoqërore	136,000	6%	136,000	8%	136,000	8%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	248,117	10%	148,117	8%	148,117	8%
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ						
Nën-Totali	Shpenzime Korrente	1,669,613	70%	1,569,613	88%	1,569,613	88%
231	Kapitale të Trupëzuara	700,000	30%	220,000	12%	210,000	12%
Nën -Totali	Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	700,000	30%	220,000	12%	210,000	12%
Totali (korrente + kapitale)		2,369,613	100%	1,789,613.0	100%	1,779,613	100%

Në tabelën e mësipërme është kryer shpërndarja sipas llogarive ekonomike për vitet 2025-2027. Siç vërehet plani vjetor i miratuar në vitin 2025 në shumën totale 2,369 mln është më i lartë se dy vitet pasardhëse.

Grafiku nr.6: Pesha specifike sipas llogarive ekonomike të planit të buxhetit viti 2025



Shpenzimet për paga dhe sigurime në vlerën e rreth 1,421 milion lekë, ose 60% të buxhetit të miratuar, janë parashikuar sipas strukturës së miratuar për Prokurorinë e Posaçme dhe BKH. Vlen të theksojmë se për personelin Magjistrat, Hetues Financiar, Hetues të BKH- së si dhe Ekspertë, efekte të shtuara në shpenzimet për paga janë dhe orët e gatishmërisë dhe jashtë orarit zyrtar. Natyra e punës dhe veçoritë specifike të ushtrimit të detyrës në hetim sjell domosdoshmëri të kërkesës për të ushtruar detyrën mbi kohën normale të punës. Në buxhetin e miratuar në zërin e pagave nuk është parashikuar fond për kryerjen e pagesave mbi kohën shtesë të punës, për

kategorinë e subjekteve si më sipër, fakt i trajtuar dhe në relacionin e paraqitur në PBA dhe Komisionin e Ligjeve.

Shpenzime Operative në vlerën e rreth 248 milion lekë ose 10% të buxhetit të miratuar, janë parashikuar për mbulimin e kostove të funksionimit dhe administrimit të institucionit. Këto fonde gjatë vitit 2025, SPAK do ti vendos në efikasitet të plotë për të siguruar infrastrukturën e nevojshme me mallra dhe shërbime për arritjen e objektivave procedurale të hetimit të veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Sa kemi trajtuar dhe në analizën e treguesve të realizuar për vitin 2024, SPAK për shkak të natyrës së punës disponon teknologji në përdorim brenda ambienteve të cilat duhet të qëndrojnë në funksion të plotë dhe pa ndërprerje dhe si rrjedhim mirëmbajtja e tyre është e domosdoshme për të shmangur riskun e dëmeve të mundshme si pasojë e mungesës së mirëmbajtjes së tyre. Për vitet në vijim 2025-2027 referuar parashikimeve për vitin 2025 dhe kërkesave të shtuara (rrjedhojë e shtimit të kapaciteteve të sistemeve IT) parashikohet rritje e shpenzimeve të mirëmbajtjes së këtyre sistemeve.

Shpenzime për investime janë parashikuar në vlerën 700 milion lekë ose 30% të buxhetit të miratuar. Në kushtet e emergjencës për përshtatjen e Godinës së re në funksion të nevojave të institucioneve të SPAK, duke përfshirë këtu edhe rekrutimin e vendeve vakante në strukturë, e cila do të rezultojë në më shumë efektivitet në punë, buxheti i miratuar për shpenzime kapitale, do të përdoret për realizimin e investimeve në punime ndërtimi, pajisje elektronike dhe infrastrukturë të IT, blerje pajisje zyre, si dhe pajisje operacionale.

Për të realizuar objektivat e Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, të përcaktuara në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, në përputhje me metodologjinë e hartimit të PBA-së 2025-2027, SPAK për vitin 2025 ka përcaktuar treguesit e performancës që lidhin qëllimin dhe objektivat e institucionit me realizimin e buxhetit vjetor. Në zbatim të ligjit nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, janë marrë masat për pasqyrimin sa më të saktë dhe real të detajimit të planit të shpenzimeve, bazuar në objektivat strategjike të institucionit dhe treguesve të performancës.

6. NDRYSHIMET NË BUXHET VITI 2024

Për vitin 2024, rrjedhojë e ndryshimeve të akteve ligjore/nënligjore, i referohemi këtu;

- VKM nr. 421, datë 26.06.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 325/2023, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”
- VKM nr. 422, datë 26.06.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 326/2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të specialiteteve të tjera në institucione të administratës publike”, e cila ka sjellë efekt rritës në shpenzime për zërat paga dhe sigurime.
- Me Akti Normativ nr. 3, datë 28.08.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” janë reflektuar ndryshime në buxhet, konkretisht pakësime në zërat buxhetor me vlerë totale 87 mln lekë dhe ndryshimi i numrit të

punonjësve në organik, shtesa prej 40 punonjës. Detajimet përkatëse janë reflektuar në muajin Shtator. Për 8 mujorin nuk kemi ndryshime në buxhetin e planifikuar.

- Me Akti Normativ nr. 5, datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” janë reflektuar ndryshime në buxhet, konkretisht pakësime në zërat buxhetor me vlerë totale 282 mln lekë. Detajimet përkatëse janë reflektuar në muajin Dhjetor.
- VKM nr. 846, datë 26.06.2024 “Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2024” në fondin e veçantë, e cila ka sjellë efekt rritës në shpenzime me vlerë totale 401 mijë lekë.

Kuvendi

